

Zoran Zaevi
Deri në fund të vitit sërish rritje pagës minimale

Fq.6



SHTETËSITË NË RMV


I huaj në shtëpinë e tij!

Fq.5



Putin do ndante Kosovën si Gjermaninë

Fq.18



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3594 · e martë, 26 shkurt 2019

-6°C | 12°C

15 DEN



KOHA për kulturë

Fq.12-15

EDITORIAL

Klonimi me pupla të huazuara



Mirënjohja që po u jepet artistëve e sportistëve nëpër botë, flet për kreativitete individuale të tyre, por jo për ndonjë burracakëri të ndonjë institucioni a politikani. Dua Lipa, tash së fundmi, por edhe emra të tjerë të kulturës e sportit, siç është, bie fjala, Majlinda Kelmendi e ndonjë tjetër, janë 'ana e tjetër' e botës shqiptare që po djeg çdo tentim për rrahgjoksi individësh të struktur nëpër institucione shtetërore. Është ajo 'anë e...'

Fq.2

RAJON

Marrëveshje që sjell stabilitet në rajon

Fq.16

GLOBI

Me tren të blinduar për t'u takuar Trumpin

Fq.17



IMUNITETI I VELJANOVSKIT PËRPLAS LSDM-BDI

NGËRÇ I RI BRENDA KOALICIONIT



Ndarjet në koalicionin qeveritar tashmë kanë dalë në shesh. BDI dhe LSDM akuzojnë njëra-tjetrën se kanë "shpëtuar" ish-kryeparlamentarin Trajko Veljanovski nga përgjegjësia për 27 prillin e përgjakshëm në Parlament në vitin 2017. Zaevi shprehet i revoltuar me BDI-në, Xhaferi akuzon Zekirin. Opozita shqiptare ndërkohë kërkon dorëheqje dhe zgjedhje të parakohshme

Fq.3

Nuk ka raste të rrëmbimeve

Shkup, 25 shkurt - As nuk ka rast të rrëmbimit, as personave që në disa rastet e fundit i kanë humbur jetët u mungojnë organet. Këtë e konfirmoi mjekësia ligjore. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka asnjë rast të vrasjes për shkak të nxjerrjes së organeve, potenco dje në konferencën për shtyp ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, i cili edhe një herë përgënjeshtroi ashpër informacionet dhe

spekulimet në të cilat keqpërdoren rastet aktuale të personave të zhdukur. "Kategorikisht i hedh poshtë spekulimet për gjoja rrëmbyes dhe gjoja shitje të organeve njerëzore. Këto janë gënjeshtra dhe dezinformata", tha ministri. Ai theksoi se me gënjeshtra dhe dezinformata të këtilla dëmtohet shoqëria dhe qytetarët, të cilëve me të vërtetë u nevojitet ndihmë. Apeloj që qytetarët të jenë...

Fq.7



EDITORIAL

KLONIMI ME PUPLA
TË HUAZUARA

Emin AZEMI

Mirënjohja që po u jepet artistëve e sportistëve nëpër botë, flet për kreativitete individuale të tyre, por jo për ndonjë burracakëri të ndonjë institucioni a politikani. Dua Lipa, tash së fundmi, por edhe emra të tjerë të kulturës e sportit, siç është, bie fjala, Majlinda Kelmendi e ndonjë tjetër, janë 'ana e tjetër' e botës shqiptare që po djeg çdo tentim për rrahgjoksi individësh të struktur nëpër institucione shtetërore. Është ajo 'anë e medaljes' ku imazhi i shqiptarëve po ndërtohet me mund individual dhe me pasion e përkushtim të pashterur, pa prituri se ndokush do t'u shtrojë para këmbëve qilimin e lavdisë së pamerituar. Po ndodhë kjo pikërisht në kohën kur elitat politike shqiptare në Ballkan janë më të përçara se kurdoherë më parë dhe së rrjedhojë po dërgojnë anën (tjetër të medaljes) e zymtë të imazhit shqiptar në botë. Lajmet e kronikat e mbushura me sherre e prapaskena, sikur nuk po mjaftohen të pikturojnë realitetin me ngjyrat më të zymta dhe tash së fundmi është kaluar në një garë të hapur protagonizmi negativ të aktorëve të mjerë të skenës politike të shqiptarëve. Këta të fundit të zënë peng nga mazohizmi i tyre politik, që po e gatujnë me zgjatime duarsh të huazuara edhe nga kuzhinat tjera, sikur kanë filluar ta kompensojnë imazhin negativ me pritje ceremoniale (vetëm sa për t'u dikur të buzëqeshur në foto) e postime, krejt formale, e krejt triviale dhe sikur duan të na thuan se prapa suksesit të këngëtarëve e sportistëve shqiptarë nëpër botë po qëndrukan pikërisht ata, politikanët 'engjuj'. Pra, po ata politikanët grindavecë që janë bërë pikë e pesë me qëndrime e opsione diametralisht të kundërt, tash gjejnë kohë të bëjnë selfy me ikonat e shquara të kulturës e sportit, teksa aktojnë figurën fuqishme të politikës shqiptare, pa kontributin e të cilit s'paska mund të triumfoj madje as Dua Lipa në "Brit Awards 2019".

Në protokollin e shumë politikanëve tanë vazhdon të 'farkohet' krenaria e artistëve e sportistëve, si një aset që duhet patjetër të 'prarohet' në flakën e mirënjohjes ceremoniale politike. Pa këtë mirënjohje sikur mbetet i zbehët triumfi artistik apo sportiv në planin ndërkombëtar, sepse çelësin e suksesit që ta jep katundi ynë politik, duhet mbajtur si hajmali që ruan në vete magjinë e suksesit.

Çdo kush e ka të qartë se cila është potencia financiare e shteteve tona për të ndjekur zhvillimin e ndonjë talenti në kulturë apo në sport. Dhe askush nuk po kërkon që në trumfin ndërkombëtar të talentëve tanë, sidomos të atyre që jetojnë jashtë vendit, të merr pjesë edhe ndonjë dikaster i yni shtetëror, por është e pafalshme që të kalohet me kaq komoditet në 'gjuetinë' e meritave të paqena, ndërkohë që ka plot talent vendor i cili nuk mundet të prosperoj vetëm pse mungon mbështetja minimale institucionale. Shembuj të tillë kanë raportuar mediat në këto vitet e fundit dhe është e tepërt të ilustrohen rastet e veçanta, sepse përshtypje e përgjithshme është se politikanëve më tepër iu intereson të fotografohen me ndonjë yll të artit apo të sportit, se sa të na tregojnë se sa ministrat e tij kanë ndihmuar konkretisht një nismë kulturore, apo ndonjë ngjarje sportive.

Nëse themi se sportistët dhe artistët janë ambasadorët më të denjë të kombit të tyre në botë, që nuk kërkojnë kurrfarë kompensimi as shpërblimi për këtë punë, atëherë me çfarë të drejte kërkojmë prej tyre të bëhen edhe rregullues të imazhit të politikanëve, ndërkohë që këta të fundit asnjëherë nuk e kanë kuptuar drejt rolin e artistëve, shkrimtarëve, sportistëve dhe më së paku kanë nevojë të stolisen me puplat që ua huazojnë ata për t'u dukur më të bukur në sytë e publikut. Në raste të tilla, një dukje si kjo më dendur asocon në një kloun që mund të përdoret për zbatimje çasti, dhe më së paku i ngjason një politike që ka të ndërtuar strategji afatgjate në zhvillimin e kulturës dhe sportit.

TRENI I FEMINIZMIT NA KA
KALUAR ME KOHË

"Pak ditë më parë një mikja ime gazetare, e cila kishte qenë në promovimin e librit të një kolegut tim, më tha se në festën e tij kishte më së shumti kolegë burra, dhe më pyeti se si e shpjegoja këtë. Në të vërtetë, ende kam keqardhje që nuk munda të shkoj vetë, sepse është një koleg i nderuar. Atë çast nuk kisha ndonjë ide, por i thashë se e kisha vënë re këtë gjë. Artiste, mes tyre edhe shkrimtare, shoh gjithnjë e më pak në ngjarjet kulturore. Në promovimet e librave kjo është më e dukshme. U përpoqa t'i bëj një shpjegim atë ditë, se mund të ishte një lloj "hakmarrjeje" ndaj shpërfilljes që shoqëria shqiptare i bën zërit të tyre. Vitë të shkuara kam dëgjuar një kolegun tim të thoshte në një intervistë se gratë janë të zonja për fëmijë dhe lot, pra letërsia nuk hynte në domenin e tyre. Unë mendoj se as në domenin a tij, jo se jo. Çuditërisht, gazetarja që e intervistonte nuk e njihte gjininë e saj, se mund ta kishte pyetur se cilën nga mjeshtrit e botës letrare kishte lexuar ai, dhe nuk kishte pelqyer, sepse shqipare nuk duhet të kishte lexuar. Unë nuk jam shkrimtare feministe, pasi besoj se shkrimtari në procesin e tij krijues, nuk mund të ketë gjini, por edhe sepse besoj se treni i feminizmit na ka kaluar me kohë, ose nuk do të vije kurrë, pasi ende ua presim kokën me sopatë grave për "nder", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtarja nga Tirana, Flutura Aça.

NËSE QEVERIA HARADINAJ
REZISTON?

"Nëse qeveria Haradinaj reziston dhe nëse dialogu bllokohet, deri sa të ndodhin ndryshime në Bruksel e eventualisht edhe në Uashington, kjo do të shndërrohet në fitore të pakthyeshme të Kosovës. Si? 1. Kosova do të dilte nga tutela neokolonialiste ku e mbajnë SHBA dhe Brukseli, tash njëzet vjet. 2. Kosova do të eliminonte nga skena e vet politikanët që nuk e durojnë presionin e të huajve. 3. Kosova do të dëshmonte se i mbijeton presionet e Serbisë. 4. Kosova do ta sfidonte edhe lidërsipin e Tiranës, së paku këtë që shohim në versionin e një lideri kundërthënës e aventurier siç është Edi Rama", ka shkruar një status në Facebook, Milazim Krasniqi.

QË NGA KOHA E RILINDËSEVE
NE NUK JEMI MËSUAR ME
THËNË JO

"Taksa duhet të hiqet! Çfarë palogjike është kjo, o Zot!!

Të vetmin aset burrnje shtetërore që e kemi në dorë për momentin, edhe ai na pengon e po na vjen i rëndë. Asryeja është, mendoj unë, sepse që nga koha e rilindasëve ne nuk jemi mësuar me thënë JO. Shtetnisht, burrnisht e me krenari atdhetarie...!!!", ka shkruar një status në Facebook, teologu, Mustafë Bajrami.

MEDIACitate

PSE SERBIA DO
QË "ZGJIDHJA"
ME KOSOVËN
TË BËHET
GJATË KOHËS
SË TRUMPIT

Politikanë nga Serbia po e shfaqin haptas dëshirën e vet që kontestin me Kosovën, ose ajo që ata e quajnë "çështje e pazgjidhur e Kosovës", të rregullohet gjatë administratës së presidenti aktual amerikan Donald Trump. Sipas gazetës "Blic" të Beogradit, edhe pse nuk dihet se kush do t'i dalë përballë Trumpit në zgjedhjet e vitit 2020, ndërriimi i administratës dhe ardhja e demokratëve në Shtëpinë e Bardhë, gjithsesi se do të ndikonte në zhvillimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ministri serb i Punëve të Jashtme Ivica Daçiç për këtë gazetë ka vlerësuar se "largimi i Trumpit do të ishte i keq për zgjidhjen nyjës kosovare". "Kjo nuk do të na përgjigjej. Sërish do të ketë ultimatum – çdo gjë tashmë është e zgjidhur, Kosova është e pavarur dhe neve na mbetet vetëm ta njohim pavarësinë e saj", citohet të ketë thënë Daçiç. Dragan Gjukanović nag Qendra për Politikë të Jashtme beson se edhe administrata e ardhshme do të mbetet po në këtë prag kur bëhet fjalë për Kosovën.

"Administrata e re do ta kishite po këtë qasje të vendosur që çështja të zgjidhet. Për më tepër, presioni për përfundimin e dialogut do të ishte edhe më i mundshëm dhe më i fuqishëm. Veç kësaj, ndikimi amerikan te pala kosovare në kornizat për zgjidhje përfundimtare do të mund të ktheheshin më shumë drejt kërkesave të Prishtinës", ka thënë Gjukanović për gazetën.

Zgjedhjet në SHBA duhet të mbahen në vjeshtën e vitit 2020 e presidenti i zgjedhur detyrën e merr më 21 janar 2021.

Marko Savković nga Forumi i Beogradit për politikë të përsosur thekson se ka mbetur edhe pak kohë për zgjidhjen e kontestit me Kosovën. "Ajo që do të bëhet në gjysmën parë të vitit 2020, do të bëhet. Pas kësaj është rregull që në gjashtë muajt e fundit të administratës të mos merren vendime të mëdha nga Shtëpia e Bardhë.

(Blic, 25 shkurt)

Ndarjet në koalicionin qeveritar tashmë kanë dalë në shesh. BDI dhe LSDM akuzojnë njëra-tjetren se kanë "shpëtuar" ish-kryeparlamentarin Trajko Veljanovski nga përgjegjësia për 27 prillin e përgjakshëm në Parlament në vitin 2017. Zaevi shprehet i revoltuar me BDI-në, Xhaferi akuzon Zekirin. Opozita shqiptare ndërkohë kërkon dorëheqje dhe zgjedhje të parakohshme

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 25 shkurt - Ndryshe siç ishte parashikuar, Parlamenti i Maqedonisë së Veriut ka anuluar dje vazhdimet e dy seancave 86-të dhe 88-të të caktuara paraprakisht me marrëveshje të koordinatorëve të grupeve parlamentare. Interpelanca e punës së ministrit të Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, kërkesë e deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe imuniteti i deputetit Trajko Veljanovski kanë qenë dy pikat për të cilët është dashur të debatohet, por që pa asnjë sqarim, që të dyja seancat janë anuluar. Ndarjet në koalicionin qeveritar tashmë kanë dalë në shesh. BDI dhe LSDM akuzojnë njëra-tjetren se kanë "shpëtuar" ish-kryeparlamentarin Trajko Veljanovski nga përgjegjësia për 27 prillin e përgjakshëm në Parlament në vitin 2017. Koordinator i LSDM-së, Jovan Mitrevski kërkoj përgjigje nga kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, se pse të dielën mbrëma e ndërpreu seancën plenare në të cilën pikë e vetme e rendit të ditës ishte marrja e imunitetit të deputetit Trajko Veljanovski.

"Kishte kuorum për votim dhe deputetët e shumicës ishin të gatshëm të sjellin vendim me të cilin do t'i mundësohet gjykatës t'i vazhdojë pa ndërprerë proceset e tij. Deputetët ishin të gatshëm të mundësojnë që drejtësia për 27 prillin të çohet deri në fund, por kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi e ndërpreu seancën dhe nuk lejoi të votohet për marrjen e imunitetit të deputetit të akuzuar Trajko Veljanovski. Talat Xhaferi duhet t'i përgjigjet opinionit, qytetarëve, pse e ndërpreu seancën për marrjen e imunitetit të deputetit Trajko Veljanovski dhe pse lejoi rrëmujë në seancën e mbrëmshme", theksoi Mitrevski, ndërsa shtoi se për Veljanovskin duhet të vlejné procedurat dhe rregullat e njëjta si dhe për çdo deputet tjetër. "Parlamenti duhet të veprojë si ka vepruar gjithmonë për të gjithë deputetët tjerë të cilët janë akuzuar dhe për të cilët është kërkuar vendim për përgjegjësinë e tyre. Për shkak të kësaj, në Parlament sot nuk ka kushte të vazhdojnë aktivitetet tjera", tha Mitrev-

IMUNITETI I VELJANOVSKIT PËRPLAS LSDM-BDI

NGËRÇ I RI BRENDIA KOALICIONIT



ZAEVI I REVOLTUAR ME XHAFERIN

Kryeministri Zoran Zaev thotë se Parlamenti të dielën mbrëma është dashur ta ndjek praktikën e deritanishme në lidhje me vendosjen e marrjes së imunitetit të deputetit dhe ish kryetar i Parlamentit, Trajko Veljanovski. Me këtë, konsideron, do të dëshmohej se të gjithë deputetët janë të barabartë, ndërsa do të lihej edhe mundësia e gjykatës të vendosë. "Procedurat dhe rregullat duhet të vlejné njëloj për çdo deputet pa dallim nëse ai është ish kryetar i Parlamentit ose jo, për atë duam qytetarëve


t'u dërgojmë porosi se të gjithë janë të barabartë para ligjit, ndërsa pjesa tjetër është punë e organeve të gjyqësisë. Parlamenti duhet ta zbatojë praktikën e deritanishme. Në lidhje me atë që ndodhi shprehim pakënaqësi të madhe dhe revolt", tha Zaev duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve para prezantimit të Planit operativ për punësimin në vitin 2019.



GRUBI FAJËSON BOGOEVSKIN

Sekretari organizues i BDI-së, Artan Grubi, dje në konferencë për shtyp në Parlament, përgjegjësinë për mosvotim të vendimit për heqjen e imunitetit të deputetit për Trajko Veljanovskin e locoi tek kryetari i Komisionit për çështje të rregullores dhe mandatit dhe imunitetit, Pavle Bogoevski. "BDI e mbështetë plotësisht sundimin e së drejtës pa ndikime partiake, politike, etnike apo çfarëdo ndikime të tjera. Në mbledhjen e mbrëmshme në kohën e caktuar të gjithë deputetët e BDI-së ishin të pranishëm në mbledhje, nga kryetari Ahmeti deri te deputeti i sëmurë Agim Shaqiri në mënyrë që të votojmë për marrjen e imunitetit. Për fat të keq, në mbledhje deputetët nuk mundën të përmbahen nga ofendimet ndaj kryetarit të

Kuvendit në momentin e votimit. Asgjë nga ajo që ndodhi, nuk do të ndodhte, nëse kryetari i Komisionit për çështje të rregullores dhe mandatit-imunitetit e vendoste vendimin në votim në orën 23, siç ishim dakorduar paraprakisht, nëse ai nuk do të merrej vesh me VMRO-DPMNE-në, duke e përjashtuar BDI-në dhe ta vendoste në marrëveshje të përbashkët me ta vendimin për votim në orën 21:00, pa na informuar dhe pa na pritur", theksoi Grubi, ndërsa ka shtuar se asgjë nga ajo që ndodhi mbrëmë, nuk do të ndodhte, nëse disa nga deputetët nuk do të ngriteshin dhe me fjalë ofenduese, sharje dhe gjuajtje të stilolapsave ndaj spikerit Xhaferi nuk do ta pengonin aktin e votimit disa minuta para mesnatës.



ski. Është përgjigjur kryeparlamentari Talat Xhaferi. Para gazetarëve, Xhaferi tha se seancën e ndërpreu për shkak të sjelljes së deputetit Muhamed Zekiri nga LSDM-ja, i cili tha se koha ka kaluar dhe se duhet të votohet. "Nuk e kam shpëtuar Trajko Veljanovskin e askënd, seanca është ndaluar pasi që ka kaluar koha për miratim vendimi dhe për shkak të sjelljes së deputetëve", tha Xhaferi.

Xhaferi midis të tjerave iu përgjigj edhe thirrjes së LSDM-së dhe Aleancës për Shqiptarët për paqartësinë e procedurës së tij që rreth mesnatës - pa asnjë lloj elaborimi, e ndërpreu seancën në të cilën do të debatohet për marrjen e imunitetit të deputetit të VMRO-së dhe

ish paraardhësit të tij. "Talat Xhaferi nuk është zgjedhur me sakrificën e askujt. Talat Xhaferi është zgjedhur kryetar parlamenti me vullnetin e shumicës, me procedurat e parapara, i përgjigjet popullit dhe jo shumicës e as deputetëve që nuk e kanë kryer punën e tyre. Puna e Kuvendit është e përshkruar me Rregullore dhe Kushtetutë. Talat Xhaferi ka vepruar konform rregullores. E ka gabim dikush nëse dikush mendon se dikush ka ndikuar tek unë. Të gjithë ata që mendojnë se jam politikan Fejsbuku unë nuk merrem me Fejsbuk", tha Xhaferi, ndërsa faji kryesor për këtë pat-zion është në Komisionin për çështje të rregullores dhe çështjeve të mandatit dhe imunitetit, i cili nuk

solli propozim -vendim sipas të cilit do të drejtohej parlamenti. Xhaferi konsideron se pa marrë parasysh që imuniteti i Veljanovskit nuk është hequr, gjykata mund të vazhdojë me procedurën.

Megjithatë, reagime të shumta kanë ardhur nga opozita shqiptare. "E vërteta e zhveshur. Dje Agimi sot Talati. Imagjinoni njeriu që u zgjodh kryetar Parlamenti nën brohoritje dhe zhurmë pa mikrofon përpara tij, dje (gjoja) i pengoi vetëm një zë për ta hedh në votim propozimin për marrjen e imunitetit të Trajko Veljanovskit. Ishte një zë apo janë shumë afera, mes të cilave edhe 27 prilli (për të cilën Veljanovski ka shumë çka mund të zbuloj) që e detyruan kreun e BDI-së të bëj


skenarin e mbrëmshëm? Është dora e zgatur apo bishti i kapur!?", thotë Ziadina Sela i Aleancës për Shqiptarët, ndërsa kërkoj dorëheqjen e Xhaferit nga posti i kryeparlamentarit. "Xhaferi duhet të tërhiqet nga funksioni, sepse pas gjithë kësaj që bëri mbrëmë, nuk e ka dinjitetin për të vepruar", tha Sela, duke kërkuar zgjedhje të parakohshme parlamentare, sepse konsideron se të seanca e së dielës mbrëma ishte një skenar i ish-partnerëve të koalicionit VMRO-BDI.

"BDI, së bashku me deputetin Agim Shaqirin, kryetarin e Parlamentit Talat Xhaferin, duke mbrojtur Trajko Veljanovskin, dhe duke mos ua dorëzuar atë drejtësisë, goditën mbi ligjin, mbi votuesit e tyre dhe tradhtuan edhe miqtë tanë të SHBA-ve dhe BE-së që presin instalimin dhe funksionimin e drejtësisë. BDI, ky bisht i kapur i VMRO-DPMNE, peng i kimit dhe i korrupsionit, që pamundësoi marrjen e imunitetit të deputetit Trajko Veljanovski, i dyshuar si organizator Kryesor i ngjarjeve të përgjakshme të 27 Prillit, flet për dyshimin se edhe BDI është bashkëorganizator i dhunës së 27 Prillit dhe se si duket është e detyruar ti mbroj të akuzuarit e VMRO-së?", thonë në ASH, ndërsa shtojnë se kryeparlamentari veproi njëjtë si presidenti Ivanov, i cili refuzoi ta nënshkruaj Ligjin e Gjuhës dhe të ratifikojë Marrëveshjen e Prespës, edhe pse Ligji dhe kushtetuta e RMV e obligonte atë. Ka reaguar edhe partia e Bilall Kasamit. Lëvizja BESA në një reagim drejtuar mediave, ka akuzuar se "aktrimi i realizuar nga kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi dhe deputetët e BDI-së, mund të konkurrojnë lirisht për çmimin 'Oskar' për aktrim".

"Për fat të keq, u dëshmuar edhe njëherë konstatimi jonë se ende gjysma e regjimit vazhdon të jetë pjesë e pushtetit dhe pasojat e këtij regjimi si duket po kaplojnë pushtetin në tërësi dhe jo rastësisht po dëshmohej se BDI vazhdon të mbetet partneri me dëshiruar për partitë maqedonase. Pasi që Parlamenti i Maqedonisë së Veriut po shndërrohet në çerdhe për mbrojtje të njerëzve që cenuan sigurinë e shtetit nuk na mbetet gjë tjetër që të kërkojmë sa më shpejt shpërbërjen e Parlamentit dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme dhe aty qartazi të shihet verdikti i popullit a do lejojnë qytetarët që me votën e tyre të përkrahin deputetë që do vihen në shërbim të kimit. Nga gjithë analizat e deritanishme rezultojnë se kjo Qeveri dhe kjo shumicë parlamentare ka dështuar në luftën ndaj kimit, korrupsionit dhe nepotizmit prandaj Lëvizja Besa zgjidhjen e vetme e sheh në zgjedhje të parakohshme", thuhet në reagim.

EDHE NJË AKUZË E ZEKIRIT DREJTUAR BDI-SË

Deputeti i LSDM-së, Muhamed Zekiri, i hodhi poshtë akuzat se ai ka faj se pse nuk është votuar marrja e imunitetit të deputetit, Trajko Veljanovski. Tha se nuk e ka ofenduar Talat Xhaferin. "Kërkoj që ta lexojë përfundimin që të votojmë para mesnatës", deklaroi Zekiri. Ai shtoi se nuk ka pasur situatë të nxitur që të ketë nevojë për ndërprerjen e seancës. "Ai është një deputet me përvojë, di të



menaxhoje edhe me seanca më tensionuese", deklaroi Zekiri për Xhaferin dhe shtoi se përgjegjësinë nuk duhet që ta hedh te të tjerët. "Xhaferi a punon me vetëdije për VMRO-DPMNE-në", pyeti Zekiri dhe në lidhje me idenë për ngritjen e interpelancës ndaj kryeparlamentarit tha se në mënyrë shtesë do të vendosin në grupin e deputetëve.

Zaharieva tha se pas ndërprerjes dhjetëvjeçare, në fillim të muajit mars do të përbëhet Komision ekonomik i përbashkët, temë kryesore e së cilës do të jetë infrastruktura. Paralajmëroi edhe forum të biznesit me pjesëmarrje të mbi 100 kompanive bullgare

Sofje, 25 shkurt - Ratifikimi i shpejtë i Protokollit për pranim në NATO, në Parlamentin bullgar është shembull i mirë për atë se sa e fuqishme është mbështetja e Bullgarisë dhe sa për ne në mënyrë strategjike është e rëndësishme Maqedonia e Veriut të bëhet pjesë e Aleancës, deklaroi shefja e Diplomacisë bullgare Ekaterina Zaharieva pas takimit të sotëm me ministrin e Punëve të Jashtme Nikolla Dimitrov në Sofje. "Shpresoj se në dhjetor në Londër do të jeni aleat me të drejtë të plotë dhe se deri atëherë do të përfundojë ratifikimi i Protokollit në të gjithë parlamentat nacional. E rëndësishme është në qershor t'i filloni edhe negociatat për anëtarësim në BE", deklaroi Zaharieva. Ajo shprehu edhe kënaqësi nga puna e Komisionit të përzier ekspert Maqedoni-Bullgari për çështje arsimore dhe historike, por edhe shpresë se do të intensifikohet bashkëpunimi i biznesit mes dy vendeve.

Zaharieva tha se pas ndërprerjes dhjetëvjeçare, në fillim të muajit mars do të përbëhet Komision ekonomik i përbashkët, temë kryesore e së cilës do të jetë infrastruktura. Paralajmëroi edhe forum të biznesit

DIMITROVI NË SOFJE

MAQEDONIA NË NATO, INTERES I PËRBASHKËT



me pjesëmarrje të mbi 100 kompanive bullgare. "Duhet ta rregullojmë padrejtësinë historike të infrastrukturës së keqe që e kemi mes dy shteteve, duhet ta simulojmë biznesin dhe qytetarët e dy vendeve të bashkëpunojnë, të lidhen dhe të ndërtojnë miqësi në bazë të së vërtetës", tha Zaharieva. Biznesit, shtoi "i nevojitet infrastrukturë sepse është mëkat të kaloni 288 kilometra për katër orë".

Ministria bullgare e Punëve të Jashtme potencoi se interesi i kompanive bullgare për investime në Maqedoninë e Veriut dyfish është rritur, ndërsa pret trendi i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ministri Dimitrov vlerësoi se pas nënshkrimit të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë është bërë përparim i madh në bashkëpunimin mes Shkupit dhe Sofjes. Afrimi mes dy vendeve, thotë Dimitrov, nuk duhet të jetë vetëm politik por edhe ekonomik. Ai shprehu falënde-

rim për mbështetjen bullgare për në NATO dhe BE. "Kemi interes të jemi shumë më afër me Bullgarinë. Kjo është për interes reciprok dhe për atë duhet të tregojmë urtësi dhe vizion", tha ministri Dimitrov. Sipas tij, duhet të rregullohen të gjitha gabimet historike mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut që të mund të rregullohen marrëdhëniet bilaterale në baza të shëndosha. Duhet të bëjmë gjithçka, tha, të dy vendet të vazhdojnë të mbesin miqësore. Maqedonia e Veriut, siç u shpreh Dimitrov, ka shumë arsye që të shpresojë se në qershor do të vendoset data për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian pasi ka realizuar pjesën më të madhe të detyrimeve të përcaktuara nga Brukseli.

"Ne kishim raport të shkëlqyer qershorin e vitit kaluar dhe Bashkimi Evropian tha se rruga deri tek fillimi i bisedimeve po "vizatohet" (shtrihet qartë); ven-

dimin e projektuan për qershorin e këtij viti. Do të jetë problem i madh për kredibilitetin e tërë procesit të aderimit të politikës së BE-së ndaj Ballkanit nëse nuk mbështetet sukcesi i vendit tonë, që pati sukses në pastrimin e rrugës e cila ishte me shumë vështirësi ishte barrikaduar seriozisht viteve të fundit, që nga viti 2005", vlerëson Dimitrov. Sipas tij, Maqedonia e Veriut ka arritur të instalojë mekanizma të shëndoshtë për të parandaluar korrupsionin dhe për të mundur funksionimin e shtetit ligjor. "Kemi argument të madh, jo vetëm me ligjin e ri, me të cilin u formua Komisioni për Antikorrupsion, por edhe - si i zgjedhëm antikorrupsionarët. Do të thotë, kemi Komision me dhëmbë, që mund të kafshojë, të përbërë nga njerëz që u zgjedhën në një proces shumë transparent, publik, dhe prej gjithkujt pa marrë sinjale se atje kemi një ekspertizë të jashtëzakonshme".



VMRO ankohet nga kërcënimet e Grupit të Kumanovës

Shkup, 25 shkurt Çdo ditë jemi dëshmitarë se si anëtarët e grupit të Kumanovës dhe mbështetësit e tyre dërgojnë porosi me të cilat kërkojnë gjak dhe hakmarrje ndaj të gjithë kundërshtarëve politik të Zoran Zaevit. Kërcënimet e grupit të Kumanovës të cilëve Zaevi u ka premtuar amnisti dhe hetim ndërkombëtar nuk ndalën, ndërsa pushteti hesht. Zoran Zaev dhe bashkëpunëtorët e tij të cilët janë përgjegjës për sigurinë e shtetit nuk ndërmarrin asgjë. Kështu thuhet në reagimin e VMRO-së drejtuar mediave, sipas të cilës, hapen dyshime serioze se kërcënimet e shpeshtuara nuk janë të rastësishme dhe nuk janë pa mbështetje të strukturave të pushtetit.

"E dukshme është se pushteti nuk ka për qëllim të ndërmarë asgjë kundër atyre të cilët kërcënohen. A është kjo për shkak të mbështetjes të cilën ua ka premtuar Zoran Zaev në lidhje me ngjarjet në Lagjen e Trimave? Nën kërcënim janë jetët e të gjithë kundërshtarëve politik të Zoran Zaevit të alobar dhe kartelit të tij kriminal në pushtet. Përpjekja për linçimin e ish ministrave Spiro Ristovski dhe Mile Janakieski është vetëm njëra nga aktet e shumta skandaloze të cilat e konfirmojnë atë. Pushteti di vetëm në orët e hershme të mëngjesit të bastisë nëpër shtëpi dhe të arrestojë qytetarë të pafajshëm të cilët kanë shkruar statute ku e kritikojnë Zoran Zaevin, ndërsa tani nuk ka as deklaratë për atë se kush i dërgon kërcënimet. Nuk ka as hetim për motivet as nuk ndërmerret asgjë që të ndërpriten qëllimet e Grupit të Kumanovës i cili kërcënohet me jetë të njerëzve", thuhet në reagimin e VMRO-së.

Gjykata nuk guxon të mbetet peng i pushtetit dhe duhet t'i rishqyrtojë vendimet për arrestimin e Spiro Ristovskit dhe Vlladimir Atanasovskit, Hristijan Delevit dhe të gjithë kundërshtarët tjerë politik të cilët janë viktimë e ndjekjes së këtij pushteti, vazhdon më tej reagimi. "Gjithashtu MPB detyrohet menjëherë t'i zbulojë dhe sanksionojë personat të cilët kërcënohen. Përgjegjësi për këto incidente duhet të ketë. Opinioni pret përgjegjësi por edhe dorëheqje. Ndjekja e kundërshtarëve politik gjë e cila ndodh në Maqedoninë e Veriut është turp për një vend i cili veten e quan demokratik dhe pretendon të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian. Për opinionin është e qartë se Zaev dhe karteli i tij kriminal janë në panikë dhe për atë janë të gatshëm me çfarëdo lloj metoda ta ndalojnë çmontimin tyre nga pushteti që qytetarët do ta bëjnë në zgjedhje"

XHAFERI TAKOI MINISTREN E MBROJTJES TË SHQIPËRISË

STABILITETI I BALLKANIT, SIGURI PËR EVROPËN

Shkup, 25 shkurt - Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi realizoi takim me ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Olta Xhaçka, në të cilën bashkërisht u shpreh kënaqësi për ratifikimin e Protokollit për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO në Parlamentin shqiptar. Në takim u theksua bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Tiranës dhe Shkupit në vitet e kaluara, si edhe përpjekjet e Shqipërisë për mbështetjen e shtetit tonë në rrugën dhe zhvillimin evropian. Siç njoftoi pres shërbimi i Parlamentit, Xhaferi theksoi se Republika e Maqedonisë së Veriut është në rrugën e sigurt drejt NATO-s, ndërsa shteti punon me përkushtim në




përbushjen e reformave të domosdoshme për marrjen e datës për fillimin e negociatave me BE-në. "Jemi të vetëdijshëm se ky proces nuk është i lehtë, por Parlamenti dhe Qeveria punojnë me të gjitha forcat dhe kapacitetet për arritjen e qëllimit të dëshir-

ruar", tha Kryetari Xhaferi dhe e potencoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit të të gjithë komponentëve politikë për përbushjen e obligimeve për të mirën e qytetarëve dhe të shtetit. Ministria Xhaçka, drejtoi urime për hapat e guximshme politike për

zhbllokimin e procesit të integritetit euroatlantike. Ajo e përsëriti edhe mbështetjen e fuqishme të Shqipërisë për proceset reformuese nga agjenda jonë e BE-së dhe ofroi këmbim të përvojave në aspektin bilateral për përforsimin e kapaciteteve. Ajo theksoi se fillimi ynë final duhet të jenë perspektivat euroatlantike, duke e mbështetur njëri-tjetrin, ndërsa shembulli më i mirë për këtë për momentin është Republika e Maqedonisë së Veriut. Në këtë mënyrë duhet të këmbëjmë mesazhe politike ndërmjet dy vendeve që të tejkalohen më lehtë sfidat. Të dy bashkëbiseduesit thanë se stabiliteti i vendeve të Ballkanit do të thotë siguri për vendet e Evropës.

I lindur dhe i rritur në Shkup, por pa të drejtë shtetësie. Ky është fati i Ramadan Lutës nga lagja Serava, të cilën shteti i Maqedonisë së Veriut e numëron në mesin e shtetasve të huaj edhe pse ai jeton në shtëpinë e vet nga dita që ka ardhur në këtë botë. Por jo vetëm Ramadani. Fatin e tij e ndajnë edhe qindra shqiptarë tjerë

RRETH 1 MIJË KËRKESA PËR SHTETËSI SHQYRTOHEN NË MPB I HUAJ NË SHTËPINË E TIJ!




RAMADAN LUTA

Problemi kryesor ishte se unë jam shqiptar. Këtë në sy ma kanë thënë përgjegjësitë e institucioneve. Pastaj problem shtesë ishte pse unë prindërit me prejardhjen i kam nga Kaçaniku i Kosovë. Në mesin e familjes jam i vetmi që nuk kam shtetësi. Fëmijët, bashkëshortja dhe të afërmit tjerë të gjitha kanë shtetësi. Një tentim tjetër për të fituar shtetësinë ishte viti 2004. Disa shok më bindën që ti përpi të gjitha ofendimet dhe nënçmimet. Kështu edhe bëra. Fitova letërnjoftim dhe pasaportë për të huaj, por me një kusht që në ato dokumente të figurojë se unë jam nga Serbia dhe Mali i Zi

takon është diskutuar se duhet të bëhet intervenimi në Ligjin për shtetësi, ngjashëm si në vitin 2004, me qëllim që qytetarët që kanë fakte dhe rrethana të cilat mund të dëshmojnë lidhjet juridike me sovranitetin e shtetit, përmes faturës apo ndonjë certifikatë të karakterit publik të arrijnë deri te shtetësia. Në kohë kur nga MPB, thonë se janë bërë intervenime në disa udhëzime administrative të DSK-së, për fitimin e shtetësisë, Avokati i Popullit, për gazetën KOHA, thotë se DSK-ja është njëra ndër pengesat kryesore sepse shumë qytetarë nuk arrijnë të fitojnë shtetësinë. Zyrat e Ombudsmanit, është institucioni i dytë në shtet i cili i trajton dhe shqyrton ankesat dhe parashtrirat e qytetarëve për fitimin e shtetësisë.

“Breng e jona është që ende kemi qytetar që me prejardhje janë nga ish-Republikat e Jugosllavisë, të cilët edhe kësaj ditë nuk kanë arritur të rregullojnë statusin e shtetësisë. Kemi mjaftë ankesa. Shqetësuese është ajo që përsëritet gjatë viteve e që lidhet me punën e DSK-së. Ajo jep qëndrime (vendime) të njëanshme dhe të njëjtat nuk i arsyeton. Në të shumtën e rasteve ajo e informon MPB se jep mendim negativ për një person të caktuar. Ndërkohë nuk e arsyeton atë. Kjo është e palejueshme”, thotë ombudsmani Ixhet Memeti. Sipas të dhënave statistikore të MPB, për momentin janë duke u shqyrtuar rreth 1 mijë kërkesa për fitimin e shtetësisë, duke mos bërë dallime në baza etnike. Ndërkohë para zyrës së Avokatit të Popullit, brenda një viti dorëzohen mes 50 dhe 70 parashtrira për shkelje të të drejtës për shtetësi.



IXHET MEMETI

Breng e jona është që ende kemi qytetar që me prejardhje janë nga ish-Republikat e Jugosllavisë, të cilët edhe kësaj ditë nuk kanë arritur të rregullojnë statusin e shtetësisë. Kemi mjaftë ankesa. Shqetësuese është ajo që përsëritet gjatë viteve e që lidhet me punën e DSK-së. Ajo jep qëndrime (vendime) të njëanshme dhe të njëjtat nuk i arsyeton. Në të shumtën e rasteve ajo e informon MPB se jep mendim negativ për një person të caktuar. Ndërkohë nuk e arsyeton atë. Kjo është e palejueshme

Tashmë katër vite me radhë, Ramadan Luta procedurën e fitimit të shtetësisë e zhvillon para zyrës së Avokatit të Popullit. Ai ndonëse shpreh optimist se të drejtën e shtetësisë do ta fitoj, nuk e ka qartë se si mundet disa sektorë të MPB-së, të njohur për shkeljet e shumta ligjore, të vendosin për fatin e mijëra qytetarëve, përfshi dhe fatin e tij.

“Unë jam i hapur për çfarëdo debati dhe me cilido qoftë. Le ta shkruajnë atë që e mendojnë. Megjithatë, nuk e kam të qartë se si është mundur që një sektor si ajo e farë Drejtorisë së Pestë, të japin pëlqimin për fitimin e shtetësisë, kur të njëjtit futen në Parlament dhe kryejnë tentim vrasje të deputetëve. Ndërkohë duhet të japin vlerësim se a duhet të më pranojnë mua në shtetin ku ka lindur apo jo. Kjo është një paradoks”, thekson Luta.

Njëherit, Luta nuk është i vetmi i cili vite me radhë përballet me problemin e fitimit të shtetësisë. Një hall të tillë e ka edhe motra e Hyseinit nga lagja Shuto Orizare e Shkupit. Sipas tij, institucionet e Maqedonisë duhet ti respektojnë të drejtat e njeriut, respektivisht të drejtat dhe liritë e njeriut që burojnë nga Konventat Ndërkombë-



AGIM NUHIU

Viteve të fundit për sa unë jam në këtë dikaster, së bashku me ministrin Oliver Spasovski, e kemi urdhëruar Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim të bëjë ripërtirjen e udhëzimeve administrative, me qëllim që procedura për dhënien e shtetësisë, (ku kishte më tepër ngecje) të bëhet në mënyrë më efikase dhe më të shpejtë. Pa pasur hile dhe diskriminim. Rezultat e këtyre intervenimeve në kuadrin e akteve nën ligjore janë të dukshme. Vetëm viteve të fundit janë dhënë tre mijë shtetësi qytetarëve shqiptar

tare. “Motra ime për 18 vite nuk ka shtetësi. Ajo është refugjat nga Kosova, atje ishte e martuar. Megjithatë, ja ende s’ka shtetësi. Djemtë nuk kujdesen për të. Tash jeton me mua”, deklaroi Hyseini. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu, kur flet për çështjen e të drejtës së shtetësisë, thotë se bëhet fjalë për një problem shumë dimensional-institucional. Ai, thotë se partia e tij BDI, këtë problematikë e ka trajtuar me seriozitetin më të lartë.

“Viteve të fundit për sa unë jam në këtë dikaster, së bashku me ministrin Oliver Spasovski, e kemi urdhëruar Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim të bëjë ripërtirjen e udhëzimeve administrative, me qëllim që procedura për dhënien e shtetësisë, (ku kishte më tepër ngecje) të bëhet në mënyrë më efikase dhe më të shpejtë. Pa pasur hile dhe diskriminim. Rezultat e këtyre intervenimeve në kuadrin e akteve nën ligjore janë të dukshme. Vetëm viteve të fundit janë dhënë tre mijë shtetësi qytetarëve shqiptar”, thotë zëvendës ministri Nuhiu.

Mes tjerash Nuhiu, shton se në kuadër të subjektit politik që ai i

MPB e pret raportin nga burgu i Shutkës

Shkup, 25 shkurt - Ministria e Punëve të Brendshme e pret raportin e burgut të Shkupit dhe të Drejtorisë për kryerjen e sanksioneve në lidhje me incidentin e javës së kaluar kur të burgosurit ish ministrat Mile Janakieski dhe Spiro Ristovski pas zënkes verbale ishin sulmuar nga disa të burgosur.

“Presim që të përfundojë hetimi i brendshëm, sepse burgu dhe Drejtoria janë të obliguar për sigurimin e brendshëm dhe në bazë të këtyre raporteve nëse kemi urdhër për çfarëdo lloj veprimtarie do të veprojmë”, tha Spasovski sot në konferencën për shtyp. Drejtori i burgut “Shkupi”, Gjoko Kotevski, paralajmëroi se sot do të dorëzohet raporti për incidentin, së bashku me dorëheqjen e tij, të cilën javën e kaluar e kërkoi kryeministri Zoran Zaev.

Më 21 shkurt rreth orës 13 gjatë shetitjes së rregullt të të burgosurve ka ardhur deri te incidenti verbal i shkaktuar nga personi S.R. drejtë personit L.K. i cili më vonë ka kaluar në zënkë të lehtë fizike e cila menjëherë ishte ndërprerë nga shërbimet e burgut. Rreth orës 13:45, përsëri gjatë shetitjes së rregullt të të burgosurve ka ardhur deri te incidenti tjetër verbal i shkaktuar nga M.J. drejtë personit E.K. i cili më vonë kaloi në zënkë fizike e cila menjëherë ishte ndërprerë nga shërbimet e burgut. Për të dy incidentet janë grumbulluar deklarata me shkrim nga dëshmitarët e rastit dhe ishte njoftuar gjykatat adekuate, kumtuan javën e kaluar nga burgu “Shkupi”. Pas incidenteve për Ristovskin dhe Janakieskin menjëherë ishin siguruar kontrolle dhe kujdes adekuat nga mjeku, ndërsa pastaj Ristovski nuk kërkoi ndihmë mjekësore shtesë, përderisa Janakieski ishte ankuar për dhimbje për çka ishte dërguar në SPQ “8 Shtatori”.

Janakieskit dhe Ristovskit, të mërkurën iu ishte caktuar paraburgim prej 30 ditëve në lidhje me ngjarjet në Kuvend të 27 prillit të vitit 2017, ndërsa pastaj Prokuroria masën e paraburgimit për ish ministrin e Transportit dhe Lidhjeve e kishte ndryshuar në arrest shtëpiak. Janakieski dhe Ristovski, së bashku me Trajko Veljanovskin, Nikolla Grueskin dhe Nikolla Boshkovskin janë të dyshuar se janë organizatorë të ngjarjeve në Kuvend më 27 prill. (O.XH)

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 25 shkurt - Fitimi i shtetësisë çdoherë ka paraqitur problem për shqiptarët në Maqedoni. Me një sfidë të tillë për gati 30 vite me radhë ballafaqohet edhe Ramadan Luta nga Shkupi. Ndonëse i lindur dhe i rritur në Shkup, ai ende llogaritet si i huaj në shtëpinë e vet. Autoritetet shtetërore të Maqedonisë të Veriut deri më tani nuk i kanë marrë parasysh faktet dhe gjendjen faktike se Luta, është rritur, ka punuar dhe ka krijuar familje në Shkup. Qasja diskriminuuese e institucioneve vendase, me theks të posaçëm të Ministrisë për Punë të Brendshme, siç thotë Luta, shtohet edhe më tepër kur ato i kërkojnë që aplikimin për shtetësi ta bën vetëm në bazë të lidhjes martesore. “Fatkeqësisht është e pakuptueshme që e vetmja rrugë që më është lënë për të fituar shtetësinë është martesë me një shtetase të Maqedonisë (i martuar për 35 vite). Ky kriter është i pavend. Nuk e kam të qartë pse duhet që unë të kërkoj shtetësinë në këtë mënyrë, kur të e njëjta më takon në bazë të lindjes. Sinqerisht kjo është e tepërt”, shpreh Luta, banor i lagjes Serava të Shkupit.

Përpjekjet e Ramadan Lutës për të fituar shtetësinë e tij fillojnë disa vite pas pavarësimit të vendit tonë. Mirëpo, nënçmimi, ofendimet dhe provokimet e shpeshta e kanë shtyrë atë që gjatë viteve të 90-ta, të tërhiqet nga kërkesa për shtetësi.

“Problemi kryesor ishte se unë jam shqiptar. Këtë në sy ma kanë thënë përgjegjësitë e institucioneve. Pastaj problem shtesë ishte pse unë prindërit me prejardhjen i kam nga Kaçaniku i Kosovë. Në mesin e familjes jam i vetmi që nuk kam shtetësi. Fëmijët, bashkëshortja dhe të afërmit tjerë të gjitha kanë shtetësi. Një tentim tjetër për të fituar shtetësinë ishte viti 2004. Disa shok më bindën që ti përpi të gjitha ofendimet dhe nënçmimet. Kështu edhe bëra. Fitova letërnjoftim dhe pasaportë për të huaj, por me një kusht që në ato dokumente të figurojë se unë jam nga Serbia dhe Mali i Zi. Këtë provokim e durova deri në vitin 2007, kur edhe u dorëzova”, thekson Luta.

Shteti së paku deri në fund të vitit pritet sërish të rrisë pagën minimale në rreth 13 mijë denarë, ndërsa do të ndihmojë një pjesë të papunëve të gjejnë punë, si dhe do ti kushtojë më shumë kohë dhe vëmendje përmirësimit të gjendjes ekonomike në Maqedoni e Veriut

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 25 shkurt - Shteti deri në fund të vitit pritet sërish të rrisë pagën minimale në së paku 13 mijë denarë, ndërsa do të ndihmojë një pjesë të papunëve të gjejnë punë, si dhe do ti kushtojë më shumë kohë dhe vëmendje, përmirësimit të gjendjes ekonomike në Maqedoni e veriut. Nga ekzekutivi parajlmëruan rritje të serishme të pagës minimale, por duke mos saktësuar se sa do të jetë shuma e rritjes.

"Deri në fund të vitit presim që sërish të rrisim pagën minimale në konsultim me komunitetin e biznesit, ku qëllimi i kësaj mase është që ajo të reflektojë edhe në rritjen e përgjithshme të pagave. Për këtë qëllim në vitin e kaluar nga buxheti i shtetit kemi mbuluar 20 deri 30 për qind të harxhimeve.", theksoi kryeministri Zoran Zaev, para prezantimit të planit operativ për punësim për vitin 2019.

Sipas tij, pritet sivjet do të ndahen 1.1 miliardë denarë, për masat e ndryshme që do të ndihmojnë të papunët që përmes rikualifikimit dhe masave të tjera të punësohen.

Nga ana tjetër, zëvendës kryeministri për çështje ekonomike, Koço Angjushev, theksoi se tani është momenti mirë që duhet ta shfrytëzojë Maqedonia e veriut, për të përmirësuar ekonominë e saj, në çka do të ndihmojë edhe

MBËSHTETJE PËR PUNËTORËT MË PAK TË PAGUAR

DERI NË FUND TË VITIT SËRISH RITJE E PAGËS MINIMALE



asistenca dhe ndihma profesionale nga Gjermania.

"Me këshilltarin special Valter Defa të deleguar nga qeveria gjermane, kemi biseduar për tërheqjen e investimeve të huaja, përmirësimin e rregullativës ligjore në favor të biznesit, eksportit të prodhimeve tona jashtë vendit, reformat në sistemin arsimor, sidomos në pjesën e arsimit dual e kështu me radhë", thotë Angjushev. Njëherësh është biseduar edhe për prioritetet qeveritare në zhvillimin ekonomi, sundimin e së drejtës, realizimin e projekteve infrastrukturore për një lidhje më të mirë me shtetet fqinje etj.

Ndryshe, përmes planit të ri operativ vendoset një theks i veçantë tek personat e papunë deri në 29 vjeç, si dhe deri tek shfrytëzuesit e ndihmës së garantuar sociale. Gjithashtu, në të parashikohen edhe mbi 43 milion denarë për zhvillimin e shkathtësive digjitale ku do të përfshihen 1323 të rinj. Në vitin 2018, plani kishte realizim prej 95 për qind. Njëherazi për herë të parë u vendos masa "Garancia për të rinjtë", që punësoi 1839 persona.

Ndryshe, Maqedonia me pagë minimale prej 196 euro apo 12.165 denarë, që vlen prej muajit mars të këtij viti, ka pozitën më të dobët në Evropë vetëm se Mali zi me pagë minimale prej 193 euro dhe Kosova. Në Shqipëri, paga minimale, sipas Eurostat, paga minimale mujore në 2019 fiksohet në 210 euro në muaj. Në Bosnje e Hercegovinë punëtorët pranojnë pagë minimale prej 208 euro. Në Kosovë, paga minimale aktualisht është e kategorizuar 130 euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare, ndërsa Ministria e Punës në Kosovë, i ka propozuar Qeverisë që paga minimale të rritet në 250 euro. Në këtë ministri thonë se propozimi për rritje të pagës minimale në 250 euro është dërguar në Qeveri, porse deri më tani nuk është vendosur në rend dite për aprovim. Në Kroaci ajo sivjet do të arrijë në 404 euro, ndërsa në Slloveni ajo ka vlerën prej 667 euro.

Në ndërkohë, Evropa ndahet si me thikë në drejtim të pagës minimale, pasi pjesa lindore në pjesën më të madhe e ka këtë shifër nën

600 euro në muaj, ndërsa ajo perëndimore, kryesisht, mbi 1000 euro në muaj.

Në Bashkimin Evropian, Bullgaria është në vend të fundit, me 286 euro në muaj. Pagë të ulët kanë edhe Serbia me 308 euro në muaj, Turqia me 422 euro dhe Letonia me 430 euro në muaj. Nga krahu i kundërt i tabelës është Luksemburgu me rreth 2000 euro në muaj, i ndjekur nga Irlanda dhe Holanda me pak më shumë se 1600 euro në muaj, të vlerës së pagës minimale.

Vlerësohet se paga minimale është mjet i politikës qeveritare që të ndërhyjë në tregun e punës me caktimin e nivelit minimal të pagave që secili person i punësuar duhet ta marrë. Në botë shumë shtete kanë përdorur këtë politikë për të vendosur pagën minimale të parashikuar me ligj ose pagën minimale sektoriale me qëllim të sigurimit të minimumit të standardit jetësor për punonjësit. Me fjalë të tjera, paga minimale e caktuar dhe e rregulluar me ligj zbatohet në shkallë vendi në të gjithë sektorët, nën të cilën punëtorët nuk mund të paguhet.

Përvoja gjermane për zhvillim të shpejtë ekonomik

Shkup, 25 shkurt - Zëvendës-kryeministri për Çështje Ekonomike Koço Angjushev dje realizoi me këshilltarin special të nominuar nga Qeveria e RF të Gjermanisë, Valter Def me të cilin ka biseduar për atë si të shfrytëzohen përvojat gjermane që të mundësohet zhvillim më i shpejtë ekonomik. Të dy bashkëbiseduesit, siç informojnë nga Kabineti i zëvendës-kryeministrit, kanë biseduar për prioritetet strategjike të Qeverisë në pjesën e ekonomisë dhe si të sigurohen parakushtet kyçe për rritje ekonomike më të shpejtë dhe të qëndrueshëm.

"Postulatet kyçe në këtë drejtim janë sundimi i së drejtës, realizimi i projekteve infrastrukturore për ndërlidhje më të mirë me fqinjët, me këtë edhe rritje të bashkëpunimit ekonomik rajonal, me të cilat do të kënaqen nevojat e tregut të punës në vend", thonë nga kabineti i zëvendëskryeministrit. Në takim të sotëm të parë, Angjushev ka theksuar se ndarja e përvojave për fondet evropiane do të jetë me rëndësi të madhe dhe do të kontribuojë për shfrytëzimin e këtyre fondeve për zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe përmirësim të standardit të jetesës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Valter Defa është përfaqësues shumëvjeçar i RF të Gjermanisë në Komisionin Evropian ku ka kryer më shumë detyra. Mes tjerash ka qenë edhe drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikë Rajonale, ndërsa e ka kryesuar edhe Drejtorinë e Përgjithshme për tatime dhe Dogana në Komisionin Evropian.

Në shtator të vitit të kaluar, ministri i Financave Tevdovski, nënkryetari i BEI, Endrju MekDauel dhe drejtori i BMMZH Martinovski nënshkruan marrëveshje për linjë të re kredituese prej 100 milionë eurove për ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Shkup, 25 shkurt - Me 15 milionë euro kredi të lira nga Banka Evropiane për Investime (BEI), do të mbështeten investimet e 39 firmave të vogla dhe të mesme, të cilat fillimisht do të hapin 160 vende të

BEI MIRATON HUAN PËR MAQEDONINË E VERIUT

KOMPLETOHET KËSTI I PARË PREJ 100 MILIONË EUROVE KREDI

reja të punës. Drejtori i Bankës Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit (BMMZH), Dragan Martinovski e ka informuar ministrin e Financave, Dragan Tevdovski se me këtë është kompletuar kësti i parë prej 100 milionë eurove nga BEI për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ndërsa gjatë kësaj jave projektet do të dorëzohen në BEI. Siç njoftuan nga kabineti i ministrit, gati 90 për qind e projekteve në këstin e parë janë investime afatgjate. Më shumë investohet në objekte afariste, pajisje dhe mjete transportuese, ndërsa më

pak në mjete qarkulluese.

Ministri Tevdovski ka theksuar se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë pjesë e rëndësishme e ekonomisë sonë, sepse ato përfaqësojnë mbi 99 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të cilat marrin pjesë në krijimin e bruto prodhimit vendor nga 55 për qind edhe në krijimin e vendeve të punës me 75 për qind. Për këtë shkak, ka theksuar ministri, Qeveria përmes kësaj linje kreditore, si dhe një varg masash të tjera angazhohet që të sigurojë qasje deri te kapitali për këto

ndërmarrje. "Kreditë e lira nga BEI për ndërmarrje të vogla dhe të mesme në vlerë të përgjithshme prej 100 milionë eurove janë të dedikuara për realizimin e projekteve të reja, punësimeve të reja, likuiditet të rritur dhe eksport të rritur për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Me këtë, por edhe përmes masave aktive për punësim dhe masat për mbështetje të ndërmarrjeve mbështetet sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i cili është me rëndësi të madhe për ekonominë", ka theksuar Tevdovski. Në shtator të vitit

të kaluar, ministri i Financave Tevdovski, nënkryetari i BEI, Endrju MekDauel dhe drejtori i BMMZH Martinovski nënshkruan marrëveshje për linjë të re kredituese prej 100 milionë eurove për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. MekDauel atëherë ka porositur se mbështetja e vendit në BE-integrimit dhe shfaqja bindje të fuqishme se po fillon periudha e thellimit të bashkëpunimit. Kjo linjë kredituese është e pesta me radhë e këtij tipi. Vlera e përgjithshme e financimit nga BEI arrin 450 milionë euro. (Z.V)

SPASOVSKI PËR DEZINFORMATAT E FUNDIT

NUK KA RASTE TË RRËMBIMEVE

“Përkundrazi, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2018 ka pasur 370 persona të denoncuar të zhdukur, ndërsa për shembull në vitin 2014 ka pasur 574”, theksoi Spasovski

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 25 shkurt - As nuk ka rast të rrëmbimit, as personave që në disa rastet e fundit i kanë humbur jetët u mungojnë organet. Këtë e konfirmoi mjekësia ligjore. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka asnjë rast të vrasjes për shkak të nxjerrjes së organeve, potencoi dje në konferencën për shtyp ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, i cili edhe një herë përgënjeshtroi ashpër informacionet dhe spekulimet në të cilat keqpërdoren rastet aktuale të personave të zhdukur. “Kategorikisht i hedh poshtë spekulimet për gjoja rrëmbies dhe gjoja shitje të organeve njerëzore. Këto janë gënjeshtër dhe dezinformata”, tha ministri. Ai theksoi se me gënjeshtër dhe dezinformata të këtuilla dëmtohet shoqëria dhe qytetarët, të cilëve me të vërtetë u nevojitet ndihmë. Apeloj që qytetarët të jenë të qetë dhe të mos bëhen pre e këtyre gënjeshtërave dhe i vlerësoi si absolutisht të pavërteta konstatimet se rritet numri i personave të zhdukur.

“Përkundrazi, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2018 ka pasur 370 persona të denoncuar të zhdukur, ndërsa për shem-



bull në vitin 2014 ka pasur 574”, theksoi Spasovski. Ministri tha se çdo qytetar mund ta verifikojë informacionin që është përhapur në opinion dhe apeloj deri te të gjithë qytetarët që këtë ta bëjnë nga burime zyrtare dhe të kontribuojnë për përhapje të panikut dhe shqetësimit.

Potencoi se në vazhdimësi në pesë vitet e fundit gjetja e personave të denoncuar të zhdukur realizohet me rreth 94 për qind. “Si prind bashkëndej me çdo prind, fëmija i të cilit është zhdukur dhe i bind ata dhe të gjithë prindërit në Republikën e Maqedonisë së Veriut se këto hetime trajtohen me seriozitet dhe përkushtim të plotë”, theksoi Spasovski.

Atyre që, siç tha ministri, përhapin lajme të rreme dhe të mbështetura në asgjë për trafikim me organet e njeriut i porositi “mos ndihmoni”. Theksoi se një pjesë e këtyre rasteve për fat të keq ndonjëherë përfundojnë si vetëvrasje që ka pasur në periudhën e fundit dhe shtoi se në

ato raste është me rëndësi të respektohet privatësia e familjeve në vend që të bëhet spektakël nga dhimbja dhe pikëllimi i tyre. Ai shprehu një sërë rekomandimesh që mund të ndihmojnë në raste të personave të zhdukur – fillimisht të kontaktohet MPB-ja, e pastaj të gjithë mund ta dinë vendin e qëndrimit të personave të zhdukur, qytetarët të bashkëpunojnë me policinë, t’i japin informacionet për miqtë dhe familjarët e personit të zhdukur, në vend të së cilës i viziton shpesh, gjendjen shëndetësore apo mënyrën e sjelljes në të kaluarën e afërt. Mes setit janë edhe ndarja e mendimeve karakteristike të personit të zhdukur, mosfshheja e informacioneve nga policia, sigurimi i fotografisë dhe lejen që policia ta ndajë me opinionin, drejtimin në stacionin më të afërt të policisë, kujdesin për personat që kanë probleme shëndetësore dhe sëmundje për të cilat e humbin aftësinë për ta kuptuar, për të cilat, siç tha, nuk duhet të lihen pa shoqë-

rim dhe mbikëqyrje. Në përhapjen e këtyre informacioneve të rreme dhe spekulimeve merr pjesë një strukturë e caktuar e njerëzve, zakonisht këtë e bëjnë për shkaqe politike dhe interesa tjera. “Është shumë e lehtë të ulet në kompjuter dhe të shkruani çka do qoftë dhe me këtë në opinion të ngreni panikë”, tha Spasovski dhe shtoi se ka pasur rast edhe me një ish-shef të MPB-së, i cili ka publikuar status në rrjetet sociale në lidhje me personat e zhdukur dhe gjoja nxjerrjen e organeve, por më vonë e ka tërhequr statusin. Ai ka falënderuar mediat që kanë qasje profesionale në këtë rast, por, siç tha, me keqardhje konstaton se ka struktura të caktuara të gazetarëve, për të cilët senzacioni është shumë më i rëndësishëm se qetësia dhe paqja jonë e përbashkët.

“Apeloj që secili me përgjegjësinë e tij të kontribuojë në mënyrë të drejtë për informimin e opinionit”, tha ministri i Punëve të Brendshme.

Fundjava me 21 aksidente, 148 gjoba për vozitje të shpejtë

Shkup, 25 shkurt - Një këmbësor e ka humbur jetën, një peron ka marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa 13 persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në gjithsej 21 aksidente që kanë ndodhur gjatë fundjavës së kaluar, në rajonin e SPB Shkup. Në 10 aksidente është shkakuar dëm material. Nga MPB-ja informojnë se gjatë fundjavës policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madhe të kundërvajtjeve. Janë sanksionuar 148 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, 16 shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritën e kuqe, gjashtë shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve në vijat e shënjuara për këmbësorë, dy shoferë për parakalim jo

të drejtë, dy shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi automjeteve në zonën e udhëkryqit, shtatë për mos posedimin e pajisjes dimërore në automjet, 17 shoferë për mos mbajtjen e rripit të sigurimit dhe 23 shoferë kanë shfrytëzuar telefon celular gjatë drejtimit të automjetit. Nga komunikacioni janë përjashtuar 42 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 45 shoferë para se të marrin të drejtën e vozitjes së automjetit dhe 15 shoferë fillestarë, si dhe një automjet me probleme teknike dhe 25 automjete të paregjistruara. Janë hasur edhe 276 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt, ndërsa me ndihmën e karrotrecit janë larguar 183 prej tyre.

KRONIKË

Tre femra nga Serbia ndalohen në një lokal në Gostivar

Policia e Gostivarit të dielën pas mesnate ka realizuar kontroll në një objekt hotelierik që gjendet në rrugën “JNA” në Gostivar, pronë e 35-vjeçarit E. A. nga fshati Llakavicë e Gostivarit. Gjatë kontrollit në objekt janë ndaluar 4 femra, prej të cilave 3 shtetase të Serbisë dhe një shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tre shtetaset e huaja, të moshave 24, 29 dhe 33 vjeçe janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Gostivarit dhe më pas janë dorëzuar në Njësinë për kriminalitet ndërkufitar, të huajt dhe riatdhesim, ndërsa diku më vonë janë dërguar përpara gjykatës për kundërvajtje në Gjykatën themelore Gostivar.

Aksidentohet çiklisti 60 vjeçar nga Tetova

Të dielën rreth orës 11 e 15 minuta, në rrugën “Ivo Ribar Lola” në Tetovë, vetura e tipit “Golf” me targa të Tetovës, e drejtuar nga 38 vjeçari Sh. S. nga Tetova ka aksidentuar çiklistin A. L. 60 vjeçar gjithashtu nga Tetova. Çiklisti i lënduar është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes dhe punohet në përcaktimin e shkakut dhe rrethanave tjera lidhur me këtë aksident.

Apelohet për mos ndezje të zjarreve

Gjatë këtyre ditëve, në rajonin e Pollogut, kanë filluar përgatitjet e para për mbjelljet pranverore. Me qëllim që të pastrojnë mbeturinat, individë të caktuar djegin barishtet e thata, të cilat në të shumtën e rasteve pasi ndizen, të njëjtat nuk kontrollohen.

Për këtë shkak, Sektori për Punë të Brendshme Tetovë apelon deri tek bujqit dhe tek gjithë të tjerët që të jenë të kujdesshëm, veçanërisht të mos ndezin zjarre të cilat shpejt mund të përhapen. Në të kundërtën ata do të ballafaqohen me sanksione rigorozë ligjore, gjegjësisht dënime me burg, ku me ligj janë paraparë prej 6 muaj deri 8 vjet burg, varësisht nga lloji i zjarreve, rrethanave dhe pasojave që ka shkakuar. (U. H)

“Fortesa 2” shtyhet për më 5 prill

Shkup, 25 shkurt - Gjykimi për lëndën “Fortesa 2” të Prokurorisë Speciale Publike, në të cilën i akuzuar i parë është ish shefi i Drejtorisë së Pestë, Goran Grujovski, si dhe gjashtë të punësuar në DSK, është shtyrë për më 5 prill. Gjykatësja Elena Ilieva Josifoviq e shtyu seancën e sotme për shkak të aktgjykimit të mosdorëzuar në Gjykatën Penale në Greqi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Maqedonisë së veriut. Të akuzuarit në rastin “Fortesa 2” gjykohen për falsifikim të dokumentacionit zyrtar dhe për shkatërrimin e dokumentacionit zyrtar në lidhje me përgjimet joligjore. Dokumentacioni ka të bëjë me dy sistemet e përgjimeve të paligjshme, të cilat sipas PSP-së, ishin shkatërruar gjatë vitit 2014.

UDHËTIMI I LINJAVE NDËR URBANE

VLON TRANSPORTI NË TË ZEZË

Transporti i paligjshëm dakordohet përmes rrjeteve sociale. Sipas pohimeve të asociacionit të transportuesve "Lindje", me ndihmën e Fejsbuk-grupeve organizohet transporti i paligjshëm thuajse nga të gjitha qytetet e shtetit



Shkup, 25 shkurt - Autobusët e linjave mes qyteteve gjatë ditëve të punës lëvizin gjysmë të zbrazët, ndërsa një pjesë e transportit tashmë mbulohet me furgona, meqë udhëtarët gjithnjë e më shpesh i përdorin shërbimet e transportuesve të paligjshëm. Ata janë konkurrencë jolojale e transportuesve të regjistruar, të cilët ankohen se shënojnë gjithnjë e më shumë humbje dhe se nuk janë në gjendje t'i paguajnë të punësuarit. Njëherësh, qytetarët të cilët përdorin shërbime të transportit të paligjshëm arsyetohen se për çmim të njëjtë sa kushton bileta e autobusëve marrin transport deri në cilindo vend, e jo vetëm deri te stacionet e autobusëve, por nuk komentojnë faktin se në këtë mënyrë prodhojnë ekonomi gri. Me problemin e transportuesve të paligjshëm duhet të merren 16 inspektorë të Inspektoratit Shtetëror të Transportit, si dhe 60 inspektorë komunal, të cilët janë të obliguar me ligj që të ndërmarrin masa në territorin e komunës.

Transporti i paligjshëm dakordohet përmes rrjeteve sociale. Sipas pohimeve të asociacionit të transportuesve "Lindje", me ndihmën e Fejsbuk-grupeve organizohet transporti i paligjshëm thuajse nga të gjitha qytetet e shtetit. Në Shkup transportuesit e paligjshëm në të shumtën e rasteve gjenden rreth Stacionit të autobusëve për transport mes qyteteve në Shkup, ish-stacionin e autobusëve në afërsi të shtëpisë së mallrave "Ura", konviktet studentore, në rr. "Partizane" në afërsi të kishës "Shën Klimenti i Ohrit" Shkup, kompleksin e fakulteteve në Bit Pazar, QT CityMol... Nga qytetet nga brendia automobilat e transportuesve të paligjshëm të cilët nuk kanë "gjetur udhëtarë të sigurt" jo rrallë nisen para autobusëve dhe i

mbledhin udhëtarët e tyre. Kryetari i "Lindje"-s, Goran Tërpkovski shprehet se ekziston bazë për sanksione dhe mekanizëm, por institucionet shtetërore heshtin dhe nuk veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre. Për të ndihmuar në luftimin e transportuesve të paligjshëm, deri te institucionet kanë dorëzuar paraqitje tabelare të targave dhe karakteristika të automjeteve të transportuesve të paligjshëm sipas qyteteve.

"Për shkak të lehtësimit të kontrolleve, e që të evitohet arsyetimi se institucionet nuk kanë kuadër të mjaftueshëm për mbledhjen e të dhënave për transportuesit e paligjshëm, asociacioni "Lindje" në bashkëpunim me të gjithë anëtarët mblodhi të dhëna sipas komunave, për çdo automjet – transportues të paligjshëm ndaras, me kohën e nisjes, rutën e lëvizjes. Janë përpiluar një numër i madh i planeve të veprimit me shpresën se me ndihmën tonë do të sanksionohen transportuesit e paligjshëm, por nuk u zbatuan dhe nuk u morën parasysh. Me këtë u confirmua dyshimi se nuk bëhet fjalë për mungesë të kuadrit, por mungesë të vullnetit dhe ndoshta kon-

flikt të interesave për zbatimin e tyre", shprehet Tërpkovski për MIA-n. Në fillim të vitit të kaluar kanë parashtruar edhe kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit kundër "subjekteve që ushtrojnë veprimtari të parregjistruar, transport të udhëtarëve në komunikacionin rrugor (transportues të paligjshëm), por nga Ministria e Brendshme kanë marrë përgjigje se ende janë duke u mbledhur informacione dhe dëshmi.

Sipas Tërpkovski, institucionet kompetente duhet sa më shpejtë të formojnë grup punues për luftimin e ekonomisë gri me plane për ndërmarrjen e masave urgjente në këtë fushë, duke ndjekur shembullin e Republikës së Serbisë.

BRENDA VITIT NUK TAKSOHEN 576 MILIONË DENARË

Analiza e asociacionit "Lindje" tregon se në grupet e Fejsbukut përmes të cilave organizohet transporti i paligjshëm ka së paku 50.000 anëtarë, numri i të cilëve sa vjen e rritet. Nëse vetëm 30 për qind prej tyre udhëtojnë tetë herë në muaj, ndonëse të anëtarësuarit

janë kryesisht të punësuar të cilët udhëtojnë çdo ditë ose studentë që udhëtojnë çdo fundjavë, arrihet deri te shifra prej 120.000 udhëtarëve që udhëtojnë nga tetë herë me çmim mesatar të biletës prej 400 denarëve. Këto janë 48 milionë denarë të patakshuar brenda muajit, ndërsa brenda vitit 576 milionë denarë, buxheti është dëmtuar me së paku 2.880.000 denarë, pesë për qind TVSH, me 57.600.000 denarë tatim të fitimit..., tregon analiza e "Lindje"-s.

Prej atje theksojnë se është brengosës fakti se në nivel ditor 70 për qind e udhëtarëve transportohen me transportues të paligjshëm, ndërsa vetëm 30 për qind me ata legjitim. Transportuesit e paligjshëm me automjete 6+1 ose furgona nuk kanë orar të vozitjes, të cilit do të ishin të obliguar t'i përmbahen, gjithmonë janë një hap para dhe janë kreatorë të "orareve personale të vozitjes", varësisht nga numri i udhëtarëve që do t'i sigurojnë. Përballë tyre, transportuesit legjitim posedojnë leje, orare të regjistruara të vozitjes, kanë obligim që t'u përmbahen orareve të vozitjes pa marrë parasysh nëse në autobus ka një udhë-

tar ose nuk ka udhëtar fare, ndërsa për mosmirëmbajtjen e linjës vijon gjobë dhe marrje të orareve të vozitjes në përputhje me Ligjin për transport në komunikacionin rrugor. Parku vozitës me autobusë bëhet i papërdorshëm, i shtrenjtë për mirëmbajtje, jorentabil, ndaj transportuesit u ekspozohen shpenzimeve të reja plotësuese për furnizimin e minibusëve për shkak të uljes së shpenzimeve, e në interes të mbijetesës dhe mirëmbajtjes së linjave ekzistuese, sqaron Tërpkovski.

DËMSHPËRBLIM PËR AUTOMJETET E TRANSPORTUESVE TË PALIGJSHËM

Prej nëntorit të vitit 2012 deri në janar të vitit 2015, "transportuesve të paligjshëm" u janë marrë automjetet derisa Kushtetuesja nuk i anuloi nenin 99-a paragrafi 3 dhe 4 nga Ligji për transport në komunikacionin rrugor, me të cilët parashihej që Inspektorati për Komunikacion Rrugor lëshon vendim për marrjen e përhershme të automjetit në rast të përsëritjes së shkeljes nga ana e autorit të njëjtë ose me automjetin e njëjtë. Përkundër faktit që është anuluar neni, nga asociacioni "Lindje" konsiderojnë se në ligjet me më shumë akte ka mundësi për zgjidhjen e problemit, gjegjësisht marrje të përkohshme të automjetit në kohëzgjatje prej 30 ditëve dhe për shqiptimin e masës në përputhje me shkeljen që e ka bërë transportuesi i cili nuk posedon as licencë themelore, e as që është i regjistruar për veprimtari kryesore dhe me punë të tjera për të qenë transportues legjitim.

Pas heqjes së mundësisë për marrjen e automjeteve dhe ankimit, vendimet që Inspektorati për transport i ka shqiptuar në bazë të kësaj janë ankimuar kështu që ky institucion ka qenë i detyruar të paguajë gjoba dhe siç shprehen prej atje, kjo njëherësh edhe i ka demotivuar inspektorët e tyre. Deri në miratimin e Vendi-



Analiza e asociacionit "Lindje" tregon se në grupet e Fejsbukut përmes të cilave organizohet transporti i paligjshëm ka së paku 50.000 anëtarë, numri i të cilëve sa vjen e rritet. Nëse vetëm 30 për qind prej tyre udhëtojnë tetë herë në muaj, ndonëse të anëtarësuarit janë kryesisht të punësuar të cilët udhëtojnë çdo ditë ose studentë që udhëtojnë çdo fundjavë, arrihet deri te shifra prej 120.000 udhëtarëve që udhëtojnë nga tetë herë me çmim mesatar të biletës prej 400 denarëve

mit nr. 70/1992 të 28 janarit të vitit 2015 të Gjykatës Kushtetuese Inspektorati Shtetëror për Transport ka marrë përkohësisht 91 automjete për një periudhë prej gjashtë deri 12 muaj, derisa 154 automjete janë marrë përgjithmonë. Për një pjesë të zgjidhjeve me të cilat ishin marrë automjetet përgjithmonë janë dorëzuar padi në Gjykatën Administrative dhe ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative. Gjatë procedimit të padive gjegjësisht ankesave, Gjykata Administrativ dhe Gjykata e Lartë Administrative kanë marrë vendime me të cilat i kanë anuluar dhe pezulluar vendimet për marrje të përhershme të automjeteve duke mos e respektuar Vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe nenin 125 të Ligjit për procedurë të përgjithshme dhe administrative, shprehen nga Inspektorati Shtetëror për Transport dhe bëjnë të ditur se me anulimin dhe pezullimin e vendimeve janë përballur me probleme financiare.

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Transport, Rufat Huseini, për MIA-n sqaron se autorëve të kundërvajtjeve, gjegjësisht transportuesve të paligjshëm u janë kthyer automjetet, ndërsa një pjesë e tyre të cilët pas marrjes së automjeteve kanë nxjerrë licenca, kanë parashtruar ankesa në gjykatat themelore dhe kanë marrë vendime për kompensimin e fitimit të humbur. Njëherësh, një pjesë e transportuesve të paligjshëm kanë parashtruar padi në gjykatat themelore për dëmtimin e automjeteve gjatë ruajtjes në Agjencinë për pasuri të sekuestruar dhe për humbjen e vlerës së automjetit për periudhën kur janë marrë, kanë marrë aktgjykime për dëmshpërblim. Mbi të gjitha bazat Inspektorati Shtetëror për Transport ka paguar gjobë në vlerë prej 251.169 denarëve.

"Me aktgjykimet e këtilla u demotivuan inspektorët, e njëherësh u motivuan transportuesit e paligjshëm, numri i të cilëve dita-ditës vjen duke u rritur. Transportuesit e njëjtë të cilëve ne u paguam dëmshpërblim vazhdojnë punën e paligjshme", deklaroi Huseini.

SANKSIONE PËR 243 TRANSPORTUES

Në Inspektoratin Shtetëror për Transport janë të punësuar 16 inspektorë për komunikacion rrugor të cilët ushtrojnë mbikëqyrje inspektuese sipas Ligjit për transport në komunikacionin rrugor, Ligjit për transport të materieve të rrezikshme në komunikacion rrugor dhe hekurudhor dhe Ligjit për orarin e punës të punëtorëve mobil në komunikacionin rrugor dhe aparatet për regjistrim në komunikacionin rrugor, ndërsa një pjesë të orarit të punës inspektorët për komunikacion rrugor e kanë humbur edhe me shkuarjen në Gjykatë gjatë vendosjes lidhur me paditë e parashtruara.

"Përkundër të gjitha problemeve që i ka Inspektorati Shtetëror për Transport përmes inspektorëve shtetëror për komunikacion rrugor gjatë vitit 2018 ka ndërmarrë masa dhe sanksione kundër 243 transportuesve të paligjshëm. Duhet përmendur edhe atë se Komisioni që vendos për kundërvajtjet, që i zgjidhë Kërkesat për nisjen e procedurës kundërvajtëse për transportuesit e paligjshëm ende është duke i zgjidhur ato prej vitit 2015. Që puna jonë të japë rezultate Komisioni duhet sa më shpejtë t'i zgjidhë kërkesat tona, ndërsa DAP-i duhet të veprojë dhe t'i realizojë gjobat e shqiptuara nga Komisioni për kundërvajtje i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, në të kundërtën puna jonë nuk jep kurrfarë rezultatesh, sqaroi Huseini. Në përputhje me Ligjin për transport në komunikacionin rrugor, kompetenca për dhënien e licencave dhe gjithë dokumentacionit për transportin me taksë është e Këshillit të komunave dhe kryetarëve të komunave. Çdo transport i udhëtarëve fillon prej ndonjë komune, përfundon në ndonjë komunë tjetër dhe në fund transportuesi sërisht kthehet në vendin prej ku e fillon transportin, në komunën amë. Sipas Ligjit, transporti me taksë është kompetencë komunale dhe secila komunë ka obligim ligjor të ketë inspektorë të autorizuar për komunikacion rrugor.

"Sipas njohurive tona ka më shumë se 60 inspektorë të autorizuar komunal. Ata kanë bazën e të dhënave me taksë-kompani të licencuara që kanë të drejtë të ushtrojnë transport taksë. I shikojnë edhe tjerët që nuk janë të licencuar dhe punojnë në mënyrë të paligjshme. Në përputhje me ligjin i kanë kompetencat e njëjtë si edhe inspektorët e Inspektoratit Shtetëror për Transport. Inspektoratet shtetërore nuk kanë të drejtë të ndërmarrin masa dhe sanksione nëse transporti ushtrohet në territorin e komunës meqë kjo bën pjesë nën kompetencë të komunës", shprehet Huseini. Ndryshe, ulja e ekonomisë gri është njëra prej katër reformave parësore që duhet të sigurojnë klimë më të mirë biznesi në Maqedoni, sipas vlerësimit të kompanive të përfshira me hulumtimin e klimës së biznesit në Maqedoni në vitin 2018 përmes projektit "Partneritet për rregullim më të mirë të biznesit".

PESË MILIONË DENARË PËR HEQJEN E MBETURINAVE NGA LUMENJTË

FILLOI PASTRIMI I LUMENJVE NË TETOVË

Nga Komuna e Tetovës thonë se procedura për furnizime publike për pastrimin e lumenjve ka përfunduar dhe tashmë kompanitë kanë filluar me punët në teren. Sipas informacioneve dhe kontratës së nënshkruar në vlerën prej 5 milion euro janë përfshirë katër shtretër të lumenjve në territorin e komunës së Tetovës edhe atë lumi në Reçicë të Madhe, lumi në Shpikovicë, lumi Shkumbin dhe lumi në fshatin Poroj



madhe që mund të ndodhë", thonë banorët e fshatit Poroj. Zanafilla e vërshimeve në lumin e Porojit është në beshkët mbi fshatin Gjermë të Tetovës. Banorët e fshatit Gjermë shprehën se problemi i vërshimeve në fshatin e tyre dhe më pas edhe në Poroj është në lumin që kalon në këtë fshat. Burimi i tërë këtij rreziku është në lumin e quajtur "Uji i Shpejtë", prej nga uji bart me vete gjithçka që i del përpara dhe i sjell poshtë në fshatin Poroj. Nga Komuna e Tetovës thonë se procedura për furnizime publike për pastrimin e lumenjve ka përfunduar dhe tashmë kompanitë kanë filluar me punët në teren. "Vendimi për shpalljen e furnizimit publik për pastrimin e shtretërve të lumenjve edhe atë të lumit Shkumbin, lumenjve në fshatrat Reçicë e Madhe, Shpikovicë si dhe lumin në fshatin Poroj ishte hapur në fund të vitit të kaluar. Kështu, sipas këtij vendimi nga buxheti i Komunës janë ndarë 5 milion denarë që janë paraparë për pastrimin e shtretërve të lumenjve, ndërkohë që në procedurë e sipër është dhe plani aksional mbi rregullimin dhe pastrimin e shtretërve të lumenjve për të cilin plan janë ndarë mjete nga Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinor për Komunën e Tetovës në vlerë prej 5 milion denarë por që sipas vendimit të ministrisë ky

plan aksional pritet të fillojë realizimin kur edhe është paraparë pastrimi i shtretërve të lumenjve në mbarë vendin", deklaroi Arsim Nuredini nga Komuna e Tetovës. Sipas informacioneve dhe kontratës së nënshkruar në vlerën prej 5 milion denarë janë përfshirë katër shtretër të lumenjve në territorin e Komunës së Tetovës edhe atë lumi në Reçicë të Madhe, lumi në Shpikovicë, lumi Shkumbin dhe lumi në fshatin Poroj. Sipas Arsim Nuredinit nga Sektori për tokë ndërtimore, gjendja momentale në lumin Shkumbin është e vështirë, për shkak se gjerësia e tij është deri në 6 metra dhe është ngushtuar për shkak të hedhjes së mbeturinave të shumta, bërllok, mbeturina të materialeve ndërtimore dhe hedhje të mbetjeve të amvisërive dhe mobileve. "Krahas kësaj, përgjatë lumit vërehen edhe deponi të vogla të egra që janë krijuar nga hedhja e mbeturinave, prandaj edhe këta do të përfshihen në pastrimin e të njëjtave", tha Nuredini. Lidhur me gjendjen në lumin e fshatit Reçicë të Madhe, ai tha se në këtë pjesë lumi ka sjellë me vete baltë, ambalazhe të plastikës dhe materiale ndërtimore. Krahas kësaj, po ashtu ka edhe mbetje komunale në të dy brigjet e lumit, të cilat përfshihen në pastrimin e shtratit të këtij lumi në këtë periudhë.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 25 shkurt - Këtyre ditëve ka filluar pastrimi i shtratit të lumit në fshatin Poroj. Me përmirësimin e kushteve klimatike, tashmë gati se një javë është duke u pastruar Lumi në këtë fshat, që kohëve të fundit ka shkaktuar shumë probleme sidomos gjatë vërshimeve të viteve 2015 dhe 2017. Nga Sektori për tokë ndërtimore thonë se pastrimi ka filluar në pjesën e poshtme të rrjedhës së lumit të fshatit Poroj, ndërsa prej ditës së hënë pastrimi ka filluar edhe në pjesën e sipërme të fshatit që është e stërmbushur me gurë, rërë dhe baltë që i sjellë uji nga fshati Xhermë. Banorët e fshatit Poroj, një kohë të gjatë kërkojnë ndërtimin e digave dhe jo vetëm pastrimin e shtratit. "Atëherë neve na premtuan se do të rregullojnë në tërësi shtratin e lumit në fshat, ndërsa në pjesën sipër fshatit, në shtratin e lumit, premtuan se do të ndërtojnë diga për parandalimin e ndonjë katastrofe edhe më të

Ndihmë financiare për familjet e viktimave dhe të plagosurit e tragjedisë në Llaskarc

Shkup, 25 shkurt - Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e djeshme vendosi që në shenjë solidariteti, familjeve të personave që humbën jetën në aksidentin që ndodhi në autostradën Shkup-Tetovë, tek fshati Llaskarc, t'i japë ndihmë financiare me vlerë prej 100.000 denarësh. "Me këtë vendim, Qyteti i Shkupit si shprehje e solidaritetit viktimave dhe të lënduarve në aksidentin rrugor në autostradën Shkup-Tetovë, çdo familje e cila ka humbur nga një anëtar do të marrë ndihmë financiare prej 100.000 denarësh, ndërsa për të lënduarit do të ndajë nga 30.000 denarë, njoftojnë nga Qyteti i Shkupit. Këshilli i Qytetit të Shkupit e filloi seancën e 27-të me një minutë heshtje për viktimat e aksidentit në autostradën Shkup-Tetovë. Pesëmbëdhjetë persona e humbën jetën, në aksidentin e madh automobilistik më 13 shkurt.

Prej sot rritje të temperaturave të ditës

Shkup, 25 shkurt - Rritje të temperaturave të ditës që do të arrijnë edhe deri në 10 gradë paralajmërojnë prej sot meteorologët. Nga DPHM informojnë se deri të premtën do të jetë kryesisht me diell me rritje të dukshme të temperaturës së ditës, përveç të mërkurën kur do të fryjë erë e fortë nga drejtimi verior dhe do të ketë rritje të vranësirave me kushte për shi të dobët lokal. Sërisht rritje të vranësirave me reshje lokale pritet gjatë fundjavës. Temperatura e ditës do të lëvizë sot prej shtatë e deri në 14 gradë, të mërkurën prej katër e deri në 11, të enjten prej shtatë e deri në 14, të premtën prej pesë deri në 11 gradë. Temperatura e mëngjesit nesër do të jetë ende më e ulët edhe nën zero dhe do të ulët deri në minus tetë, nga e mërkura në disa pjesë do të jetë nën zero dhe do të lëvizë prej minus tre e deri në katër gradë, të enjten prej minus gjashtë e deri në tre gradë, të premtën prej minus pesë e deri në një gradë, të shtunën prej minus dy e deri në katër dhe të dielën prej minus një deri në katër gradë.

Një fund dhe filizat e një fillimi të ri

Nga
Christoph STRACK



Në fund të takimit në Romë, Papa Françesku ka mbajtur një fjalim të rëndësishëm për tmerrin e keqpërdorimit seksual të fëmijëve, për anët e errëta dhe kriminele të internetit aq të dashur, për turizmin seksual. Por ka diçka që më shqetëson në rrënjë tek ky fjalim: Vendi më i mirë për këtë do të kishte qenë një konferencë e OKB-së për mbrojtjen e fëmijëve apo një skenë e përafërt. Në Romë, në zemër të kishës, në të cilën ende ekziston keqpërdorimi seksual i fëmijëve, siç u shpreh vetë Papa Françesku, ky fjalim mu duk më se ambivalent.

Vërtet Papa Françesku e quan keqpërdorimin seksual brenda kishës "edhe më të rëndë e skandaloz" i krahason priftërinjtë, autorë të veprave seksuale me "ujçerit e lëshuar" dhe "të pashpirt", i quan ata "vegël të satanit". Për të kapërcyer këtë krizë globale të kishës ai beson tek "grigja e zotit", tek të gjithë besimtarët. "Kjo grigjë e zotit do të na çlirojë nga ai klerikalizëm që krijon truallin ushqyes për këto mizori". Po, por pas kësaj?

VIKTIMAT MBESIN JASHTË

Një duzinë viktimash nga Europa, Azia, Afrika, Amerika Veriore e Jugore, që si fëmijë u bënë pre e dhunës seksuale nga klerikët, i shoqëruan këto ditë të kishës nga përjashta. Brenda ata nuk lejoheshin. Vetëm delegacioni polak me sa duket me lidhje të forta, mundi të mbërrinte deri tek Papa, dhe madje qarkullon edhe një foto prekëse, ku Papa i puth dorën një viktime. Të tjerë nuk hynë dot në Vatikan. Por këto ditë ata morën konfirmimin, se dosje të tëra për vepra të caktuara janë shkatërruar dhe veprat janë fshehur.

Kjo është diçka që viktimat e thonë prej vitesh. Por për një kohë dukej se ishte e bezdisshme. Po, kush i ka fshehur gjëma të tilla duhet përmendur me emër. Dhe dosjet nuk shkatërrohen vetiu. Të gjithë këta viktimë duhej të dëgjonin fjalimin e Papës në monitorë. Dhe kaluan minuta, derisa ai foli konkretisht për keqpërdorimin seksual brenda kishës. Kurse çështja e dëmshpërbllimit as nuk u shtrua. Për disa ky mund të jetë një aspekt anësor, për të tjerë një pranim, kërkim faljeje. Nuk është edhe aq rastësisht që po falimentojnë ipeshkvi në SHBA.

FUND I NJË GËNJESHTRE TË ZGJATUR

Katër ditët e konferencës në Romë shënojnë në shumë pika fun-



din. Fundin e gënjeshtrevë të besuara gjatë nga kisha. Askush nuk mund të thotë më, se dhuna seksuale në kishë është vetëm pjesë në disa rajone të botës, e vendi im nuk përfshihet. Edhe fshehja e krimeve është një fenomen i praktikuar kudo nga kisha, krim pas krimi. Askush nuk mund të dyshojë më për lidhjen mes keqpërdorimit të pushtetit dhe dhunës seksuale - dhe kisha u bë shpesh një vend i keqpërdorimit të këtij pushteti. Por a do të kthehen këto ditë në ditët e një fillimi të ri? Të shpresojmë. Asgjë nuk kishte efekt ligjor në Romë

këto ditë. Gjatë këshillimeve, Papa paraqiti një program 21 pikësh. Ai mund të shihet si pikënisje për t'u zbatuar më pas nga konferencat e ipeshkëve dhe Roma. Çdo ipeshkv që ishte në Romë e ka detyrë një gjë të tillë.

FRIKA NGA E REJA?

Disa ditë para konferencës në Romë, Kardinali Kölnit Rainer Maria Woelki i shuahti shpresa e pritshmëritë e mëdha për një reformim të gjerë. "Nuk është detyra jonë të krijojmë tani një kishë të re". Në këto

Në Romë u takuan krerët e kishës katolike për të folur për dhunën seksuale ndaj minoreneve, brenda kishës katolike. Kjo ishte e nevojshme, por një fillim i ri do të kërkojë kohë



fjalë tingëllon frika.

Kjo fjalë më vinte ndërmend në kohën që dëgjoja tre fjalime të jashtëzakonshme, tre fjalime të mbajtura nga tre gra në konferencën në Vatikan. Fjalimet më të mira të këtyre ditëve. Me siguri asnjë prej tyre nuk dëshiron "të shpikë një kishë të re". Por fjalimi i drejtues së urdhrut, Veronica Openibo nga Nigeria, nëse do të ishte mbajtur në meshën e së dielës në kishat e Gjermanisë dhe Europës do të ishte prituri me duartrokkitje spontane. Openibo nuk do të donte një kishë të re, nuk kërkoi heqjen e celibatit. Ajo vetëm pyeti: "Pse ka heshtur kaq gjatë kisha? Dhe preku temën e keqpërdorimit të pushtetit, parasë, klerikalizmit, diskriminimit femëror, rolin të grave. "Shumë shpesh ne duam të heshtim, deri sa të kalojë stuhia. Por kjo stuhi nuk do të kalojë".

Këto ditë në Romë shënuan një fund dhe një fillim. Fundin e disa gënjeshtrevë të besuara gjatë nga kisha. Dhe kjo ka rëndësinë e vet në një sistem të ngurtësuar kaq fort. Fillimi i ri duket i brishtë. Por ai do të vijë, e siç e treguan jo rastësisht fjalimet e tre grave të kishës, shumë më shpejt nga impulset jashtë sistemit klerikal. (DW)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS




Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë, 25 shkurt 2018 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Pse shqiptarët nuk e sunduan veten?

Nga
Senat FERATI



Është bërë e zakonshme nëpër qarqet intelektuale e politike, tashmë, që për vonesën tonë historike të zhvillimit kombëtar të i fajësojmë pushtimet romake, bizantine, otomane e komuniste të hapësirave etnike shqiptare. Sidomos këto dy sundimet e fundit, ai otoman dhe komunist, i trajtojmë si fajtorët kujdestar të të gjitha të këqijave të cilat po e pllakosin shoqërinë shqiptare. Por, vallë, të këqijat që na kanë goditur në periudha të ndryshme a mos kanë qenë rezultat edhe i analizave jokritike të përvojave tona të akumuluar gjatë rrugëtimit tonë historik ndër shekuj. A kemi qenë, në momentet kyçe historike, mjaftueshëm vetëkritik për të marrë vendime të drejta në favor të interesave tona, apo, në mungesë analizave të përshtatshme, duke mos analizuar me kritikizëm të mjaftueshëm përvojat e akumuluar, kemi marrë vendime të disfavorshme të cilat kanë rezultuar me zhvillime negative shoqërore në shekujt e ardhshëm? Deri kur do të vazhdojmë me avazin e fajësimit të tjerëve, e kur do të fillojmë që gishtin për këto dështime e vonesa të e drejtojmë kah vetvetja? Pjekuria politike, kulturore e civilizuese e një kombi nuk matet vetëm me të mirat materiale që i ka prodhuar në të kaluarën apo i prodhon aktualisht, por edhe me shkallën e dëshmuar të vetëkritizmit kontinuitiv në të kaluarën dhe në momentin e tanishëm historik.

Nëse në Mesjetë, para pushtimit Otoman, Serbët, Grekët e Bullgarët, si fqinj tanë të parë, kishin arritur të krijonin mbretëritë e tyre të cilat ekzistonin ndër shekuj, pyetja e paevitueshme është se pse edhe Shqiptarët, në atë kohë, nuk kishin arritur të krijonin mbretërinë e tyre në hapësirën etnike në të cilën shtriheshin gjeografikisht? Do t'ia lëmë fajin tjetrit, Bizantit, apo do ta pranojmë se këtu "faji" qëndron më shumë te ne? Do t'i bëjmë fajtor perandoritë Romake dhe atë Bizantine pse na përçanë në dysh me kishat e tyre, që na e ndanë territorin etnik shqiptar sipas Vijës së Teodosit, apo përgjegjësinë për këtë duhet kërkuar te ne, meqë në atë kohë ne nuk kishim ende Kishën tonë autoqefale, sikur që e kishin popujt tjerë fqinj, Serbët e Bullgarët? Kjo ka shumë rëndësi të dihet meqë Kisha ishte ajo që e kurorëzonte vikend për mbret të një territori, si sundimtar legjitim mbi aristokracinë (princat, kontët apo

Popujt fqinj, të cilët kishin në kujtesën e tyre kolektive historike përvojën e mbretërimit (Serbët kishin Kanunin e Car Dushanit në të cilin kishin të inkuorporuar institucionin e perandorit), kishin arritur një shekull përpara nesh të çliroheshin nga Perandoria Otomane, kurse ne, në mungesë të kësaj kujtese kolektive, e shprehur si mungesë e kishës autoqefale, e mungesës së përvojës qeverisëse mbretërore dhe mungesës së modifikimit normativ kanunorë, ecnim më ngadalë nëpër itinerarin e historisë moderne



despotët) e vendit dhe banorët e saj. Dihet se asokohe shqiptarët ishin të organizuar politikisht vetëm deri në nivelin e bajraqeve (principatave), si mekanizëm vertikal subordinues i organizimit të hierarkisë shoqërore e politike. Dhe, kuptohet, për t'i ikur simpli-

fikimit, nuk është Kisha i vetmi faktorë i cili ndikonte efektivisht në homogjenizimin shoqëror të një etnikumi dhe në kompaktësinë territoriale të sajë, por ajo ishte conditio sine qua non për ekzistimin e mbretërisë në këto hapësira, në kontinentin e Europës. Po ashtu, mungesa e kishës qendrore, autoqefale, pastaj i rezultonte domosdoshmërisht status të caktuar politik gjithë etnikumit shqiptar në raport me popujt tjerë sepse ata duhej të i nënshtroheshin ose Patrikanës së Stambollit - realisht i nënshtroheshin Kishës Ortodokse Serbe apo Kishës Ortodokse Greke - ose i nëntroheshin Kishës katolike të Vatikanit. Pra, pyetja është: pse Serbët e Bullgarët kishin arritur me u pavarësuar prej Patrikanës së Stambollit dhe kishin arritur me u organizuar si mbretëri e perandori, dhe me këtë sistem organizimi ekzistuan deri në pushtimin Otoman, kurse ne ishim ende të organizuar në nivel të principatave? A është patjetër "faji" të kërkohej jashtë nesh, apo po frikësohemi të e gjejmë fajin brenda nesh, brenda vlerave tona kulturore etnike? Pse nuk kishim arritur të krijojmë mbretëri, qoftë sipas parimit të primogeniturës mashkullore, qoftë sipas parimit të promogeniturës edhe mashkullore edhe femërore (mbretëresha Teuta), meqë vetëm Mbreti, si institucion i pavarur nga feudalët, kishte rolin unifikues në shtet dhe në tërë shoqërinë, ai ishte simbol i unitetit dhe identitetit kolektiv, simbol i kontinuitetit të traditës etnike. Vetëm mbretëria ishte ai institucion i cili një shtet (dhe popull) e bënte subjekt gjeopolitik, kurse mungesa e mbretëri-

së këtë popull e bënte objekt të sundimit nga dikush tjetër. Është e nevojshme për ne të kuptojmë se pse Mbretëria e Arbërit (Regnum Albaniae) kishte qenë aq jetëshkurte? Si ndodhi që edhe modeli i mbretërisë ku për mbret zgjedhet dikush nga ndonjë dinasti mbretërore nga jashtë, prej ndonjë familje mbretërore europiane (familja e Karlit I Anzhuin), të tregohet i pasuksesshëm për rrethanat shqiptare gjatë periudhës së Mesjetës? Të arsyetohet ky mossukses me armiqtë e mbretërive fqinje ndaj nesh, kur ato njëkohësisht ishin edhe armike të njëra-tjetrës, është ky një argumentim pa bazë shkencore sociologjike e politike. Çështja, pra, është gjetiu.

Këtu duhet patjetër të e marrim parasysh edhe ndikimin e Kanunit (në të katër variantet e tij) si e drejtë zakonore, si institucion juridik i trashëguar, në organizimin ekonomik e politik të shoqërisë shqiptare për periudhën konkrete, si edhe më vonë, sepse mungesa e idesë (konceptit, normës) së Mbretit, e idesë së të Parit si parim themelues juridik, i Njëshit si njëjës e jo si shumës (princat, bajraktarët), kishte lënë pasojë edhe në konstituimin e Një Kishë qendrore e cila, rrjedhimisht, më pastaj do të i përcaktonte edhe kufijtë shtetëror ku do të shtrinte sundimin e saj meqë do të duhej të i normativizonte të drejtat dhe obligimet e saj kundrejt feudalëve dhe njerëzve tjerë brenda këtyre kufijve. Duhet të ia sqarojmë vetes sonë këtë mungesë normative në Kanunin shqiptar, meqë Kanuni është produkt ekskluzivisht i gjeniut shqiptar, dhe

askujt tjetër. Ne, si populli më i vjetër autokton në Gadishullin Ballkanik, kishim dëshmuar shumë herë potencialin tonë të qeverisjes dhe organizimit politik duke i dhënë, gjatë Mesjetës, disa perandorë të famshëm Bizantit, disa papë Vatikanit, më vonë disa vezir e sadriazem Perandorisë Otomane, por nuk kishim arritur me organizuar vetveten si popull deri në atë cilësi sa për të prodhuar ndonjë dinasti mbretërore që do të sfidonte shekujt.

Popujt fqinj, të cilët kishin në kujtesën e tyre kolektive historike përvojën e mbretërimit (Serbët kishin Kanunin e Car Dushanit në të cilin kishin të inkuorporuar institucionin e perandorit), kishin arritur një shekull përpara nesh të çliroheshin nga Perandoria Otomane, kurse ne, në mungesë të kësaj kujtese kolektive, e shprehur si mungesë e kishës autoqefale, e mungesës së përvojës qeverisëse mbretërore dhe mungesës së modifikimit normativ kanunorë, ecnim më ngadalë nëpër itinerarin e historisë moderne. Kjo ngadalësi, pa përjashtuar edhe faktorët sociologjik, politik e religjioz, është pasojë e korelacioneve të vlerave tona kulturore e antropologjike në mendësinë tonë, andaj, për të kuptuar fatin tonë historik pa prejurdikime është e domosdoshme të realizojmë introspeksionin kritik të sistemit të vlerave tona etnopsikologjike dhe antropologjike që të evitojmë analizat tendencioze joproduktive, që të mos fajësojmë të tjerët s' aherë që na mungojnë idetë kreative gjatë ballafaqimit me sfidat me të cilat ndeshemi në rrugëtimin tonë historik.





Ndërsa Kosova mori pjesë në Berlinale në Evropë me një film të vetin, Shqipëria duket se e ka kthyer vështrimin në festivalet e tjera

FILMI I SHQIPËRISË: MË MIRË ME ÇMIM, SESA VETËM PJESËMARRËS!?



Në aktivitetin paralel me Berlinale, European Film Market, që u mbajt në mes të shkurtit në Berlin, mund të krijoje një përshtypje për gjendjen e kinematografisë së sotme shqiptare. Sidomos në pritjen tradicionale të stendës së dy QKK-ve të Shqipërisë dhe të Kosovës, ku mblidhen producentë dhe kineastë nga e gjithë bota, e kuptojë se industria e filmit të Shqipërisë dhe Kosovës po zë vend gjithnjë e më të qendrushëm në rrjetin kinematografik evropian. Kosova mori pjesë në Berlinale në kuadër të Berlinale Shorts me "Në mes" (të Samir Karahodës) dhe kjo ishte një premierë e veçantë për Kosovën dhe filmin e saj. Kurse, Shqipëria nuk kishte marrë pjesë në aplikim, sepse, siç thotë Ilir Butka, producentët shqiptarë e kanë ndryshuar strategjinë e tyre në lidhje me aplikimin nëpër festivale. Dhe, që të fitosh sot në festivale filmi duhet "t'i përshtatet tipologjisë dhe sensibiliteteve të festivaleve" ku aplikon. Publiku gjerman, sado i hapur që të jetë, nuk ndjehet shumë i afërt me tematikat e Shqipërisë. Edhe pse Berlini vetë ka pasur një të kaluar komuniste, festivali i Berlinit është një produkt tipik perëndimor dhe tematikat e së kaluarës komuniste duhet të kenë lidhje me Gjermaninë e sotme ose

me probleme me të cilat identifikohen njerëzit në Gjermani, në mënyrë që të pranohen nga politikë e festivalit dhe të pëlqehen nga publiku, argumenton Butka më tej. Dhe, nëse ky kriter nuk përmbushet atëherë mbetet vetëm ekzotizmi për të tërhequr vëmendjen e përzgjedhësve të festivalit: Prandaj, nuk është çudi fakti që (përveç filmit të Bujar Alimanit, "Aministia", 2011) që ka marrë pjesë në Seksionin Forum, të vetmet filma shqiptarë që kanë marrë pjesë në garën kryesore të Berlinales në të gjitha kohërat kanë qenë të lidhur me fenomenin e burrneshave: "Burrnasha" (2015) dhe "Falja e gjakut" (2011), bashkëprodhim mes SHBA-së, Shqipërisë, Italisë dhe Danimarkës. Ky i fundit e futi Shqipërinë për herë të parë edhe në listën e vendeve fituese, pasi mori asokohe "Ariun e Argjendit" përskenarin të shkruar nga Joshua Mar-

ston dhe Andamion Murataj. Prandaj, edhe, siç rrëfen Butka, kineastët shqiptarë kanë nisur t'i përzgjedhin festivalet sipas tematikave. Dhe, me sukses: Filmi i Bujar Alimanit "Delegacioni" (bashkëprodhim Shqipëri, Kosovë, Greqi), me skenar të Artan Minarollit (1958-2015) që trajton periudhën e fillimit të tranzicionit në Shqipëri menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit, fitoi ndër të tjera, në tetor të 2018-ës, Çmimin e Madh të Festivalit të Varshavës. Edhe ky festival është i kategorisë A, pra i akredituar te FIAPF-i (Fédération Internationale des Associations de Producteurs de Films). Janë rreth një duzinë festivalesh në botë që e shijojnë këtë privilegj. Një ndër ta është edhe Tallinn Black Nights Film Festival në Estoni, ku, falë po së njëjtës strategji, në dhjetor të vitit 2018 mori pjesë në konkurrimin kryesor edhe

filmi më i ri i Robert Budinës "Streha mes reve" (bashkëprodhim Shqipëri-Rumani me distributorin gjerman, Pluto). Këto ditë, përpara përfundimit mandatit të tij si drejtues i QKK-së, Ilir Butka arriti edhe marrëveshjen me Open Labs, për të publikuar informacione mbi filmat shqiptarë në enciklopedinë online Wikipedia, prej nga shpresohet të rritet edhe më shumë njohja për kinematografinë shqiptare. Vetëm me një gjë nuk është i kënaqur kryetari i Qendrës Kombëtare: Që projektvendimi i ri për kinematografinë, i cili do t'u hapte rrugën producentëve të huaj për të xhiruar në Shqipëri, nuk është miratuar ende. "Kam katër vjet që i bie murit me kokë dhe refuzohet për disa teknikalitete, por unë do të vazhdoj të luftoj deri sa të thyhet muri, se koka ime nuk thyhet", paralajmëron ai. (DW)

"Green Book", filmi më i mirë në Oscar 2019

Ceremonia e Oscarit tërheq të gjithë pa përjashtim, nga aktorë të dëshmuar e deri tek të rinj që premtajnë shumë, por që secili prej tyre parakalon në tapetin e kuq me një synim: të kthehen në shtëpi me statujën e famshme të artë. Gjithashtu, ceremonia e 91-të e Akademisë së Çmimeve ka filluar të mbahet të dielën në mbrëmje në teatrin "Dolby" në Hollywood, ndërsa me orën tonë lokale prej orës 02:00 të së hënës. Gjatë tërë ceremonisë kishte emocione të shumta dhe gara ishte shumë e ngushtë, por çmimin prestigjioz e vodhi "Green Book" si "Filmi Më i Mirë" ndërsa si "Regjisori Më i Mirë" është zgjedhur Alfonso Cuarón me filmin "Roma", transmeton Koha.net. Po ashtu, çmimin "Aktori Më i Mirë" e mori Rami Malek me filmin "Bohemian Rhapsody", ndërsa "Aktorja Më e Mirë" e mori Olivia Colman me filmin "The Favourite". Gjithashtu, çmimin si "Aktori më i mirë mbështetës" e mori Mahershala Ali me filmin "Green Book" ndërsa atë si "Aktorja më e mirë mbështetëse" Regina King me filmin "If Beale Street Could Talk".

Gjatë ceremonisë, po ashtu, aktori Bradley Cooper dhe këngëtarja Lady Gaga dhënë një performancë të mahnitshme me këngën e tyre "Shallow" nga filmi "A Star Is Born", këngë e cila fitoi çmimin "Kënga Më e Mirë Origjinale". Lidhur me këtë ceremoni, ka folur edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, i cili la të kuptohet se po pret me pa durim ndarjen e çmimeve. Përmes një postimi në Twitter, Kosnett pati një pyetje për kosovarët. "Të shikojmë përpara tek Oscarët. Prodhuesit e filmit dhe aktorët ndërkombëtar ndër breza kanë gjetur sukses në Hollywood. Kush do të jetë drejtori dhe aktori i ardhshëm nga Kosova që ta bëjë një gjë të madhe në Shtetet e Bashkuara?", tha ai.

RRËFIMI I RRALLË I NJË ANGLEZI

SI NDAHEN SHQIPTARËT DHE PSE EDHE TË NDARË JANË TË BASHKUAR?!


Sikurse skocezët që puqeshin me njëri-tjetrin nga urretja që ushqenin për anglezët, edhe shqiptarët i bashkon urretja që kanë për slavët. "Kombet përreth tyre ua kanë pasur aq shumë frikën – për shkak të pasionit të tyre mbizotërues dhe të pasuar për luftën – sa i kanë lënë shqiptarët të merren me veten e tyre. Mungesa e rrugëve, shtigjet e rrezikshme malore dhe zilitë ndërfisnore kanë bërë që çdo zonë, e mbërthyer mes malesh të pakalueshëm, të ndjehet e vetëmjaftueshme.

Gjithkund vërehet një bujari e rreptë. Një femër mund të udhëtojë e sigurt nëpër Shqipëri vetëm falë dobësisë së saj. Megjithatë, shqiptari do të ngurronte të qëllonte një burrë për një fyerje të paqenë, aq sa do të ngurronte të qëllonte një qen që i leh. Ekziston një mëvetësi e ashpër...

Fiset e Shqipërisë nuk kanë një fe të përbashkët. Disa janë të besimit mysliman dhe disa të krishterë. Brenda fisit mund të gjenden që të dy besimet. Më i rëndësishmi nga fiset e veriut, mirditorët, janë të krishterë: katolikë romanë. Në jug shqiptarët janë të krishterë dhe, duke qenë në kufi me grekët, kanë përfaqur Kishën Ortodokse. Shqiptari mysliman është nën ndikimin e fqinjëve të tij të krishterë. Ai pi verë dhe është veçanërisht i dhënë pas birrës. Më rastisi të gjej edhe shishe birre nga Mynihu, e ai betohet në emër të Virgjëreshës", shkruan Fraser.

John Foster Fraser (1868-1936) është një sy vëzhgues i fillimit të shekullit të njëzetë, i cili midis memuarëve të veta ka përfshirë dhe vështrimet mbi Shqipërinë, sidomos pjesën e poshtme të saj, ku elementet e eposit, etnografisë, traditës dhe dokeve shqiptare janë

përshkruar me një stil të këndshëm, pse jo edhe me dashuri, të përshtatshëm për lexuesin anglo-sakson. Vlera e këtij libri nuk ndalet me prezantimin e Shqipërisë të lexuesit i huaj, por fare mirë mund t'i shërbejë dhe lexuesit shqiptar për të njohur këtë pjesë të Shqipërisë nëpërmjet këndvështrimit të një të huaji. "Populli që të bie më shumë në sy janë shqiptarët. Burrat janë shtatlartë dhe zeshkanë, me tipare të pashme dhe të rregullta. Atje dhe, në të vërtetë, në të gjithë vendin, shqiptari më la përshtypjen e një sqimatarit. Ai dëshiron që xhamadani i tij të jetë i qëndisur me serm e flori. Zakonisht, fustanella e tij është borë e bardhë. Opingat, rëndom prej lëkure të kuqe, kanë nga një xhufkë të madhe në majë... për të cilën shqiptari mendon se është pjesë veçanërisht e rëndësishme e 'kapardisjes' së tij", ky citim i



John Foster Fraser dëshmon për një realitet historik të Shqipërisë së para 100 viteve. "Shqipëria e Poshtme" e autorit John Foster Fraser, një nga rrëfimet dhe ballkanologët e shquar të fillimshekullit të kaluar bën pjesë në koleksionin Memorie të Botimeve Zenit.



Nga Vjollcë BERISHA

ASKUSH S'E MERR MË PËRDORË LEXUESIN PYJEVE TË LETËRSISË

Kaq shumë gjëra do të ndryshonte kultivimi i një kritike të mirëfilltë letrare, i një kritike me baraspeshë, i një kritike të bërë jo nga mjeshtrë çollakë, por nga ata të zanatit, nga ata që dozimin e njohin dhe e përfillin këmbëngulshëm, nga ata që s'i zë gjumi natës për një fjalë të thënë...

Gjithmonë jam ndjerë ngushtë kur më është dashur të jap një mendim lidhur me krijimtarinë e shkrimtarëve të rinj, jo për shkak të mungesës së entuziazmit se ata po shtohen, por për shkak të frikës reale të dozimit të fjalëve nxitëse e dëshirore. Kur them nxitëse, kam parasysh ato mendime që mund t'i japin hov e vetësiguri akëcilil shkrimtar, duke ia përkëdhelur sedrën e duke e frymëzuar edhe më që ta shohë veten në radhën e shkrimtarëve të shquar. Ndërkaq fjalët a fjalitë dëshirore kanë të bëjnë me ato gjëra që do të dëshiroja t'i shihja ndryshe e më mirë të shkrimtarit që ma ka paraqitur me zell dorëshkrimin. Kjo baraspeshë mes këtyre të dyjave është ai dozimi që ia kam frikën dhe e ndiej si barrë tek shkruaj një tekst për një autor të ri, edhe në rastet kur më pëlqen shkrimi, po edhe në rastet kur mendoj se ka tepri të disa gjërave në dëm të mendimit, të ndjenjës, apo, çështje më e rëndësishmja, të estetikës.

AUTORI I RI MIDIS DY RREZIQEVE

Dozimi është kaq brejtës dhe bart kaq shumë përgjegjësi sa mund të ta shpjerë në theqafje gjumin për disa net rresht.

Kurrë s'i kam kuptuar as ata kritikë që e fryejnë si tullumbace mjeshtrinë e një autori, e as ata që i bien shkurt e me negativitet, duke ia prerë flatrat që në fillim, apo, siç do të thoshte poeti Esad Mekuli, si ato mrazet e pranverës, duke ua mbytur filizat mu në farë.

Dozimi i këtyre dyjave ka të bëjë me baraspeshën dhe përgjegjësinë e fjalës. Një lëndatë e tepërt, një mëtim për ta vendosur poetin e ri në maje të larta me "teleportim", është më shpesh një dëm, është mundësia për t'ia mbytur mendjen se ka një talent të rrallë, duke ia ndërprerë rrugën e kërkimit, e madje, edhe më skandalozja, edhe atë të leximit, aq sa e shndërron poetin në një kërkues botuesi a shtypshkronje dhe e vë në gjurmim të një njeriu tjetër që

do ta fryejë atë fluskën e sapunit që e duan fort fëmijët, që e quajnë bubbles, që bëhet me ngjyra të rreme nga përthyerjet e dritës, e që fluturon larg, ku zhduket përfare, duke ia lënë fëmijës iluzionin gjysmë të besueshëm se u ngjit në qiell, ku syri i tij s'e gjen më...

Po edhe heqja e një vije të rreptë a e një iksi barbar mbi krijimtarinë e tij është diçka e vrazhdë, e pamenduar mirë, diçka që s'e lejon t'i rriten flatrat, diçka që ia ndalon fluturimet e nesërme, diçka që u ngrit bostbllloqe të tmerrshme muzave që e deshën, diçka që ia rrokullis vetbesimin tatëpjetës së ëndrrës. Pra, të dyja janë të rrezikshme dhe të dyja e zhdakin një krijues, andaj dozimi është i domosdoshëm në rastin e krijuesve ende të paafirmuar. Kjo ndjenjë përgjegjësie më ndalon të shkruaj për librat e rinj të botuar apo për ata që presin në dorëshkrim, edhe sot kur e ndiej, si asnjëherë më parë, mungesën e një kritike të mirëfilltë letrare. Mungesën e një kritike që në mënyrë korrekte, të drejtpërdrejtë, do të fliste për librat që duhen lexuar, do të trasonte rrugë të sigurta për krijuesit e rinj dhe jo vetëm për ata; një kritikë që do ta orientonte mendimin e lexuesit joprofesionist, do t'i hapte horizontin një lexuesi të profesionalizuar për të bërë një studim për një vepër të caktuar, do t'i nxirrte nga anonimati disa njësi letrare që janë humbur në grumbullin me zhurmues të atyre që kanë botuar një deng librash sa për t'i marrë në qafë drurët që e bënë letrën...

Një produksion i jashtëzakonshëm "letrar" pa asnjë shoshë

Kaq shumë gjëra do të ndryshonte kultivimi i një kritike të mirëfilltë letrare, i një kritike me baraspeshë, i një kritike të bërë jo nga mjeshtrë çollakë, por nga ata të zanatit, nga ata që dozimin e njohin dhe e përfillin këmbëngulshëm, nga ata që s'i zë gjumi natës për një fjalë të thënë... A s'duket pak e shëmtuar të kesh frikë të shkruash e të japësh mendim për një vepër kur e di mirë se ç'hon të madh le në artet bashkëkohore (në të gjitha pa përjashtim) mosekzi-

stimi i kritikës?! Sigurisht që po. Por ajo ndjenja e frikës nga dozimi i saktë mbase ma jep një arsye...

Në grumbullin e librave që shtohen përditë, në mundësinë tepër të madhe të secilit për të botuar gjithçka që zhgaravit, shpesh humb emri i një krijuesi të talentuar vërtet, për shkak të mungesës së reklamës, për shkak të natyrës së tij të tërhequr (siç janë rëndom poetët), për shkak të vërshimit të titujve të botuar pa asnjë kriter, të cilët jo se e rrezikojnë letërsinë, por rrezikojnë dukjen e atij të vërtetit, pasi kur na bie në dorë një libër i shkruar nga një autor që s'e njohim, e para gjë që na vete ndërmend është: Duhet të jetë njëri nga ata. E ata janë shumë, janë aq shumë sa kanë bllokuar vitrinat e librarive, standat e panairëve, rrjetet sociale e gjithçka që u del përpara. Ky fakt e bën shumë të ngutshëm kultivimin e një kritike letrare që do t'i shquante disa emra në një qoshe gazete a në një faqe serioze letrare interneti, apo në ndonjë diskutim konstruktiv në televizion. Ekziston një produksion i jashtëzakonshëm "letrar" në kohën e fundit, pa asnjë shoshë, pa asnjë mendim serioz i thënë për të dhe kjo po na shpie në rrugë pa krye e jo vetëm në letërsi, por në të gjitha artet. Kaq shumë koncerte të muzikës klasike, kaq shumë ekspozita personale e kolektive, kaq shumë shfaqje teatrore kalojnë pa u thënë asnjë fjalë për to e duke ua lënë vlerësimin vetëm sasisë së duarve që e aplaudojnë. E kështu, me efektin e fluturës, rrënojmë diku një vjershë të bukur, e vëmë një ngjitës në gojën e një poeti që ka ardhur në jetë për të shkruar, e dënojmë një roman me burg në magazinat e librarive, apo, edhe më keq, në kompjuterin e shkrimtarit, ia vëmë çelësin dy-tri redaksive të revistave kulturore, po besa, edhe të disa shtëpive të vogla entuziaste botuese. Heshjtja dalëngadalë mundëson që oferta të jetë egjri dhe pastaj vjen mendimi ngulmues se alqionët-poetë nuk duken më kund për t'i mbajtur në shpinë prindërit e tyre në hapësira të reja fluturimi.

MBËSHTETEN INSTITUCIONALISHT VEPRA TË PAVERIFIKUARA

Moskultivimi i kritikës së mirëfilltë mundëson që të përkrahen financiarisht edhe nga institucionet e kulturës vepra të paverifikuara, gjë që e mundëson jetëzgjatjen e disa pseudoautorëve, të disa shtëpive botuese fantazma, apo të atyre që aktivizohen vetëm një herë në vit me nga dy libra të financuara nga Ministria (këtu te ne, për shembull), të disa koncerteve e trupave teatrore të dobëta, të disa revistave letrare që janë llumi i produksionit letrar, hartuar pa asnjë shije e kriter (vetëm për ta arritur normën e tirazhit që duhet të dorëzohet në Bibliotekë) e shumë dukuri të ngjashme që e bjerrin artin, në vend që ta stimulojnë atë. Në rastin e një kritike të vërtetë asnjëra nga këto dukuri nuk do të shfaqej kështu paturpësisht në çdo fushë arti për ta zvetënuar e për t'ia humbur pak nga pak publikun, atë publik që mezi mbahet në këmbë midis betejës me internetin dhe informacionet e pafiltruara që i marrim përmes tij. Me këtë do të mundësohej mbështetja e artit të vërtetë, e letërsisë së mirëfilltë që mëton drejt vendit të saj në vlerat kanonike, si dhe krijimi i një mendimi serioz mbi artin në përgjithësi e mbi letërsinë në veçanti, gjë që do ta ushqente shëndetshëm më vonë krijimin e një historie të plotë letrare, që ka herë paraqet një nyje kruciale për studiuesit e letërsisë sonë.

Përveç frikërave të paraqitura në krye të këtij shkrimi lidhur me dozimin e lëndatave dhe vërejtjeve, kritikut serioz letrar i dalin edhe do stërkëmbëza të tjera që e pengojnë ta hedhë tutje drojën e shkrimit të drejtpërdrejtë për secilën vepër. E para, me gjasë, është rënia e besimit se ende tekstet e tilla janë kërshërindjellëse dhe se mund të ndryshojnë ndonjë gjë dhe e dyta shpesh ka të bëjë me një provincializëm të lehtë, sidomos në vendet ku hatri është kandari matës i shumë vlerësimeve, në mjediset e vogla letrare ku njihen të gjithë dhe ku çdo mendim i shprehur drejtpërdrejt rrezikon të duket ten-

dencioz, i njëanshëm, mosdurim personal, ballafaqim grupesh me kriteret jashtëletrare vlerësimi e të ngjashme. Në mjediset të këtylla zhvillimi i mendimit kritik jo rrallë bëhet peng i hatërmbetjeve provinciale në dëm të së mirës së përgjithshme të artit.

LEXUESI I PROFESIONALIZUAR ZGJEDH NDËRTOJË LISTËN VETJAKE TË VEPRAVE

Një tjetër element pengues i kritikës është edhe mundësia që i jepet gjithkujt të publikojë krijime letrare në rrjete sociale e bashkë me to edhe komente superlative, ku shkëlqejnë fjalët: e jashtëzakonshme, perlë, mrekullia vetë, kryevepër..., që shqiptohen me bollëk e që kontribuojnë edhe më në bjerrjen estetike dhe të vështrimit të mirëfilltë letrar. Të gjitha sa i përmendëm, po edhe mjaft faktorë të tjerë, e krijojnë këtë shkretëtirë të mendimit kritik kaq të munguar në ditët e sotme, që jo vetëm s'arrin ta ndjekë fluksin marramendës të botimeve të librave, por edhe ngurren të shfaqet haptazi. Kritiku, apo lexuesi i profesionalizuar, i zënë ngushtë midis produksionit marramendës në njërin anë dhe reklamës me kriteret jashtëletrare (por mjaft të fuqishme) në anën tjetër, zgjedh të heshtë e ta ndërtojë listën vetjake me veprat që, sipas shijes së tij, i bëjnë nder letërsisë kombëtare a botërore. Ai pothuajse ka pushuar fare dhe s'duket gjëkund për t'ia nisur prapë nga e para: t'i afrohet ngadalë veprës, me lapsin e gdhendur për të shënuar ndonjë rresht e varg që i lë përshtypje të veçantë a një tepri poetike që i shkon në dëm estetikës së librit, sa për ta mbajtur në baraspeshë reale dozimin e nxitjes dhe dëshirës ndaj një shkrimtari të njohur apo ndaj atij të riut që rish-tazi po depërton në pyllin joshës të shkrimtarisë me fanarin e dorës dhe përjetimet e veta, si mjete të vetme që do t'i hyjnë në punë midis bukurisë së pyllit dhe kërcënimit të egërsirave.

(Autorja është pedagoge e letërsisë në Universitetin e Tetovës. Shkrimi është botuar në rrjetin Panalbanica.net)

Kush ishte Antonio Machado?

Antonio Cipriano José María y Francisco de Santa Ana Ruiz Machado, poet spanjoll i njohur thjesht si Antonio Machado (Antonio Maçado), i lindur më 26 korrik 1875 në Sevilje, Spanjë, në Las Dueñas Palace.

Ende fëmijë, la qytetin andaluzian me familjen e tij dhe u zhvendos në Madrid, ku ai ndoqi një shkollë laike, Institucion Libre de enseñanza, themeluar nga Francisco Giner de los Rios.

Më 1893 ai u desh të përballlet me vdekjen e babait të tij, i cili e la familjen e tij në kushte të komplikuar ekonomike; Antonio, megjithatë, nuk heq dorë nga pjesëmarrja në shfaqje teatrale ose për të mbajtur fjalime në kafenenë letrare e cila gjithashtu përfshin Azorín, Ramón del Valle-Inclán, Miguel de Umamuno, Villaespesa Francisco, Ramon Perez de Ayala dhe Juan Ramón Jiménez. Midis 1899 dhe 1902 ai bëri dy udhëtime në Paris: gjatë të parit ai u takua me Jean Moréas dhe Oscar Wilde; gjatë takimit të dytë ai u takua me Rubén Darò, mjeshtrë nikaraguan i modernizmit. 1903 është viti i debutimit të tij letrar, me "Soledades", një libër poetik.

Kur ishte mësues i frëngjishtes në një shkollë të mesme në Soria, ai u martua me Leonor Izquierdo, një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçare, gati njëzet vjet më e re se ai. Gruaja e tij e shoqëron atë në vitin 1910 në Paris, ku Antonio ndjek një kurs të mbajtur nga Henri Bergson; i cili vdiq vetëm dy vjet më vonë për shkak të tuberkulozit. Në të njëjtën periudhë, Antonio Machado botoi "Campos de Castilla", përmbledhja e tij më e famshme; pastaj, i tronditur nga vdekja e gruas së tij, ai u transferua në Baeza, Andaluzi, ku qëndroi deri në vitin 1919, duke vijuar në një jetë gjithnjë e më të vetmuar dhe duke dhënë mësim në një shkollë fillore. Ai u transferua në Segovia, në vitet njëzet bëhet një nga intelektualët që e kundërshtuan me bindje më të madhe diktaturën e Primo de Riveras. Ndërsa në vitin 1924 botoi një përmbledhje të re me poezi, të titulluar "Nuevas Canciones", veprimtaria krijuese e Antonios është reflektuar edhe në shkrimin e teksteve teatore, bërë në bashkëpunim me Manuelin, vëllai i tij më të madh: në vitin 1927 përfundon veprën "Juan de Manara", frymëzuar nga miti i Don Zhuanit, dhe dy vjet më vonë ishte një sukses i madh "La Lola se va a los puertos" ("Lola shkon në port").

Duke u bërë ndër kohë anëtar i Real Academia de la Lengua Espanola, Machado ka mundësi të njihet me Pilar Valderraman, një poete që në zemrën e tij merr vendin e Leonorës. Në vitin 1931 ai ishte ndër mbështetësit më të zjarrtë të Republikës; menjëherë pas kësaj ai u vendos në Madrid përfundimisht, së bashku me nënën e tij dhe me familjen dhe me Hozenë, vëllain dizenjator dhe piktor.

Dy vjet më vonë publikon edicionin e tretë të "Poesias completas", pasuruar me një seksion të ri, të quajtur "De un cancionero apócrifo". Pas publikimit të "Juan de Mairena", Antonio – me largimin e Pilar Valderrama në Portugali dhe në fillim të luftës civile – mbajti anën e qeverisë Republikane (ndryshe nga vëllai i tij Manuel, i cili merr një qëndrim në mbështetje të nacionalistëve) dhe mbështet aktivitetet e intelektualëve të ndryshëm.

Tashmë i mërzitur dhe i lodhur, qëndron në një hotel që gjendet përtej kufirit, në Collioure: këtu vdes më 22 shkurt 1939, në xhepin e tij gjendet një copë letër ku është shkruar "Këto ditë blu dhe ky diell i fëmijërisë". Ai varroset në varrezat e qytetit të vogël të Alpeve: pas disa ditësh, do të vdesë edhe nëna e tij.



ANTONIO MACHADO

KOPSHTI

*Larg nga kopshti yt kopshtit digjet mbrëmja
temjani i artë me flakë të purputa,
pas pyllit prej hiri dhe bakri
Gjorgjinat në kopshtin tënd.
I shëmtuar kopshti yt!..Sot më duket
vepër e një berberi, me palmën xhuxhe
dhe lehen me mersina të riprera ...
dhe portokallin në fuçi ..Uji
i gurrës së gurtë
nuk pushon orzi në koritën e bardhë.*

LAKURIQ ËSHTË TOKA

*Lakuriq ështëoka, dhe shpirti
ulërinë kundër horizont të zbehtë
si një ujk i uritur. Ç'këron poet,
në perëndim të diellit?
E hidhur të ecësh, sepse peshon
të ecurit mbi zemër.Era e ftohtë,
dhe nata që vjen, dhe hidhërimi
i distancës... Në të ecurit e bardhë
pemë gjatoshe që nxijnë;
mbi malet e largëta gjak dhe ar ...
I vdekur është dielli... Çfarë kërkon poet,
në perëndim të diellit?*

RA TË FLERË ZEMRA IME?

*Ra të flerë zemra ime?
Luzma të ëndrrave të mia,
jeni në limonti?Mungon uji
në helikat e mendjes
dhe kovat rrotullohen bosh,
janë plot dhe vetëm me hije?
Jo, se nuk fle zemra ime.*

*Nuk fle zemra ime, ajo vri zjuar.
As nuk fle as ëndërron: është e vendosur,
me sytë e mprehtë të hapur,
dëgjon shenjat e largëta
në skaj të heshtjes së madhe.*

NGA PRAGU I NJË ËNDRRE

*Nga pragu i një ëndrre më thirrën ...
Ishte zëri i mirë, zëri i dashur.
– Thuamë, do të vish me mua të shohësh shpirtin...?
Një përkëdheli më mbririti në zemër
– Gjithmonë me ty... Dhe eca në ëndrr
nëpër një galeri të gjatë të zhveshur;
ndjeva të më prek fustani i saj pastër
dhe dridhja e ëmbël e dorës mike.*

GJATË TOKËS SË ZHVESHTUR

*Gjatë tokës së zhveshure rrugës
çel tani lulja e vogël,
murrizi i vetmuar,
lugina të përvaajtura në kthesën me hije.Psalmi kthen
vërtet
sot me zë të butë
në zemër dhe mbi buzët
fjalën e ndërprerë dhe fërgëlluese.Flenë detet e mbi të
vjetër; zbehet
zhurma e shkumës
mbi plazhin shterpë.
Larg shkon stuhia mbi renë e zymtë.
Kthehet qetësia në qiell;
puhia ruan ende aromat
përhapet në fusha, dhe në vetminë
e bekuar shfaqet hija jote.*

Përktheu: Faslli Haliti

KUR KARL MARKSI SHIHE EKSODIN E SHQIPTARËVE DREJT ITALISË

Juan Goytisolo ka shkruar një roman brenda një romani, një vepër mbi pamundësinë për të shkruar një roman historik mbi Karl Marks

Karl dhe Xheni Marks të ringjallur, ulur në kanapë në tyre në Hampsted, ndjekin një dokumentar televiziv rreth zbarkimit të refugjatëve shqiptarë në një plazh privat italian... Ishin pikërisht pamjet e kronikave televizive me anije të mbushura plot shqiptarë që i arratiseshin vendit dhe varfërisë në kërkim të një jete më të mirë që e çuan shkrimtarin spanjoll Juan Goytisolo të shkruante më 1993-shin romanin "Saga e Familjes Marks", një fiction surreal, i cili vjen në shqip me përkthimin e Bashkim Shehut, i cili prej vitesh jeton në Barcelonë, botuar nga "Pika pa Sipërfaqe". Juan Goytisolo ka shkruar një roman brenda një romani, një vepër mbi pamundësinë për të shkruar një roman historik mbi Karl Marks. Megjithatë bëhet fjalë gjithashtu për një libër që nis nga një bindje personale: Nuk ka asnjë doktrinë që mund t'i aplikohet shoqërisë si një zgjidhje e vetme për të gjithë problemet.

VLERA E TEKSTIT PËRBALLË KULTURËS SË IMAZHIT

"Vepra nuk është as marksiste as anti-marksiste, është një trill që mbledh mbetjet e mbytyes së atij procesi që u quajt socializëm dhe që preku miliona njerëz në të gjithë botën. Goytisolo aspiron të vijojë të thërrasë debatin, polemikën, jetën", do të shprehjet botuesi i tij spanjoll Joaquin Estefania, më 1993, kur libri u botua, duke shuar zërat e debatit se vepra e Marksit po aktua-

lizohet përmes mendimtarëve si Deleuze, Derrida dhe Goytisolo. Saga e Familjes Marks është një portret i familjes me histori, ose rrëfeja e historisë përmes një familjeje, asaj të Karl Marksit filozofit, i shpëtuat nga vetja, që asiston i indinjuar rrënimin e ideologjisë dhe rënien e prestigjit të mendimit të tij, në fund të shekullit të 20-të.


Juan Goytisolo prodhon një kaleidoskop ku përzihen e shkuara dhe e tashmja, njerëz, vepra dhe diskurs dhe një angazhim i guxuar kritik, që insiston të kthejë në rrëfijë realitetin që prej kurthit bazik, nga i cili Marks dhe të tjerët (përfshi dhe armiq të historikë) vazhdojnë të jenë të gjallë dhe mendimtarë, edhe pse tashmë të pafuqishëm, duke parë televizor dhe duke konstatuar rënien e komunizmit. Botuar më 1993-shit, njëqind vjet pas vdekjes së Karl Marksit, romani pati jehonë në vende si Anglia, ShBA, Kanadaja, Gjermania dhe Franca, kritikët e të cilëve e konsideruan si "një prej librave më pak të ngatërruar dhe më argëtuesit e Juan Goytisolo". Gjithashtu e quajten "një aventurë letrare e destinuar të ripohojë vlerën e tekstit përballë kulturës së imazhit", "një libër i mbushur me humor dhe dituri, me jehonë të Suift dhe Servantes, që përzien në mënyrë të admirueshme imagjinatën dhe dokumentimin". Ironike, sarkastike, lojcake dhe e tepruar deri në dalldi, "Saga e Familjes Marks", është një roman gëzueshem anakronik që i jep në go-

ditje biografisë historike.

Poeti, eseisti dhe romancieri Juan Goytisolo Gay u lind më 5 janar të 1931-shit. Ai ka jetuar në Marrakesh nga viti 1997 deri në vdekjen e tij, më 2017-ën. Është konsideruar si shkrimtari më i madh i gjallë spanjoll i fillimit të shekullit të 21-të, edhe pse ka jetuar jashtë Spanjës prej viteve '50. Në nëntor të 2014-ës atij iu akordua çmimi Servantes, çmimi më prestigjioz letrar në botën spanjisht folëse. Juan Goytisolo u lind në një familje të shtresës së lartë. Ai deklaronte se niveli i statusit, i shoqëruar nga mizoritë e stër-stërgjyshit dhe kopracisë së gjyshit të tij (zbuluar nga leximi i letrave dhe dokumenteve të familjes), ishte një arsye madhore që ai iu bashkua partisë Komuniste në rininë e tij. I ati i tij u burgos nga qeveria republikane gjatë luftës civile të Spanjës, ndërsa e ëma, Julia Gay, u vra gjatë sulmit të parë ajror frankist në Barcelonë, më 1938-ën. Ai më pas ndoqi Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Madridit dhe në Universitetin e Barcelonës, por e la marrë diplomën.

JUAN GOYTISOLO KA PREKUR TERRITORE TË PA EKSPLORUARA

Një penë në kundërrymë që prej trilogjisë së formuar nga "Shenja Identiteti", "Don Juliani dhe Juani" pa tokë, që e vendoi mes autorëve më të mirë të letërsisë spanjolle bashkëkohore, vepra narrative e Juan Goytisolo ka prekur territore të pa eksploruara,



që vënë në pyetje gjithnjë e më shumë zhanrit e fiksonit. Ky vullnet për të shkruar në kundërrymë ka ndihmuar në menaxhimin e teksteve aq të veçanta si Makbara (1980), Virtutet e zogut vetmitar (1988), Karantina (1991), Saga e Familjes Marks (1993), Vendi i vendeve (1995), Javët e kopshetit (1997), Carajicomedia (2000), Perdja e gojës (2003) i mërguari nga këtu dhe atje (2008). Ai gjithashtu njihet si eseist, me vepra si "Kundër formave të shenjta" (2007) apo "Genet en el Raval" (2009).

Zbuloni sesi reagon Karli ndaj rënies së sistemeve që Josif Vizionaroviç me kompani ndërtoi në fjalën e tij. Marks viziton skenat e triumfeve të mëparshme në Moskë, ku gëlojnë bluzat MaLenin dhe liria e hamburgerëve janë gjithë bujë dhe kthehet në pritjen e ngrohtë të Hampstedit dhe ballon e filmuar nga kamerat për një Baroneshë të kuqe, që bëhet subjekti i një emisio- ni të së shtunës mbrëma me një seksologe feministe nga universiteti i UCLA, një anarkist nga Lufta civile e Spanjës...por botuesi i narrators, urbane, duhanpirësi me çibuk, z. Faulkner, dëshiron një roman best-seller, një histori për të qenë me fakte të vërteta dhe përshkrime që të copëtojnë zemrën rreth familjes së Marksit.

ARIAN LEKA, NË KËRKIM TË KËMISHËS SË HUMBUR

"Nuk u desh shumë kohë ta marrë vesh se turistët "perëndimorë" që mbërritën asokohe në Shqipëri nuk ishin Perëndimi i vërtetë. Ata jetonin në Perëndim, por Perëndimi nuk përfaqësohej prej tyre", shkruan Arian Leka

Dhe ja ku dashur pa dashur e hoqa një vijë dalluese mes europianit human dhe ballkanasit gjakësor. Ngecëm, kur ruleta e ndaloj rrotullimin. Kë zemëron më shumë kjo ndarje: europianët skeptikë apo ballkanasit që ëndërrojnë? Shtëpi e përbashkët, por secili në dhomën e vet...Kështu shkruan Arian Leka në esenë e tij "Të shpiket ballkanasi siç shpiket një armë", pjesë e librit që erdhi i botuar para pak ditësh nën titullin "Në kërkim të Këmishës së humbur" nga Botimet POETEKA. Një libër me 10 ese mbi vendin e çuditshëm pas Perdes së Hekurt.

Vend qendror në libër zë e kaluara, dëshmitë dhe interpretimet mbi ndodhitë e saj, dështimet e atyre që sunduan shtetin, kompromiset dhe komprometimi edhe më shqetësues i tjerëve që

drejtuan mënyrë të kontrolluar tranzicionin shqiptar pas rënies së Murit të Berlinit deri më sot.


Tekstet kushtuar Shqipërisë dhe Durrësit në veçanti, vendosin një të forta lidhëse mes historisë socialiste dhe simboleve detare të vendit e të vendlindjes, si pjesë e një sfondi më të gjerë marrëdhënies me Europën Perëndimore – Fake Europa dhe Ballkanin – Armiqësor. Marrëdhënia komplekse mes dy kinse qytetërimeve të dallueshme, ai evropian dhe ai ballkanas, që kthehet herë pas here në debate intelektuale, por edhe të politikës së madhe, ku Ballkani Perëndimor mbetet pikë e nxehtë dhe kritike në përfaqimin e familjes së madhe të Bashkimit Europian, kanë qenë prej kohësh shqetësim i shkrimtarit, i cili i ka trajtuar përmes letërsisë së tij. I sjell edhe në

këtë libër eseistik në tituj si "Perëndimi artificial dhe fake-Europa", "Europiani sheh ëndrra me ballkanas", "Ballkanasi konkuron për the Best Crime Movie of..." apo "Përrallë ballkanase për europianët e rinj".

Bashkë me mjetet e tjera rrëfimorë, Arian Leka shfrytëzon edhe mundësitë e teknikave fact-fiction e patchwork, duke përdorur Kujtesën dhe mbulojën e fiksonit dokumentar si një tejqyrë që afron e largon, zmadhon e zvogëlon në mënyrë të beftë hapësirën mes historive vetjake të autorit dhe historisë së Shqipërisë gjatë viteve të komunizmit. Marrëzia dhe banaliteti i së djeshmes bën të dukshme rrëfime drithëruese të një realiteti të zhdukur, që vazhdon të rikthehet, si për të na kujtuar jo thjesht historinë e dhimbshme të një diktature ab-

surde në zemër të demokracive të konsoliduara europiane, por edhe paradokset e peizazheve të sotme shqiptare që, në vend t'i rrafshonte dyshimet mbi të shkuarën, shtoi dilemat mbi atë çka ndodh para syve tanë. "Një ditë Europa mbërriti, sidoqoftë. Por gjatë kohës që Europa mungoi, gjatë periudhës së gjatë kur Shqipëria ruajti fare pak dhe vetëm simbolikisht marrëdhënie me Perëndimin, shteti komunist u kujdes dhe mund të thuhet se edhe ia doli, të krijonte përshtypjen se nuk kishim mbetur pa Europë. Përkundrazi!

Ne shqiptarët kishin privilegjin të takonim pjesën më të zgjedhur të evropianëve", shkruan Leka në një tjetër ese, titulluar "Perëndimi artificial dhe Fake-Europa". "Nuk u desh shumë kohë ta marrë vesh se turistët "perëndi-



morë" që mbërritën asokohe në Shqipëri nuk ishin Perëndimi i vërtetë. Ata jetonin në Perëndim, por Perëndimi nuk përfaqësohej prej tyre. Megjithëse harresa ka bërë punën e vet gërryese, duhet të ketë qenë jo pak zhgënjyes çasti kur të gjithë e morën vesh se "turistët tanë" të parë nuk kishin qenë thjesht turistë në punë të tyre", shkruan ai duke iu referuar të rinjve me bindje marksist-leniniste, që mbërrinin në Shqipërinë komuniste, si në një destinacion turizmi ideologjik.

Shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, në këmbim të njohjes dhe anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), e kanë mbështetur vetëm 30 për qind e qytetarëve të Kosovës

Arritja e një marrëveshjeje paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjatë vitit 2019, nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është konsideruar si e domosdoshme për të parandaluar destabilizimin e rajonit. Gjendja në rajon, konsiderohet fragjile, andaj edhe janë shpeshtuar thirrjet edhe nga komuniteti

ndërkombëtar që Kosova dhe Serbia të zgjidhin çështjet e pazgjidhura përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe obligative për të dyja palët. Presidenti Hashim Thaçi gjatë kësaj jave tha se në 12 muajt e fundit, në raportet në mes Kosovës dhe Serbisë, ka vetëm regres. "Nuk kam kurrfarë dyshimi që nëse këtë vit nuk do të bëjmë marrëveshjeje ligjërisht detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë, do të hyjmë në një zonë të rrezikshme të këtyre raporteve që mund ta destabilizojnë gjithë rajonin", deklaroi Thaçi. Nga ana tjetër, edhe politikanët nga partitë politike opozitare, konsiderojnë se situata politike jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon nuk është e qëndrueshme.

Lutfi Haziri, nënkryetari i partisë më të madhe opozitare në Kuvendin e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, thotë se rajoni në përgjithësi nuk mbahet mend të ketë qenë më i trazuar sesa që është në këtë vit. "Tirana po vlon nga një sindromë e re që e ka prekur opozitën atje, protestat dhe pakënaqësitë sociale. Beogradi, po ashtu, opozita po provon që pakënaqësitë t'i zgjedh në rrugë përmes protestave. Kemi një heshtje nderi ndoshta mor-

MARRËVESHJE QË SJELL STABILITET NË RAJON



tore nga opozitat në Maqedoni karshi suksesit të kryeministrit Zoran Zaev në arritjen e marrëveshjes me Greqinë. Por, edhe atje situata është në ekzaltim të këtij sukcesi... Por, pakënaqësitë janë gjithandej, pa përmendur Bosnjë e Hercegovinën, dhe gjendjen që kemi në Prishtinë", thotë Haziri. Ai thekson se partnerët ndërkombëtarë të Kosovës, qofshin ata në Bashkimin Evropian, në NATO apo në Uashington, po e shohin këtë situatë të brishtë si të rrezikshme, për shkak të rritjes së pakënaqësive sociale.

"Do të jetë e pafalshme nëse Kosovës i përsëritet ndonjë ngjarje e dhunshme. Do të jetë e pafalshme nëse i përsëritet Shqipërisë viti '97 ose e pafalshme edhe për Serbinë, sepse edhe ata kanë kaluar në procese të rënda, eedhe Bosnjës e Hercegovinës. Krejt ky ambient kërkon pjekuri të madhe politike dhe unitet. Nuk ka rrugë tjetër për të kaluar", thekson Haziri. Edhe analistët politikë tërheqin vërejtjen për rrezikun që mund të vijë si pasojë e rritjes së pakënaqësive sociale në vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën. Sipas tyre, gjendje të tilla janë rezultat i keqeverisjes. Analisti Artan Muhaxhiri, duke folur për Radion Evropa e Lirë, pos tjerash

thotë se nga përparimi i dialogut Kosovë - Serbi, varen edhe shumë zhvillime, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin në përgjithësi. Ai thotë se gjendja e status quo-së është e dëmshme për të dy palët, Kosovën dhe Serbinë. Ndërkaq, deklaratën e presidentit Thaçi, për mundësinë e destabilizimit të rajonit në rast të mungesës së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Muhaxhiri e sheh edhe si një lloj kërcënimi diplomatik.

"Raportet në mes Kosovës dhe Serbisë janë jashtëzakonisht komplekse dhe kanë ndikim të madh në Ballkan, pra si në aspektin pozitiv ashtu edhe negativ. Prandaj, edhe pesha politike është shumë e madhe. Ka mundësi që nëse nuk arrihet një marrëveshje finale, atëherë forcat të cilave u intereson destabilizimi, që në radhe të parë dirigjohen nga Rusia, ta shfrytëzojnë vakuumin dhe të ndikojnë negativisht në proceset politike dhe sociale", vlerëson Muhaxhiri. Ai thotë, po ashtu, se derisa shihet një angazhim i faktorit ndërkombëtar, në radhë të parë i SHBA-së dhe BE-së për një zgjidhje të problemit mes Kosovës dhe Serbisë, Rusia, sipas tij, më tepër do të preferonte një

gjendje kaosi në Ballkan.

"Nuk mund të anashkalohen edhe trazirat edhe keqpërdorimi dhe instrumentalizimi i situatës së amullisë", shton ai. Arritja e marrëveshjes paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po provohet përmes procesit të negociatave, i cili sipas paralajmërimeve në Prishtinë dhe Beograd, po hyn në fazën finale. Aktualisht, mospajtimet qëndrojnë në faktin se a duhet apo jo që pjesë e negociatave të jetë edhe opsioni i ndryshimit të kufirit, për çka ka dallime si brenda spektrit politik në Prishtinë, ashtu edhe tek ai në Beograd. Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) gjatë javës që po lëmë pas prezantoi një sondazh që u jep përgjigje disa prej dilemave kryesore që e karakterizojnë dialogun e fazës finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nga gjetjet e prezantuaras mes tjerash është thënë se 62 për qind e qytetarëve mbështesin vazhdimin e dialogut në formatin aktual. Shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, në këmbim të njohjes dhe anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), e kanë mbështetur vetëm 30 për qind e qytetarëve të Kosovës.



Politikani serb kërkon ndalimin e mjekimit të shqiptarëve nga kanceri në Beograd

Funksionari i lartë i Partisë Demokratike të Serbisë (DSS- Demokratska Stranka Srbije), Dragan Maršić, në një postim të vetin në Twitter ka thënë se një numër i shqiptarëve të Kosovës po mjekohet në Beograd, transmeton Koha.net. Lidhur me këtë, ai, përcjell portali telegraf.rs, ka propozuar se si duhet të silltet Beogradi me shqiptarët e Kosovës që kërkojnë mjekim në Beograd. "Quajeni këtë johumane, të pashpirt, por unë do t'ua ndaloja shqiptarëve të Kosovës (Shiptari, Arnauti, sido që të...) të mjekohen nga kanceri nëpër spitalet e Beogradit dhe ata do t'i dërgoja nëpër vendet e NATO-s të cila mbi ne (dhe mbi ata) hodhën uranium të varfëruar", ka shkruar Maršić, duke konstatuar se një numër i madh i shqiptarëve nga Kosova po kërkojnë mjekim nga kanceri në Beograd. Ky postim i tij, shkruan portali, ka nxitur reagime të shumta në rrjetet sociale duke shfaqur mospajtime të hapëta me të.

Hiqeni ose suspendojeni taksën!

Ambasada e Francës në Prishtinë përmes një përgjigjeje të dhënë "Zëri" ka thënë se taksë 100 për qind, e vendosur para më shumë se tre muajsh ndaj produkteve serbe, duhet të pezullohet ose të largohet. Por pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të ndërkombëtarëve për suspendim të taksës kryeministri Ramush Haradinaj po vazhdon të zotohet se taksë nuk hiqet pa pasur paraprakisht një marrëveshje për njohje të Kosovës nga Serbia, shkruan sot gazeta "Zëri". Vendimi i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës ndaj produkteve që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina ka nxitur reagime të shumta shteteve të fuqishme të botës, të cilat po vazhdojnë të kërkojnë heqjen ose pezullimin e kësaj tarife. Një gjë të tillë tashmë e ka kërkuar edhe Franca. Zyrtarë të Ambasadës së Francës në Kosovë i kanë thënë gazetës "Zëri" se qëndrimi i tyre rreth kësaj çështjeje është më se i qartë, që masa ndaj produkteve serbe dhe atyre boshnjake duhet të suspendohet ose të largohet. Ndërkohë, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) në mënyrë të pashtrur janë duke kërkuar pezullimin e tarifës prej 100 për qind. Si pasojë e barrikadimit të Qeverisë kundër heqjes së taksës SHBA-ja madje ka nisur edhe vendosjen e sanksioneve ndaj Kosovës.

PRESIDENTI GREK I KTHEHET NACIONALIZMIT FASHIST ÇAMËT, KRIMINELË DHE NAZISTË!

shitjen e temave kombëtare, si dhe ndaj fqinjëve të vendit. Sa i përket Shqipërisë, Pavlopoulos ka theksuar se Greqia nuk kundërshton perspektivën europiane të Tiranës, por ka shtuar se një perspektivë e tillë kërkon si kusht të vetëkuptueshëm respektimin e plotë dhe të sinqertë të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane, pra respektimin e të gjitha të drejtave themelore të njeriut, duke iu

referuar edhe njëherë çështjes çame.

"Nuk nënkuptohet perspektivë, ecuri e Shqipërisë fqinje drejt zonës europiane, kur për fat të keq, ende edhe sot nuk i ka hedhur tej ato kërkesa të pakonceptueshme të gjoja të drejtave të çamëve kriminelë, bashkëpunëtorë të nazistëve. Çfarë duhet të bëjmë, t'u japim të drejtë bashkëpunëtorëve të nazistëve?! Jemi

absolutisht të sinqertë, qëndrimi ynë nuk ka asgjë hakmarrëse. Qëndrimi ynë kërkon respektin e së drejtës dhe të historisë", tha Prokopis Pavlopoulos. Edhe ndaj Maqedonisë së Veriut, Pavlopoulos ka kërkuar zbatimin e plotë të "Marrëveshjes së Prespës", ndërsa ka çuar mesazh edhe drejt Ankarasë, duke kërkuar prej të gjithë grekëve të mos ketë përçarje dhe ndasi për çështjet kombëtare.



Nga zona kufitare e Konicës, ku u ndodh për festimet e 106-vjetorit të çlirimit të saj nga zgjedha osmane, presidenti i Greqisë Prokopis Pavlopoulos ka dërguar mesazhe për unitet në çë-

Pushtetmbajtësi koreanoverior, Kim Jong Un kryen 4.500 kilometra rrugë me tren të blinduar për t'u takuar me presidentin amerikan, Donald Trump këtë javë në Vietnam. Me avion udhëtimi do të zgjaste 5 orë

Një fluturim nga Koreja e Veriut në Vietnam zgjat pesë orë, por kreu i shtetit koreanoverior, Kim Jong Un ka zgjedhur variantin më të gjatë. Ai e nisi që të shtunën udhëtimin me tren të blinduar për në Vietnam, ku do të zhvillohet samiti i dytë me presidentin amerikan, Donald Trump. Agjencia shtetërore e lajmeve, KCNA publikoi pamje të nisjes së trenit me pushtetmbajtësin Kim. Në këtë udhëtim, Kim Jong Un shoqërohet nga anëtarë të lartë të byrosë politike dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, njofton agjencia koreane. Udhëtimi nga Pheniani deri në Hanoi me tren është 4500 kilometra. Pas mbërritjes në Dong Dang në Vietnam, pjesën e mbetur prej 170 kilometrash Kim do ta kryejë me automjet. Kjo autostradë, zakonisht mjaft e frekuentuar pritet të bllokohet plotësisht për trafikun të martën nga ora 06.00-14.00, ora lokale, njoftojnë mediat shtetërore vietnameze. Edhe masat e sigurisë në Hanoi janë forcuar, njoftojnë reporterë të AFP-së.

Pushtetmbajtësi Kim Jong Un edhe udhëtimin e parë zyrtar jashtë vendit në mars të vitit të ka-

ME TREN TË BLINDUAR PËR T'U TAKUAR TRUMPIN



luar në Kinë e kreu me tren. Një tren i blinduar, të cilin e ka përdorur edhe babai i tij, Kim Jong Il në dhjetor 2011 në udhëtimet e tij në Kinë dhe Rusi. Para samitit, Kim Jong Un pritet të bëjë një vizitë zyrtare në Vietnam. Siç ka bërë të ditur Ministria e Jashtme në Hanoi, Kim në „ditët e ardhshme“ pritet në Vietnam, por nuk u dha asnjë njoftim më i saktë.

Të mërkurën dhe të enjten, në qendër të takimit me presidentin amerikan, Donald Trump janë çarmatimi atomik i Koresë së Veriut dhe shpërblimet që do të ofrojë Uashingtoni. Në samitin e parë në Singapor në qershor, Kim kishte ofruar parimisht gatishmërinë për „çarmatimin e plotë nuklear“, por nuk u bënë marrëveshje konkrete se si do të kryhet

shkatërrimi i arsenalit atomikë Presidenti amerikan ndodhet nën presion kohor, pasi ai duhet t'i paraqesë kongresit rezultate konkrete. Në ndërkohë, presidenti i SHBA-ve Donald Trump ka deklaruar se nëse Koreja e Veriut do të braktisë armët e saj bërthamore, ajo mund të jetë një nga fuqitë më të mëdha ekonomike në botë. Trump në llogarinë e tij Twitter duke përmendur samitin që do të zhvillojë në Vietnam me liderin e Koresë së Veriut Kim Jong-un tha se Koreja e Veriut "ka potencialin të rritet më shpejtë se ndonjë vend tjetër".

"Ne presim që të vazhdojmë progresin e arritur në samitin e parë në Singapor. Presidenti Kim është ndoshta më i vetëdijshëm se gjithkush për faktin se pa armë

bërthamore, vendi i tij mund të bëhet shpejt një nga fuqitë e mëdha ekonomike kudo në botë. Falë vendndodhjes, popullit të saj dhe (atij), ajo ka potencial që të rritet më shpejt sesa çdo vend", theksoi Trump në deklaratën e tij.

Ai edhe gjatë një takimi me krerët lokalë ka potencuar se me Kim kanë ndërtuar "marrëdhënie shumë të mira" dhe se nuk kanë asnjë nxitim në çarmatosjen e Koresë së Veriut nga armët bërthamore. Më 27-28 shkurt Trump dhe Kim do të zhvillojnë një takim në Vietnam, ku për këtë shkallë e sigurisë do të rritet në nivelin më të lartë. Trump dhe Kim për herë të parë u takuan më 12 qershor 2018 në samitin historik në Singapor dhe nënshkruan një marrëveshje gjithëpërfshirëse.



Egjipti përgatitet për të luftuar... me karkalecat

Egjipti do të përballet me një tufë karkalecash që do të godasin vendin për shkak të shirave afatgjatë në shtetin fqinj, Sudan. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë do të mbledhet në një takim në Jordani për të diskutuar për masat që do të ndërmerren për këtë situatë të pazakontë, pasi insektet mund të shkatërrojnë të mbjellat e fermerëve.

Një ekspert i OKB-së, Keith Cressman tha për Sputnik se javët e ardhshme do të jenë kritike për të mbajtur situatën nën kontroll. Ndërsa qytetarët të cilët mësuhan për këtë lajm, e krahasojnë këtë fenomen të ngjashëm me atë që përshkruhet në Dhiatën e Vjetër të Biblës.

Në rrjetet sociale, ata kanë thënë se "historia po përsërit vetveten", ndërsa të tjerë e kanë konsideruar "profeci vetëpërbushëse". Deri tani ekspertët kanë trajtuar 200 mijë hektarë tokë në Egjipt që nga Dhjetori 2018. Dëmtimi më i madh i tokave bujqësore nga karkalecët ka ndodhur në periudhën 2003-2005 kur më shumë se 12 milionë hektarë tokë në Afrikë u shkatërruan. Rikuperimi pati një kosto 750 milionë Dollarë.

Kaos dhe viktima në Venezuelë në përpjekjen për të futur ndihmat humanitare në vend. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo thekson, se ka ardhur koha "për të ndihmuar popullin e dëshpëruar venezuelan"

Synimi për të futur në vend ndihmat humanitare ka shkaktuar kaos dhe viktima në Venezuelë. Dy vetë humbën jetën, 300 të tjerë u plagosën. Forcat e sigurisë përdorën gazin lotsjellës dhe plumba gome në disa qytete kufitare. Sekretari amerikan i shtetit, Mike Pompeo shkroi në twitter se "ka ardhur koha për të vepruar" dhe "për të ndihmuar "popullin e dë-

"KA ARDHUR KOHA PËR TË VEPRUAR"



shpëruar venezuelan". Ai bëri të ditur "masa" të Uashingtonit për mbështetjen e demokracisë në Venezuelë.

Pas njoftimit për humbjen e jetës së dy civilëve, edhe këshilltari i presidentit amerikan për sigurinë, John Bolton shkroi në twitter

se autorët do të dalin para drejtësisë. „Ushtria është për të mbrojtur civilët e jo për të qëlluar mbi ta.“ Të premtën qeveria amerikane paralajmëroi, presidentin Maduro, nga përdorimi i dhunës. „Bota po shikon“, thuhet në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë të publikuar të

premtën. Sipas presidentit të vetëshpallur, Juan Guaido hyri ndërkohë në Venezuelë furnizimi i parë me ndihma humanitare nga jashtë të shtunën. „Ky është sukses i madh, Venezuela“, shkroi Guaido, në twitter dhe i njohur ndërkohë si president nga më shumë se 50 shtete. Shumica e ndihmave humanitare qëndrojnë në kufi me Kolumbinë, në qytetin Cucuta. Aty ndodhen edhe rreth 600 tonë ushqime dhe ilaçe nga SHBA. Mijëra vullnetarë dhe përkrahës të presidentit të vetëshpallur, Juan Guaido kanë shkuar të marrin ndihmat humanitare. Presidenti Maduro ndërkohë ndërpreu të gjitha lidhjet me Kolumbinë. Për shkak se presidenti Maduro ka mbyllur kufirin me Kolumbinë dhe Brazilin, vëzhguesit i tremben një gjak-

derdhjeje të madhe, nëse ushtarët do të përpiqen të ndalin njerëzit me dhunë.

Në Urena, zonë kufitare me Kolumbinë të shtunën, ka pasur trazira. Ushtria venezuelane ka përdorur ndërkohë gazin lotsjellës dhe plumba gome për të shpërndarë një demonstratë në kufi. „Ne duam të punojmë“ dëgjoheshin thirrjet e masës së mbledhur përballë gardës kombëtare. Dy civilë ndërruan jetë, sipas një deputeti venezuelan, kur në San Francisco de Yuruani donin të sillnin ndihmat brenda kufirit, dhe aty u qëlluan nga ushtarët. Dëshmitarët njoftojnë, se kanë parë tanke nga ana venezuelane që kanë shkatërruar barrierat e vëna, me të cilat bllokohet ura Simon Bolivar, që lidh Venezuelën me Kolumbinë.

PUTIN DO NDANTE KOSOVËN SI GJERMANINË, MES PERËNDIMIT DHE RUSISË

Pavarësia e Kosovës ishte një humbje e madhe shpirtërore si për Serbinë, ashtu edhe për Rusinë, e cila u detyrua të pranonte një rezolutë paqeruajtëse, pas sulmeve ajrore amerikane kundër Serbisë, pavarësisht lidhjeve të Moskës me Beogradin dhe interesave ruse në Ballkan. Ky hap pasqyroi dobësinë ushtarake, ekonomike dhe diplomatike të Rusisë pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik

“Vladimir Putin planifikonte ta ndante Kosovën në dy pjesë, Veriun e kontrolluar nga Rusia dhe Lindjen e kontrolluar nga Perëndimi”. Jamie Shea, ish-zyrtarit të lartë të NATO-s, i cili rrëfen për herë të parë se Moska kishte bërë gati ushtrinë 2 dekada më parë, por u ndalua të hynte falë aleatëve europianë të shqiptarëve. Shea ishte fytyra e vetme e NATO-s gjatë misionit të aleancës për të detyruar forcat serbe të largoheshin nga Kosova në vitin 1999. Sa i admiruar në Kosovë, aq edhe i urreyer në Serbi, ai ishte fytyra e vetme që shqiptarët dhe serbët panë në televizor për muaj të tërë. Sot, veterani i NATO-s mban një profil më të ulët publik si profesor në Anglinë jug-perëndimore, por thotë se ndalimi i gjenocidit ndaj shqiptarëve është krenaria e tij më e madhe.

Në një intervistë me BIRN mbi fushatën e NATO-s, që i dha fund sundimit serb në Kosovë, ai kujtoi momentin tronditës në qershor të vitit 1999, kur trupat ruse hynë në Kosovë nga Bosnja dhe “pushtuan” aeroportin e Prishtinës përpara syve të trupave të NATO-s. Për disa ditë, flitej për një përballje, madje edhe për luftë, midis NATO-s dhe Rusisë, mes frikës se presidenti rus Vladimir Putin mund të vendoste të pushtonte Veriun e Kosovën.

KOSOVA U “SHPËTUA” FALË REPUBLIKËS ÇEKE, HUNGARISË DHE POLONISË

“Rreziku më i madh që kemi pasur atë ditë ishte shqetësimi që rusët do të dërgonin forca të specializuara drejtpërdrejt nga Rusia në Kosovë për të përforcuar trupat e tyre që kishin marrë aeroportin,



duke formuar kështu një kontingjent të madh ushtarak, i cili planifikohej të aneksonte Veriun e Kosovës”, thotë ish-zyrtari. “Kjo perspektivë bëri që komandantët e NATO-s të përhapnin alarmin se Kosova do të ndahej si Gjermania, midis zonave ruse dhe perëndimore”, thekson ai.

“Mendoni për Berlinin pas Luftës së Dytë Botërore”, shpjegoi Shea, duke kujtuar ndarjen Lindje-Perëndim të kryeqytetit gjerman, i cili vazhdoi të qëndronte i tillë për pothuajse gjysmë shekulli. Për Shean, Kosova u “shpëtua” falë Republikës Çeke, Hungarisë dhe Polonisë, të cilat sapo kishin hyrë në

aleancën e Atlantikut të Veriut, por bllokuan hapësirën e tyre ajrore, duke ndaluar Rusinë që të dërgonte trupa shtesë nga toka ose ajri.

“Më pas, kontingjenti i trupave ruse u tërhoq brenda disa muajsh- kujton Shea- duke e bërë NATO-n fuqinë e vetme që do të monitoronte territorin e Kosovës”. Ushtria serbe u larguan nga Kosova, por Shea thotë se falë ndërhyrjes së Hungarisë, Çekisë dhe Polonisë, NATO-ja pengoi gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës. “Unë jam i lumtur që NATO ishte në gjendje të ndalonte spastrimin etnik në Kosovë dhe të mësonte nga gabimet me Bosnjë” tha



Shea. Por edhe pse kanë kaluar njëzet vjet, Shea nuk e nënvlerëson rrezikun që Rusia të zgjerojë ndikimin e saj në rajon, duke thënë se Ballkani vazhdon të konsiderohet nga Moska si “dera” e saj për në Europë. Por ai gjithashtu këmbëngul se tanimë Ballkani është i orientuar drejt integritetit euro-atlantik dhe Rusia ka fituar pak terren. “Nëse ju ktheni kokën prapa 20 vite më parë dhe shikoni gjendjen kaotike të rajonit në atë kohë, do të kuptoni se shumica e vendeve të Ballkanit po afrohet gjithnjë e më pranë strukturave të NATO-s, BE-së dhe integritetit euro-atlantik”, tha ai. “Nëse do të isha Presidenti Vladimir Putin, sigurisht nuk do të isha i lumtur për këtë proces”, deklaroi Shea, i cili shpreh krenarinë që kontribuoi në lirinë e shqiptarëve të Kosovës.

Ish-zyrtari i njohur nuk i mbështet të gjitha zhvillimet e fundit në vend, veçanërisht formimin e ushtrisë së Kosovës, një vendim që NATO e ka konsideruar si të papërshtatshëm”. Megjithatë, Shea këmbëngul se Kosova është e sigurt me mbështetjen ndërkombëtare dhe shpreson që qeveria e Prishtinës të përqendrohet më

shumë në çështje si arsimit dhe joshuria. “Ka disa anëtarë të NATO-s të cilët do të ishin të lumtur që do të kishin 5000 trupa të NATO-s në territorin e tyre, kështu që Kosova nuk duhet të harrojë se është një vend i mbrojtur ndërkombëtarisht”, përfundoi ai.

VIZITA E PARË DHE E FUNDIT E PUTINIT NË KOSOVË

Ishte vera e vitit 2001 kur Presidenti rus Vladimir Putin shkeli për të parën herë në tokën shqiptare. Duke vizituar trupat ruse që kishin uzurpuar Aeroportin e Prishtinës, kreu i Kremlinit bëri thirrje edhe njëherë për mbrojtjen e sovranitetit të Serbisë, duke deklaruar se “terroristët shqiptarë ishin fajtorë për shumicën e paqëndrueshmërisë së rajonit”. Atë të diel presidenti Putin pati një ndalesë të paplanifikuar në Kosovë. Fluturimi i tij nga Beogradi u njoftua në minutën e fundit për shkak të shqetësimeve të sigurisë, edhe pse Moska kishte vendosur në atë kohë në Kosovë 3.000 trupa ruse. “Ne duhet të bëjmë gjithçka për të çarmatosur terroristët shqiptarë”, tha Putin pak para se të arrinte në Aeroportin e Prishtinës. Kjo ishte hera e parë që ai vizitoi Kosovën, por jo hera e fundit që do të fliste për të.

Më 17 shkurt të 2008-ës, pjesa më e madhe e botës (109 shtete) vendosën se Kosova duhet të shpallej zyrtarisht një shtet i pavarur, pavarësisht notave të ashpra të protestës nga Serbia dhe Rusia. Që nga ajo ditë e në vazhdim, Presidenti Vladimir Putin ka akuzuar vazhdimisht Europën dhe Shtetet e Bashkuara për standarde të dyfishta, duke përmendur të gjitha rajonet separatiste që kërkojnë pavarësinë dhe duke e konsideruar pavarësinë e Kosovës si “të paligjshme”. Ndryshe nga Perëndimi, Rusia ka mbështetur për vite të tëra Serbinë, duke e cilësuar ndërhyrjen në Kosovë si shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Madje Rusia ka përdorur vazhdimisht Kosovën si një mundësi strategjike për të rivendosur rolin e saj në sistemin ndërkombëtar.

Në fakt, pavarësia e Kosovës ishte një humbje e madhe shpirtërore si për Serbinë, ashtu edhe për Rusinë, e cila u detyrua të pranonte një rezolutë paqeruajtëse, pas sulmeve ajrore amerikane kundër Serbisë, pavarësisht lidhjeve të Moskës me Beogradin dhe interesave ruse në Ballkan.

Ky hap pasqyroi dobësinë ushtarake, ekonomike dhe diplomatike të Rusisë pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik.

(BIRN)

FC SHKUPI VAZHDON ME SERINË POZITIVE

BAJRAMI: GOLI DHURATË PËR BABAIN TIM

Shkup, 25 shkurt - Skuadra e FC Shkupit ka shënuar fitore me rezultat 3:0 dhe vazhdon të mbetet ekipi pa disfatë që nga muaji nëntor dhe në shtatë ndeshjet e fundit ka shënuar katër fitore dhe tri barazime. Padyshim se ky sukses është punë kolektive por edhe meritë e trajnerit Umit Karan, ndërsa në anën tjetër Muharem Bajrami po tregohet lider dhe kapiteni i vërtet i skuadrës. Pikërisht në ndeshjen e sotme ndaj Pobodës, Bajrami shënoi një super gol duke hapur rezultatin në minutën e 38 në 1:0, ndërsa golin e shënuar ja dedikoi babit të tij. "Është ndjesi e mirë kur ke vazhdimësi të rezultateve pozitive, ndërsa kjo është meritë e të gjithë atyre që po punojnë në klub. Golin e sotëm ja dedikoj babait tim i cili në 17 vitet të karrierës sime profesionale, sot ishte për herë të parë të më shikojë në ndeshje dhe kjo ishte një dhuratë e mirë për te", ka përfunduar kapiteni Bajrami


"Është ndjesi e mirë kur ke vazhdimësi të rezultateve pozitive, ndërsa kjo është meritë e të gjithë atyre që po punojnë në klub. Golin e sotëm ja dedikoj babait tim i cili në 17 vitet të karrierës sime profesionale, sot ishte për herë të parë të më shikojë në ndeshje dhe kjo ishte një dhuratë e mirë për te", ka përfunduar kapiteni Bajrami



rezultatit me golin e mrekullueshëm të Bajramit, më pas kishim pak presion që ta rrisim epërsinë sa më shpejtë dhe në fund doli gjithçka siç duhet, fituam me rezultat 3:0. Këtë fitore ja dedikojmë portierit tonë Igor Aleksovski që të dielën kishte ditëlindjen, ta festojë sa më mirë dhe të shërohet sa është e mundur më shpejt", ka thënë Angelov i cili me golin që shënoi sot ka arritur në katër gola gjatë kësaj sezone. Po ashtu edhe

mbrojtësi i "bardhekaltërve" Amir Bilali ka folur për mediat, duke thënë se fitoren ia dedikojnë portierit Igor Aleksvoskit që është jashtë fushave për shkak të lëndimit, duke ia uruar kështu ditëlindjen. "Jemi të gëzuar me këtë ndeshje dhe këtë fitore ia dedikojmë portierit tonë Igor Aleksvoskit që sot feston edhe ditëlindjen. Fitoren ua dedikojmë të gjithë çunave të gjithë "Shvercerave" dhe jemi shumë të lumtur për këtë karakter

dhe këtë fitore që e morëm sot në shtëpinë tonë. Kam shumë besim dhe jam shumë optimist, ku mendoj se ndeshje pas ndeshje të përqëndrohem dhe të lozemi me shpirt dhe me zemër në fushë siç luajtëm sot dhe mendoj që çdo gjë është e arritshme", tha mbrojtësi i Shkupit, Amir Bilali. Shkupi ndeshjen e radhës e luan kundër ekipit të Akademija Pandev në Strumicë, skuadër kjo që gjithashtu është në formë pozitive.



Osmani: Konkurrent i Shkëndijës nuk është vetëm Vardari

Shkup, 25 shkurt - Epërsia e siguruar që në start të ndeshjes duhej të menaxhohet me gol të dytë nga ana e Shkëndijës vlerëson trajneri Qatip Osmani, që beson se në pjesën e parë kundër Makedonija Gj.P. skuadra i pati gjitha mundësitë të mbyllte fatin e takimit. Kështu skuadra shkupjane goli të Omar Imerit iu përgjig me realizimin e Robsonit nga gjuajtja e lirë në fraksionin e dytë, që në fund rezultoi vendimtar për barazimin 1:1. "Shënuam gol shumë herët, kishim lojë dhe disa raste por mendoj se duhej që në pjesën e parë duhej ta kishim vendosur fatin e takimit. Pas pranimit të golit nuk reaguam ashtu siç duhet, nuk gjetëm zgjidhje për të depërtuar drejt portës kundërshtarë. U munduam me zëvendësime t'a freskojmë sulmin, por megjithatë nuk arritëm të ndryshojmë gjë dhe në fund dolëm me barazim", komenton ndeshjen trajneri Qatip Osmani. Shkëndija me fitore do të kishte çuar në 10 pikë diferencën ndaj vendit të dytë, mirëpo humbja e Vardarit bëri që të ruhet distanca prej 8 pikëve, tashmë ndaj Akademija Pandevit që ngjitet pas kuqezinjve në tabelë. "Sigurisht se është mirë që ruajmë distancën me vendin e dytë, por sërish mendoj se Shkëndija këtu duhej të merrte tre pikët. Megjithatë edhe kështu nuk është keq, pasi kampionati është i gjatë dhe para vetes kemi edhe shumë ndeshje. Duhet të jemi të kujdesshëm sepse përveç Vardarit tashmë konkurrent kemi edhe Akademija Pandevin që tregon paraqitje të mira. Kështu që mendoj se konkurrenti i Shkëndijës nuk është vetëm Vardari", përfundoi Qatip Osmani.




Zeneli shkëlqen te Reims

Arbër Zeneli shënon golin e tij të parë në Francë në ndeshjen e tij të katërt në Ligue 1. Ishte aktivizuar si zëvendësues ndaj Marseille, Toulouse dhe Rennes (dha asist), ndërsa në sfidën e parë në rolin e titullarit sulmuesi i përfaqësueses së Kosovës, e parë me fanellën e Reims, pikërisht ndaj Montpellier, në tranfertë, duke lënë shenjë në fitoren 2-4. Zeneli realizoi me 11-metërsh në minutën e 47-të për avantazhin e përkohshëm 1-2, ndërsa kishte shërbyer edhe në rastin e golit të parë. Vendasit arritën të barazonin, por pësuan dy gola të tjerë gjatë pjesës së dytë. Zeneli në këtë transfertë qëndroi në fushë deri në fund, duke i luajtur minutat të plota. Paraqitja e tij në këtë ndeshje tregoi se për pak javën 23-vjeçari jo vetëm ka mundur të integrohet me grupin, por po shndërrohet në një nga pikat më të forta të skuadrës. Kujtojmë se Reims shpenzoi rreth 4 milionë euro, që shkuan në arkat e Heerenveenit, për kartonin e Zenelit.

Khaka i lumtur për fitoren e radhës


Granit Xhaka është shprehur i lumtur për fitoren e radhës të "Topçinjve". Arsenali ka vazhduar me formën e mirë në Premierligë. Në ndeshjen e vlefshme për xhiron e 27, Arsenali e mundi në shtëpi Southamptonin 2-0, për të marrë pikët e plota dhe për të pushtuar pozitën e katërt, që e mbante Man Unitedi, por e humbi me barazimin 0-0 me Liverpoolin. Golat për "Topçinjtë" i realizuan Alexandre Lacazette në minutën e shtatë dhe Henrikh Mkhitarian në minutën e 17'. Pas ndeshjes, Xhaka ishte i lumtur me tri pikët që mori skuadra e tij, pikë që kanë shijen e Champion-



sit. "Tri pikë, portën e paprekur, po shkojmë në shtëpi të lumtur. Kalofshi të dielë të bukur Gunners", shkroi Xhaka menjëherë pas ndeshjes

në Instagram. Me këtë fitore, Arsenali ka shkuar në kuotën e 53 pikëve, një më shumë se Man Unitedi që barazoi 0-0 me Liverpoolin

Bardhi: Lojtarët e Realit binin në tokë çdo dy minuta



Sulmuesi i Levantes, Enis Bardhi është shprehur jo i lumtur me refe-

rimin e padrejtë sipas tij në ndeshjen e mbrëmshme mes Levantes

dhe Real Madridit. Në ndeshjen e mbrëmshme mes Levantes u panë shumë dyshime në referim, në disa vendime që ishin në të mirë të klubit madrilen. Duke folur për këtë Bardhi tha se ata nuk luanin një lojë burrnore, binin në tokë pa i prekur fare, madje kërkonin edhe penallti. "Ne luajtëm një ndeshje të mirë dhe merituam më shumë, mirëpo ishte shumë e vështirë pasi lojtarët e Realit binin në tokë çdo dy minuta. Tanimë dëshirojmë të jemi të përgatitur mirë edhe në vijim dhe ti kthehem fitoreve", u shpreh Bardhi.

NBA

ZHGËNJEJNË SAN ANTONIO DHE TORONTO, DENVER NË SUPERFORMË

San Antonio Spurs është mundur për herë të dytë radhazi në NBA, në ditët e fundit. Ka qenë New York Knicks, skuadra që ka triumfuar në shtëpi, në "Madison Square Garden", me rezultatin 130-118

Ishin vetëm 3 sfidat në mbrëmjen e NBA, por spektakli nuk mungoi as këtë herë. Spikat padiskutim fitorja e New York Knicks që u rikthye te suksesi në Madison Square Garden pas plot 18 humbesh radhazi. Në mënyrë surprizë skuadra e trajnerit Fizdale që nuk fitonte në shtëpi që nga 1 dhjetori mposhti me rezultatin 130-118 San Antonio Spurs. Një disfatë që djeg në shtëpinë e skuadrës teksane sepse tashmë kualifikimi në play-off është komplikuar jo pak për formacionin e Gregg Popovich. San Antonio ka zbritur në vendin e 7-të të konferencës së Perëndimit dhe ndjen presionin e Clippers dhe Kings nga pas. Ylli i Spurs DeMare DeRozan bëri atë që duhet të bënte në këtë



përballje, realizoi 32 pikë ndërsa i ndihmoi të tijtë edhe me 4 asiste e 9 rebound, por diferencën në këtë ndeshje e bëri loja e mirë në grup e New York Knicks. 6 basketbollistë të vendasve arritën një kuotë pikë-

sh me dy shifra ndërkohë që spikati Doston me 27 pikë. Fitore shumë e thjeshtë për Denver Nuggets ndaj Los Angeles Clippers. Në Pepsi Center, formacioni nga Colorado ishte i papërmbjashtëm duke triumfuar me rezultatin 123-96. Për të marrë fitoren e 4-t radhazi dhe për të blinduar vendin e dytë në Përndim Denver kishte nevojë për një super Nikola Jokic. Basketbollisti serb me 22 pikë dhe 16 rikuperime ishte më i miri mbi parket për Nuggets, ndërkohë që nuk mbeti pas as Paul Millsap që bëri gjithashtu një figurë të shkëlqyer. Pas 7-të fitoresh rresht u thyje në mënyrë shumë surprizuese Toronto Raptors që ra në shtëpi ndaj Orlando Magic me shifrat 98-113. Skuadra nga Florida vijoi momentin pozitiv duke marrë fitoren e 8-të në 10 ndeshjet e fundit, sukses që rriti ndjeshëm shanset e Orlando në Lindje. Ndërkohë Toronto me këtë disfatë e sheh veten akoma më të distancuar nga Milwaukee Bucks dhe vendi i parë në sezonin e rregullt në Lindje bëhet një mision shumë i vështirë për skuadrën kanadeze.



Donnarumma mbush 20 vjeç, në kontratën e re ka një klauzolë

Milani i gëzohet vendit të katërt në renditje dhe rikthimit në nivele të larta të portierit Gigio Donnarumma. Ky i fundit mbush sot 20 vjeç. Ndërkohë, vlerësimi i tij në treg po rritet përsëri. Tani kushton rreth 60 milionë euro, por me kualifikimin në Ligën e Kampioneve, portieri i talentuar italian mund të kapë shifrën e 100 milionëve. Kontrata e tij skadon në qershor 2021, prandaj drejtuesit e kuqezinjve do të bëjnë mirë të zgjidhin çështjen e rinovimit sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu, sipas "Corriere della Sera", në rastin e një kontrate të re, do të ketë një klauzolë të shtrenjtë largimi. 20-vjeçari konisderohet si pasardhësi dinjitoz i Gigi Buffon në portën e kombëtares së Italisë. Që nga debutimi i tij me Milanin, më 25 tetor 2015, në moshën 16 vjeç e 8 muaj, Gigio e ka vendosur veten si vazhdim i shkollës historike italiane të portierëve. Një detyrë jo e thjeshtë, por që Donnarumma e ka bërë mjaft mirë. Jo me deklarata, por me fakte në fushën e blertë. Nga debutimi deri më sot, ai ka luajtur 131 ndeshje në Serie A. Një portier me potencialin e tij është i lakmuar në mënyrë të qartë nga klubet më të mëdha të Europës, me Real Madrid dhe PSG në vendin e parë. Gjatë muajve, me ndryshimin e pronarëve të Milanit, agjenti i tij, Mino Raiola, shpesh ka hapur çështje që lidhen me rinovimin, klauzolën e largimit dhe planifikimin e ardhshëm të klubit. Sidoqoftë, Donnarumma po përjeton momente të shkëlqyera, edhe falë ndryshimit të trajnerit te kuqezinjët. Ai ka besimin e pakufi të Gattuso. Në karrierën e vet ka fituar, për momentin, vetëm Superkupën Italiane të vitit 2016, kundër Juventusit.

Rodgers dhe Benitez në garë për stolin e Leicesterit

Pasi zyrtarizuan shkarkimin e Claude Puel pas humbjes me Crystal Palace, drejtuesit e Leicester janë vënë në lëvizje për të gjetur pasuesin e francezit në pankinë. Emri që përmendet në 'King Power Stadium' është ai i teknikut aktual të Celtic, Brendan Rodgers. Sipas mediave angleze, 'Dhelprat' janë të gatshëm të paguajnë edhe një shumë të hollash në drejtim të skocezëve në mënyrë që ata të lënë të lirë ish-teknikun e Liverpool



para përfundimit të sezonit. Përveç Rodgers, drejtuesit e klubit pëlqejnë edhe Rafa Benitez, teknikun aktual të Newcastle.

FIFA i merr Perusë organizimin e Kampionatit Botëror U-17

Federata Botërore e Futbollit (FIFA) i mori Perusë organizimin e Kampionatit Botëror U-17, për siç theksohet në vendim "problemeve të shumta infrastrukturore dhe organizative". Pas disa inspektive, FIFA konstatoi se Peruja nuk do të jetë organizatore e denjë, kështu që në tetor nuk do mbahet Botërori U-17 në këtë vend. FIFA bën të ditur se së shpejti do të gjejnë një organizator alternativ. "Falënderojmë Federatën e Futbollit dhe autoritetet e Perusë për mundin që dhanë. Në të ardhmen përsëri mund të kandidojnë për organizimin e garës në vendin e tyre", thotë FIFA.



Publicitet

Në bazë të nenit 31 të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese (Gz. Zyrtare nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), nenit 44 nga Statuti i IPSH Institutit për trashëgimi shpirtërore e kulturore të Shqiptarëve - Shkup dhe vendimi i Këshillit të Institutit nga seanca e mbajtur më 21.02.2019, drejtori i IPSH Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup publikon:

Konkurs publik për zgjedhje/rizgjedhje në titull shkencor

I - 1 (një) KËSHILLTAR SHKENCOR në njësinë për Gjuhë shqipe:

Kandidatët për këshilltar shkencor duhet të kenë shkallë shkencore *doktor i shkencave* nga sfera për të cilën zgjidhen, më shumë punime shkencore të recensuara të botuara individualisht ose në bashkëpunim me autorë tjerë, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese dhe arritje të rëndësishme në përdorim të rezultateve shkencore-hulumtuese dhe kontribut në avancimin e kuadrove mësimore-shkencore dhe përmeshje të kushteve për zgjedhje në titullin *këshilltar shkencor*;

Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet nga dispozitat e parapara në Ligjin për veprimtarinë shkencore-hulumtuese (Gz. Zyrtare nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16).

III

Kandidatët duhet ti parashirojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
- certifikatë për shkallë të mbaruar të arsimit (original ose të vërtetuar në noter);
- listë të punimeve të botuara në kopje të punimeve më të rëndësishme (në 4 kopje).

Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet për konkursin të parashitohen në adresën:

IPSH Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, (3215 382) faks, postal 171, Shkup ose personalisht në arkivin e Institutit.

Drejtor

Prof. D-r Skender Asani



Mourinho nuk do të kthehet kurrë në Premier Ligë

Jose Mourinho edhe pse për momentin është i papunë që nga shkarkimi nga stoli Manchester United, ka deklaruar se nuk dëshiron që të jetë më pjesë e Premier Leagues. Duke komentuar humbjen e Chelseat në Carabao Cup kundër Manchester City, Mourinho u pyet për një rikthim në Angli. "Në Premier, për t'u kthyer me trajnime në Premier? Nuk dëshiroj ta bëj këtë. Do të doja të ndryshoja", tha me këmbëngulje portugezi. "Shikoni El Classicon. Po, unë e shoh atë. Unë jam ende i vëmendshëm, më pëlqen shumë futbollit, kur punoni, ju përqendroni më shumë në ligën tuaj". "Tani ju keni shumë më tepër hapësirë për të parë dhe me të vërtetë dëshiroj të shikoj anët tjera të futbollit", pohoi trajneri. Ndryshe, Mourinho kohët e fundit po spekulohet se do të merr drejtimin e Real Madridit ose Interit.



Chelsea konfirmon Sarrin

Maurizio Sarri konfirmohet në stolin e Chelseat të paktën deri të mërkurën në mbremje kur Chelsea i tij të sfidojë Tottenhamin në Premier League. Paraqitja e skuadrës në finalen e FA Cup, ishte inkurajuese dhe pavarishtë humbjes me penallti, Sarri tregoi se ka ende nën kontroll dhomat e zhveshjes dhe për këtë arsye presidenti Abramovich ja ka dhënë dhe një shans tjetër. Gjithsesi një humbje në derbin e Londrës ndaj Tottenham të mërkurën mund ti vendosë kapak largimit të Sarrit nga Chelsea.

NEYMAR: MESSI ISHTE SHUMË I VEÇANTË PËR MUA NË BARCELONË




"Sinqerisht, është e vështirë, shumë e vështirë për mua që të flas për Messin. Ai ishte shumë i veçantë për mua në Barcelonë, e them këtë për të gjithë. Në momentin kur më duhej mbështetja më e madhe, lojtari më i mirë në botë mbërriti dhe më dha një dorë. Ai tha: Eja, unë jam këtu për t'ju ndihmuar!", ka theksuar Neymar

Neymar Jr, i cili po riaftësohet nga dëmtimi në shputën e këmbës (këto ditë ndodhet në Brazil), dha një intervistë për "Esporte Spectacular", që ka publikuar një pjesë paraprake të asaj që tha ylli i PSG. Kur ishte duke folur për ish-bashkëlojtarin e tij te Barcelona, Lionel Messi, intervista u bë më emocionale për Neymar. Argentinasi dhe braziliani ndanë një dhomë zhveshjeje për katër sezone, gjatë kohës së tij në "Camp Nou", përpara se të transferohej te PSG për një rekord botëror prej 222 milionë eurosh.

Neymar arriti te Barcelona 21-vjeçar nga Santos, në vitin 2013, dhe u mor shpejt nën mbrojtje nga Messi. Edhe në intervistën me "Esporte Espectacular" në "GloboTV" të Brazilit, sulmuesi i PSG nuk i mbajti lotët, kur kujtoi kohën e kaluar me superstarin argjentinas. Për këtë të fundit thotë se e ndihmoi në një moment, kur kishte nevojë më shumë për këtë. "Sinqerisht, është e vështirë, shumë e vështirë për mua që të flas për Messin. Ai ishte shumë i veçantë për mua në Barcelonë, e them këtë për të

gjithë, - pohoi 27-vjeçari brazilian. - Në momentin kur më duhej mbështetja më e madhe, lojtari më i mirë në botë mbërriti dhe më dha një dorë. Ai tha: Eja, unë jam këtu për t'ju ndihmuar!" Neymar vazhdoi të shpjegojë se me mbërritjen e tij në Barcelonë, teksa Messi e këshilloi të mos ishte i turpshëm dhe të mos kishte frikë prej atij dhe askujt në klub. Gjatë kohës së tij në "Camp Nou" braziliani shënoi 105 gola në 186 ndeshje. Po ashtu, u vlerësua si lojtari i tretë më i madh në botë, pas Messit dhe Cristiano Ronaldos.




Kepa: Nuk dal kundër vendimeve të trajnerit

Kepa Arrizabalaga shfaqësohet për gjestin e shëmtuar që bëri në sfidën ndaj Manchester City-t në finalen e Carabao Cup. Portieri spanjoll i cili nuk pranoi zëvendësimin në shtesë krijoi një lëmsh të madh në fushë duke acaruar në maksimum trajnerin Sarri dhe ndihmësin e tij Zola, por vetë portieri në një intervistë ka sqaruar gjithçka duke nënvizuar se ajo që ndodhi në Wembley ishte thjeshtë një keqkuptim. "Së pari më duhet të themi se kemi të bëjmë me një keqkuptim. Në asnjë moment nuk ishte dëshira ime që të mos i bindem urdhrave të trajnerit. Ishte thjeshtë një keqkuptim, pasi isha vizituar dy herë nga mjekët dhe trajneri kujtoi se nuk isha në gjendje të vazhdoja", ka theksuar Arrizabalaga. Kepa nënvizon më tej se nuk kishte qëllim të dilte kundër vendimit të trajnerit. "E kuptoj se kur e shikon nga jashtë situatën nuk duket diçka e hijshme. E përsëris nuk ishte qëllimi im për të dalë kundër vendimit të trajnerit. Kemi folur së bashku dhe situata është kuptuar. Bëmë një ndeshje të mirë, krijuam raste për shënim, natyrisht që ndjejmë shumë keqardhje, por mund të marrim dhe gjëra pozitive. Sot treguam se mund të konkurrojmë me një prej skuadrave më forta në botë", ka deklaruar Kepa Arrizabalaga.

Bayerni përgatit 120 milionë euro për Asension

Pas suksesit të madh, fitimit të tre Champions-ve radhazi nën drejtimin e francezit, Real Madridi ka "luftuar me veten" për të qenë në majë dhe kompensuar humbjen e Zinedine Zidane e Cristiano Ronaldos. Megjithë ardhjen e dy trajnerëve, Julen Lopetegui dhe Santiago Solari, situata nuk ka qenë fort e qartë te "Los Blancos". Sidomos me argjentinasin në stol, lojtarëve të të rinj po iu jepet një mundësi për të shkëlqyer, por raportet mediatike sugjerojnë se ndonjëri prej tyre mund të konsiderojë edhe largimin nga klubi mbretëror. ESPN raporton sot se



Bayern Munich ka treguar interes të konsiderueshëm për të nënshkruar me Marco Asensio. Gjigantët bavarezë duan ta marrin spanjollin

në "Allianz Arena" për një shumë të lartë financiare prej rreth 120 milionë euro. Presidenti Florentino Perez e ka bërë të qartë në të ka-

luarën se shitja e talentit të ri nuk është në axhendë, por situatat taktike e trajnerit mund t'i ndryshojë gjërat. Rasti "Isco" është shpjegimi më i qartë në këtë drejtim. Asensio ka luajtur në 19 ndeshje, nga 25 të tilla të La Liga-s për këtë sezon, por nuk ka minutazh prej titullari. Hapësirat janë minimizuar disi për të, ndaj nuk është çudi që palët të mendojnë një zgjidhje në merkato. Nëse kjo ndodh në të vërtetë këtë verë, mbetet për t'u parë. Shuma e ofruar nga Bayern Munich është e lartë për "Los Blancos", nërsa ka jo-shur edhe vetë futbollistin.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do i merrni gjerat me seriozitet sot juve qe jeni ne një lidhje dhe do mendoni te jetoni se bashku. Përgatituni mire sepse jo gjithçka është fushe me lule. Beqaret do mund te takojnë persona te veçante me te cilat ja vlen te njihesh. Ne planin financiar do ketë goxha vështirësi, por fale disa miqve te specializuar ne këtë fushe do ia dilni mbanë me sukses.



DEMI 21. prill - 21. maj

Sektori i dashurisë për çiftet do jete i favorizuar nga planetët. Lidhja juaj do jete me e qëndrueshme dhe ju do ndiheni mire pranë te dashurit tuaj. Beqaret do jene mahnitës dhe do bëjnë për vete atë qe duan. Do jete një dite shume e bukur! Plutoni do iu mbroje ne sektorin financiar. Do keni shume fat. Përfitoni sa me shume, por tregohuni ne çdo moment edhe vigjilente.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Ata qe janë ne një lidhje, me ne fund do afrohen me pranë partnerit te tyre dhe do ia shprehin gjitha ato qe kane menduar prej kohesh. Nëse jeni ende vetëm, mos kërkonit te bëni asgjë me ngut sepse situata mund t'iu dale jashtë kontrollit dhe keni për te vuajtur. Për financat do jete dite delikate dhe nuk do mund te kryeni asnjë shpenzim te madh. Beni kujdes!



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Pas një periudhe jo shume te mire për jetën tuaj ne çift, sot situata do filloje te ndryshoje rrënjësisht. Do e dëgjoni me kujdes tjetrin dhe do bëni zgjedhjet e duhura. Beqaret do ndihen mire ashtu si janë dhe nuk do bëjnë asgjë për ta ndryshuar statusin. Te ardhurat do i keni me ne vëmendje se kurrë dhe situata do stabilizohet. Do i shlyeni edhe borxhet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Situata ne lidhjen tuaj nuk do jete e mire. Do keni mosmarrëveshje dhe do debatoni për diçka. Kujdes, duhet te bëni kompromis përndryshe çdo gjë do përkeqësohet. Beqaret nuk duhet te mendojnë se duke joshur me shume do gjejnë personin e zemrës. Planetët do ju ndihmojnë te rregulloni financat tuaja. Besoni tek fati dhe gjithçka do shkoje ashtu si e keni pritur.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nëse nuk zbatoni disa rregulla qe keni vene ne lidhjen tuaj, do keni probleme me partnerin. Kujdes, ato mund te përkeqësohen edhe me shume sesa ju mendoni. Ndryshoni sa nuk është vone. Beqaret nuk do kenë fat sot. Ne planin financiar duhet te bëni shume kujdes. E dini shume mire sa e keni buxhetin. Mos prishni me shume lek sesa jua mban xhepi.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do ketë ndryshime ne jetën tuaj sentimentale, por këto nuk do e prishin harmoninë tuaj ne çift. Dini te dialogoni dhe te flisni me te për çdo problem qe keni. Kjo është një nga cilësitë tuaja. Bravo! Beqaret nuk do takojnë sot askënd qe do i beje për vete. Intuita do ju ndihmoje mjaft për te përmirësuar situatën e vështirë financiare. Kujdes, mos merrni shume rreziqe mbi shpatulla.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dita e sotme nuk do jete shume pozitive për çiftet. Shikojini gjerat me sy tjetër dhe çdo gjë do filloje te përmirësohet. Beqaret duhet te jene shume te vëmendshëm sot me te gjithë ata qe do takojnë. Nga momenti ne moment mund te njohin personin e zemrës. Nëse keni shpenzuar shume kohet e fundit do keni probleme te cilat do e keni te vështirë t'i zgjidhni. Kujdes!



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Duhet ta merrni me seriozitet lidhjen tuaj sot. Për sa ju përket vendimeve te rëndësishme është me mire te prisni javën qe vjen. Do jete një dite e mire për dashurinë. Edhe beqaret do kenë fat, por duhet te janë pak me te hapur. Kujdes me financat. Një gabim shume i vogël do ju lere shume pasoja edhe për ditët ne vijim. Me mire tregohuni te matur dhe shpenzoni me kufi.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Do kaloni një dite shume romantike me atë qe doni. Cijthsesi duhet te qëndroni me këmbë ne toke, jo te shkëputeni tërësisht nga realiteti. Beqaret duhet te përfitojnë sa me shume nga kjo dite për te bere takime. Do keni fat. Financat do jene te mira dhe ju do bëni një investim për diçka qe ju duhet. Cijthsesi shpenzime kot se koti nuk këshillohen gjate kësaj dite.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse jeni ne çift duhet te tregoheni me te matur me partnerin. Jeta juaj duket se do marre një kthesë tjetër. Reflektoni dhe shprehini sa me qarte dëshirat tuaja. Beqaret do takojnë një person te veçante nëpërmjet një mikut te tyre. Situata juaj financiare ne përgjithësi nuk do ketë probleme te mëdha. Mos shpenzoni shume për te mos pasur surpriza te këqija me vone.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do jeni te shqetësuar sot sepse mendoni se nuk keni aritur te plotësoni te gjitha dëshirat e partnerit. E keni gabim sepse ai do ndjehet shume i lumtur me ju. Beqaret nuk duhet te mërzhiten edhe nëse nuk do gjejnë dashurinë. Do kalojnë një dite mjaft te bukur. Për sa ju përket financave duhet te jeni te kujdesshëm dhe te matur. Nuk jeni ne ditën me te mire për te bere shpenzime.



NE KETE DITE

THEMELUESIT, TË PARËT E NJË ORGANIZATE	P	FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO	FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO	KAFSHË E EGËR GJITARE				
NOFKA E IBRAHIMOVIQIT								
TABELA E OREVE								
POETI TETOVAR, ARIFI								
I ERRËTI								
EMRI I VJETER I TOKIOS				SISTEM QEVERISJEJE MBRETERORE, ABSOLUTIZMI				
TRAJTA QË MERR EMRI GJATE LAKIMIT								
Ë		TONIN ULDEDAJ						
SHOQËRIA AKSIONARE		ZË ME DORË DIÇKA						
MBIEMRI DHE EMRI I KITARISTIT TË NUJHUR SPANJOLL	PJESË E DRAMËS (SH. PASHQ.)	LITUMI	SOPRANOJA JONË, ALIAJ	KOBALTI	SHUMËSI BANORI I TAKES	SHTRESË KAFSHË UJI		
D								
VOZITËS I AEROPLANIT						QË I PËRKET EPIKËS		
						LETËR E PALOSUR PËR TE FORMUAR 4 FAQE		
IMPULSI	FOSFORI EMËRTIM PËR KALIN E ZI		FRYMË E NGROHTË QË DEL NGA GOJA; AVULL			AR (FRENGJ.)		
			MAqedonia			PROVINÇË NE PERU		
KINEMATOGRAFI NUJHUR SHQIPTAR NË FOTO								
QË KATË BËJË ME GJOKSIN (MJEK)								
T						HEROI YNË, SOKOLI		
						NOMEN NESCIA		
AUTORI ANGLEZ, BRAUN (KODI I DA VINÇIT)				ENË BAKRI				INTENSITETI TEMPERATURA
				SQUFURI				
FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO								

ZGJIDHJET: P, IBRA, ORAR, NADI, I ZIU, EDO, RASA, E, TU, SH, KAT, DE LUCIA PACO, PILOT, EPIK, I, P, AFSH, OR, SAIM KOKONA, TORAKAL, MIC, DAN, SINI, I, APASIONATA.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

				6						3	9			2	1	6	
1		8	7		3		4			8		4				2	
	2	4			3	1	5				7			6	3		
	7				1				6		2			3			8
8					6			9						5			
			8				7			9				6		2	7
	1	7			8	9	6				3	1				5	
2		6		4		5		3		4					8		1
					2					6	1	3				8	7

Shumë i lehtë: 935416728, 168275394, 724983156, 679321845, 851764239, 342859671, 417538962, 296147583, 583692417. Mesatar: 539782164, 186493725, 427516398, 652937481, 718254639, 394861257, 873129546, 245678913, 961345872.

BËN TATUAZH EMRIN E DJALIT, POR ZBULON QË S'ËSHTË I TIJ!


Ai ishte aq i lumtur që ishte një baba që vendosi të bënte tatuazh emrin e djalit të tij në shpinë: "Benjamin". Një mbi-shkrim i madh dhe i rëndësishëm. Megjithatë, gëzimi u kthye në zemërim kur Pedro Pablo Santo Domingo, një kolumbian 22-vjeçar, zbuloi se në të vërtetë, ky fëmijë nuk ishte i tij.

Disa ditë pas bërjes së tatuazhit, në të vërtetë, i riu lexoi bisedat Ehtasapp në telefonin e të dashurës në të cilën gruaja i tha ish-it të tij, se babai i vërtetë është ai (lajmi i konfirmuar më pas nga një test i ADN-së) dhe dëshiron të rifillojë një marrëdhënie me të. Pedro Pablo, nën efektin e alkoolit, nuk ishte në gjendje



të ruante zemërimin dhe e qëllon partneren e tij me një shkop. Tani ai i është besuar një ekipi psikologësh. Lajmi është raportuar nga faqja lokale e informacionit "La Opinion". Fqinjët, të cilët njoftuan

policinë, e shpëtuan gruan nga goditjet. Partneri i saj u arrestu, por u lirua pasi tregoi historinë e tij para autoriteteve. Psikologët do ta ndihmojnë atë të kapërcejë traumën.



Bëri 19 vjet burg për vrasje, viktima e supozuar ishte gjallë

Një burrë ka bërë 19 vjet burg për vrasje, ndonëse viktima e supozuar e tij është ende gjallë. Lajmi i pazakontë vjen nga Meksika dhe protagonist i kësaj ngjarjeje është Manuel Ramirez. Siç është raportuar nga Notifications SDP, burri, më 26 maj 2000, ishte viktimë e një arrestimi të dhunshëm nga policia. Ai është sulmuar, goditur vazhdimisht dhe hipur në automjet me forcë nga disa policë privatë. Arrestimi, i cili u zhvillua në zonën Acoluman të Meksikës lindore, i parapriu një serie torturash ndaj Manuel Ramirez, i akuzuar për vrasje, por me sa duket pa dëshmi dhe prova.

Në fund të gjyqit penal kundër tij, Manuel Ramirez u shpall fajtor për vrasje nga gjyqtarët, të cilët e kishin dënua atë me 40 vjet burg. Megjithatë, sipas avokatëve të njeriut, viktima e supozuar është ende gjallë. Trupi ku bazohen hetimet, në fakt i përket një personi tjetër; më të shkurtër s, me lëkurë të errët dhe me shenja e plagët, krejtësisht të ndryshme. Itzel del Carmen, gruaja e Manuel Ramirez, ka denoncuar: "Nuk mund të quhet drejtësi ku provat prodhohen artificialisht. Meksika nuk është më shtet ligjor. Bashkëshorti im është burgosur prej 19 vjetësh për një krim që ai kurrë nuk e ka kryer. Ata e detyruan burrin tim që të bëjë një rrëfim duke e torturuar". Ankesa e gruas së tij vjen pothuajse katër vjet pas një ankese të gjatë dhe të dëshpëruar nga Manuel Ramirez, i cili i kërkoi presidentit të atëhershëm meksikan, Enrique Pena Nieto, që të lirohet nga burgju.

Hyn në fuqi ligji për flokët



Kanë marrë fund torturat e çdo personi me ngjyrë, të cilët diskriminoheshin për pamjen e tyre të veçantë, veçanërisht flokët. Tashmë është miratuar një ligj i ri në New York, ku çdo individ, pa dallime racore dhe entike, ka të drejtë të bëjë çfarë të dojë me flokët e tij.

Këtu përfshihen edhe modelet me gërsheta, flokët e kapura bisht, të gjatë ose të fryrë. Njerëzit me ngjyrë nuk do duhet t'i bëjnë më flokët me modele nga më të ndry-

shmet, të cilat shpeshherë kanë sjellë dhe dëme në shëndet.

Gjithashtu ligji parashikon marrjen e masave ndaj parukerëve që kanë shkaktuar probleme por dhe për çdo person që shpreh pakënaqësi në formë bulizmi ndaj pamjes së dikujt.

Tashmë çdo njeri që ka etnitet tjetër dhe jeton në Amerikë, do të mund të mbrohet nga ligji për çdo problematikë që ka lidhje me diskriminimin.

BMW X5 i ri vjen më i gjerë



Kompanie ruse e cila merret me modifikimin e veturave, Renegade, vitin e kaluar ka tërhequr vëmendjen me modifikimin e Infiniti FX dhe Jeep Grand Cherokee, ndërsa kreacioni i tyre më i fundit është BMW X5 (G05) i modifikuar.

Nuk janë zbuluar shumë detaje por janë publikuar vetëm disa fotografi në të cilat X5 i ri duket më i gjerë. Në fotografi shihet X5 i ri me eksterier dy-ngjyrësh, ko-

fanon e re, mbrojtësit anësor të zgjeruar, maskën e përparme të re me vrima të mëdha për ajër, pragjet e reja, mbrojtësin e pasmë shtesë (difuzer) dhe mbrojtësin e pasmë shtesë (spoiler) mbi çati, transmeton Koha.net. Gjithashtu, thuhet se në dispozicion do të jenë edhe rrotat "Vossen" prej 22-inç nga alumini, gypat më të mëdha të sistemit të shkarkimit si dhe amortizatorët e modifikuar.

1616 - Inkuizitorët spanjoll i japin gjilpëra Galileut.

1815 - Napoleoni dhe 1200 persona largohen nga Elba për të filluar ripushtimin 100 ditor të Francës.

1848 - Marksi dhe Engelsi botojnë "Manifestin Komunist".

1885 - Kongresi i Berlinit, jep Kongon Belgjikës dhe Nigerinë Anglisë.

1916 - Trupat ruse pushtojnë Rermansanxh në Persi.

1924 - Fillon gjykimi kundër Hitlerit në Munih.

1925 - Xhihad - Luftë e shenjtë kundër qeverisë turke.

1960 - Kryeministri sovjetik Kruhçev përkrah Indonezinë.

1980 - Egjipti dhe Izraeli këmbëjnë ambasadorët për herë të parë.

1986 - Revolucioni i fuqishëm popullor në Filipine.

2001 - Talibanët shkatërrojnë dy statuja të mëdha të Budës në Bamyani të Afganistanit.

2004 - Vdes tragjikisht në aksident ajror Presidenti i Maqedonisë Boris Trajkovski afër Mostarit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

KALENDARI HISTORIK 26 SHKURT



PSE HYRJA NË AEROPLAN ËSHTË GJITHMONË NË ANËN E MAJTË?

Zgjedhja bie në njërin anë kryesisht për shkak të stafit që pala tjetër mund të përdorë për të shtuar karburante, për të vënë në ndonjë bagazh etj. Përveç kësaj, pilotët zakonisht ulen në anën e majtë, pasi e bën më të lehtë të vlerësojnë distancën e avionit dhe ta parkojë më mirë atë. Ka një shpjegim tjetër që rrenjëti i ka në traditën detare. Më parë, njerëzit duhej të hipnin në anije vetëm në të majtë, kështu që prodhuesit e avionëve ndoqën të njëjtin shembull. E vetmja mënyrë që mund të hyni në të dyja anët është nëse fluturoni me një avion më të vogël.

FANTAZMA NË SHTËPI?

- Babi, kemi fantazma në shtëpi?
- Jo bir!
- ...po mua shërbëtorja më tha që po!
- Atëherë përgatit gjërat e tua dhe t'ia fusim vrapit bir!
- Po pse babi?
- ...nga që s'kemi shërbëtores!!!



Të gjithë e duam drejtësinë, por të paktë janë ata që i duan njerëzit e drejtë.

(J. E. Renan)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS